

# KOMITETI I JURISTËVE PËR TË DREJTAT TE NJERIUT



Komiteti i juristëve për të drejta të njeriut  
DORACAK PËR RESPEKTIMIN E STANDARDEVE TË JETËS PUBLIKE

*Botues*

Komiteti i juristëve për të drejta të njeriut  
Svetogorska 17, 11000 Beograd  
Tel: +381-11-3344-235  
Fax: +381-11-3344-425  
E-mail: [yucomoffice@gmail.com](mailto:yucomoffice@gmail.com)  
Web site: <http://www.yucom.org.rs/>

*Për botuesin*

Biljana Kovačević-Vučo

*Këshilli redaktues*

Biljana Kovačević-Vučo  
Katarina Jozić

*Shtypshkronja*

„Dosije studio“, Beograd

*Tirazhi*

500

ISBN 978-86-83209-28-6



Ky doracak është përgatitur nga Komiteti i juristëve për të drejta të njeriut në kuadër të projektit „Forcimi i kapaciteteve të mbrojtësve lokal të të drejtave të njeriut dhe prezantimi i standardit të jetës publike në Serbi“, i cili realizohet me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij dokumenti përbën përgjegjësi ekskluzive të YUCOM-it dhe parterëve të tij të projektit dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.



KOMITETI I JURISTËVE  
PËR TË DREJTA TË NJERIUT

DORACAK PËR  
RESPEKTIMIN E  
STANDARDEVE TË  
JETËS PUBLIKE

Beograd  
2009.

CIP – Каталогизација у публикацији  
Народна библиотека Србије, Београд

35.086(497.11)

174-057.34(497.11)

DORACAK për respektimin e standardeve të jetës publike /  
[e përgatiti] Komiteti i juristëve për të drejta të njeriut. – Beograd  
: Komiteti i juristëve për të drejta të njeriut, 2009 (Beograd :  
Dosije studio). – 120, [16] str. s tablama : ilustr. ; 24 cm

Izv. stv. nasl.: Priručnik za poštovanje standarda javnog života.  
– Tiraž 500. – Napomene i bibliografske reference uz tekst. – Iz  
sadržaja: Kodi i sjelljes së nëpunësve civil

ISBN 978-86-83209-28-6

1. Komitet pravnik za ljudska prava (Beograd)

a) Државни службеници – Етика – Србија

COBISS.SR-ID 170695948

# Përmbajtja

## PJESA E PARË STANDARDET E JETËS PUBLIKE

Hyrje – çfarë nënkuptojnë me standarde të jetës publike? .....	11
Standardet e jetës publike në Britani të Madhe .....	14

## PJESA E DYTË SHEMBUJ PRAKTIK PËR KUPTIMIN E STANDARDEVE TË JETËS PUBLIKE

Hyrje .....	23
1. Mosegoizmi .....	25
Shembulli nr. 1. Egoizmi nuk nënkupton përgjegjësi. ....	28
Shembulli nr. 2. Mrkonjiqin e nervozon fakti që duhet të kursej .....	30
Shembulli nr. 3. Zyrtarët punojnë për parti, e jo për qytetarët. ....	32
Shembulli nr. 4. Ndërrimi i humbësve nga të gjitha funksionet. ....	34
Shembulli nr. 5. Deputetët i duan edhe pensionet sipas një regjimi „special“ .....	36
2. Integriteti .....	38
Shembulli nr. 1. Drejtorët e humbësve me pagat më të larta .....	40
Shembulli nr. 2. Velja i premtoi Mrkonjës .....	42
Shembulli nr. 3. Slavica, honorariste e „Galenikës“ .....	44
3. Objektiviteti .....	46
Shembulli nr. 1. Edhe në kulturë mbretëron terrori partiak. ....	48
Shembulli nr. 2. Licenca partiake për punë .....	50

	Shembulli nr. 3.	
	Kriteri – librezë e partisë . . . . .	52
	Shembulli nr. 4.	
	Në „Aeroport“ kërkohen bonuse në lartësinë e dy pagave . . . . .	54
4.	Përgjegjësia . . . . .	56
	Shembulli nr. 1.	
	Përmes mëditjeve radikalëve u paguhet mirë pengimin i punës së Kuvendit të Serbisë . . . . .	58
	Shembulli nr. 2.	
	Drejtoresha ka marrë çelësin dhe vulat. . . . .	60
	Shembulli nr. 3.	
	Qyteti humb miliona për shkak të evazionit fiskal . . . . .	62
	Shembulli nr. 4.	
	Qeveria e Serbisë vonon kthimin e Projektligjit mbi shoqatat në procedurën e kuvendit . . . . .	64
	Shembulli nr. 5.	
	Zgjedhjet shpallen të pavlefshme për shkak të emrave në shkronja të alfabetit latin. . . . .	66
	Shembulli nr. 6.	
	Shkojnë në Beograd 20 herë për një leje. . . . .	68
5.	Të qenit të hapur . . . . .	70
	Shembulli nr. 1.	
	Shërbimet e qytetit dhe mafia e urbanizmit. . . . .	72
	Shembulli nr. 2.	
	Sekreti shtetëror dhe rasti i Miladin Kovaçevićit . . . . .	74
	Shembulli nr. 3.	
	Qeveria u ka shitur zyrtarëve të shtetit 288 banesa me çmime më të ulëta . . . . .	76
	Shembulli nr. 4.	
	Mrka ia asfaltoi rrugën Tomës!. . . . .	78
6.	Ndërshmëria . . . . .	80
	Shembulli nr. 1.	
	„Tollovi“ në ndërtesën e Kuvendit të Serbisë . . . . .	82
	Shembulli nr. 2.	
	Drejtori i firmës së Peconit ka qenë në Kuvend. . . . .	84
	Shembulli nr. 3.	
	Krkobabiq i riu – fsheh pasurinë . . . . .	86
	Shembulli nr. 4.	
	Fjalosja midis Nikoliq dhe Shutanovac rreth eksportimit të armëve . . . . .	88
7.	Shembull personal . . . . .	90
	Shembulli nr. 1.	
	Shkelja e dinjitetit të funksionit gjatë diskutimit në Kuvend . . . . .	92

Shembulli nr. 2.	
Në vend të arrestimit, vetëm fjalë për korrupsion.....	94
Shembulli nr. 3.	
Më lehtë është lyerja se marrja me politikë .....	96
Shembulli nr. 4.	
Deputetët paramendojnë se janë „aktorë“ .....	98
Shembulli nr. 5.	
Komisioni Republikan i Zgjedhjeve dhe konflikti i interesave .....	100

PJESA E TRETË  
**HULUMTIME – FORCIMI I KAPACITETEVE TË MBROJTËSVE  
 LOKAL TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE PREZANTIMI I  
 STANDARDEVE TË JETËS PUBLIKE NË SERBI**

SHTOJCA

I	KËSHILLI I LARTË I SHËRBIMIT CIVIL – KODI I SJELLJES SË NËPUNËSVE CIVIL.....	115
II	FORMULARËT PËR NDJEKJE PRAKTIKE TË STANDARDEVE TË JETËS PUBLIKE .....	121





Pjesa e parë  
**Standardet e jetës publike**



## Hyrje – çfarë nënkuptojmë me standarde të jetës publike?

Standardet e jetës publike janë një kategori e re në sistemet e krahasueshme, në thelbin e të cilave është etika. Duke u nisur nga fakti që me ligj, sipas rregullit, nuk mund të përfshihet çdo sjellje e pahijshme e zyrtarëve të autoriteteve publike dhe nëpunësve civil që nuk është në përputhje me interesin publik apo nuk është e drejtë, në Britani të Madhe, Kanada por edhe në shumë vende të tjera, çdo ditë e më shumë, më tepër vlerë i jepet normës morale, si formë e normës shoqërore dhe përgjegjësisë shoqërore të bartësve të ndryshëm të funksioneve publike dhe nëpunësve civil në të gjitha nivelet.

Duke jetuar në shoqëri, njerëzit ndërtojnë standarde përkatëse në komunikimin dhe ndërveprimin e ndërsjellë. Shpesh ndodh që, me kohë, shumica prej tyre bëhen edhe normë juridike, e cila si e tillë është e mbrojtur me autoritetin shtetëror. Fakti që një sjellje „formale“ është e ligjshme, nuk nënkupton njëkohësisht që është etike dhe morale. Prandaj, standardet e jetës publike, gjegjësisht „etika publike“ përbën sot një segment të rëndësishëm të çdo shoqërie demokratike.

Në anën tjetër, kërkesa për përgjegjësi etike, si formë shtesë e përgjegjësisë për bartësit e funksioneve publike dhe nëpunësve civil por edhe më gjerë, është rezultat i hapjes së shoqërisë demokratike bashkëkohore. Publiku ka më pak durim ndaj bartësve të autorizimeve publike, prandaj janë rritur edhe pritjet për sjellje të mirë të tyre – për standarde të larta të sjelljeve etike.

Natyra e kësaj forme të përgjegjësisë imponon një mekanizëm të vetërregullimit të sjelljes brenda organeve të autoriteteve publike, si mjet për vendosjen e përgjegjësisë etike, gjegjësisht standardit në jetën publike.

Vetërregullimi në çfarëdo profesion apo sferë të shoqërisë presupozon që zhvillimi dhe zbatimi i normave bëhet nga ana e atyre, sjellja e të cilëve rregullohet vet me këto norma, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve ndaj shfrytëzuesve të këtyre shërbimeve. Ai kërkon vendosjen e standardeve dhe veprim në pajtueshmëri me këto standarde nga ana e individëve dhe institucioneve për të cilët do të vlejnjë këto standarde, si dhe zhvillimin e procedurave dhe mekanizmave me të cilat do të realizohen këto rregulla.

Meqë thelbi i etikës, gjegjësisht i vetërregullimit është parim i *respektimit të vullnetshëm të rregullave*, gjykatat apo organet tjera të shtetit nuk luajnë rolin e arbitrit, e as nuk i zbatojnë parimet e deklaruara nga njëra anë, ndërsa, në anën tjetër, ata që detyrohen me këto norma nuk e bëjnë këtë as nën kërcënimin e dënimeve ligjore, por për dëshirën e zhvillimit të mëtejshëm të kredibilitetit të profesionit.

Në disa vende, ky sistem është nën kontrollin e organeve të cilat përcaktojnë udhërrëfyesit kryesorë në zhvillimin e përgjegjësisë në jetën publike, siç janë komisionet për standarde në jetën publike në Britani të Madhe apo Kanada.

Me kalimin e kohës, në vendet e zhvilluara ky proces ka sjell deri te zgjerimi i përgjegjësisë etike edhe në profesione dhe veprimtari tjera, të cilat janë të lidhura ngushtë me jetën publike: *mediat dhe gazetarët, mjekët, profesorët e universiteteve, avokatët...* janë vetëm disa nga profesionet të cilat kërkojnë forcim të standardeve të etikës profesionale në fushat e përmendura.

E gjithë ajo që ka ndodhur në Serbi gjatë 15 viteve të kaluara ka lënë pasoja të rënda më të gjitha fushat e jetës – si në atë publike, ashtu dhe në atë private. Shumë vite me radhë, etika dhe rregullat e etikës, si dhe rënia e përgjithshme e moralit, është pasuar jo vetëm me degradim të përgjithshëm të përgjegjësisë ligjore dhe politike, por edhe të asaj etike (morale).

Kështu, korrupsioni, keqpërdorimi i detyrës, grabitja e burimeve publike dhe të ngjashme, janë bërë madje edhe mënyrë e dëshiruar e sjelljes në Serbi, si në sferën „publike, ashtu edhe në atë „private“. Ndikim të konsiderueshëm në këtë ka pasur: (1) mosekzistimi apo mosrespektimi i sistemit ligjor, i cili rregullon të drejtat dhe obligimet e institucioneve dhe përfaqësuesve të institucioneve ndaj sistemit dhe qytetarëve dhe (2) mosekzistimi apo degradimi i sistemit normativ, i cili rregullon të drejtat dhe obligimet ndaj institucioneve dhe qytetarëve.

Zyrtarët e organit të pushtetit publik, nëpunësit civil dhe institucionet e sistemit në përgjithësi duhet ta fitojnë besimin e qytetarëve. Por, besim do të ketë nëse qytetarët e kuptojnë që autorizimet publike, si dhe ato private që lidhen me interesin publik, shfrytëzohen për *të mirën e përgjithshme publike*.

Një prej parakushteve të tranzicionit në Serbi është përmirësimi dhe forcimi i përgjegjësisë politike dhe ligjore. Ajo pa dyshim që nuk është në nivel të kënaqshëm, por reforma në këto dy fusha të përmendura ka filluar deri në një masë. Megjithatë, përgjegjësia politike dhe ajo ligjore mbeten të pamjaftueshme pa promovimin, përmirësimin dhe forcimin e standardeve etike të jetës publike, si formë e tretë e përgjegjësisë.

Vetërregullimi i mishëruar në formë të normave etike dhe rregullave, gjegjësisht standardeve të jetës publike, si dhe mekanizmat adekuate të mbikëqyrjes të sistemit të vetërregullimit, janë ndër faktorët më të rëndësishëm të sistemit të tranzicionit. Megjithatë, vetërregullimi duhet të jetë i vendosur në atë mënyrë që mos të prekë në vet idenë e vetërregullimit dhe të mundësojë përparimin e standardeve të etikës të bartësve të autorizimeve publike, e kombinuar me barazimin e standardeve të vendosura në kuadër të institucioneve. Duke e pasur parasysh qëllimin e përmendur (besimin e qytetarëve dhe forcimin e institucioneve të sistemit), këto standarde do të duhej të pasqyronin etikën, të cilën shumica e qytetarëve pret që ta respektojnë organet, zyrtarët dhe nëpunësit civil. Pra, etika vjen nga qytetarët.

Një pjesë e këtyre standardeve është e definuar me rregulla ligjore, e cila i referohet parandalimit të konfliktit të interesave. Mosekzistimi i konfliktit të interesave të bartësve të autoriteteve publike është, megjithatë, standard minimal të cilin e kërkojnë qytetarët. Konflikti i interesave duhet të përjashtojë mundësinë e përdorimit të autorizimeve publike për realizimin e interesave private. Megjithatë, ky mund të jetë vetëm njëri prej standardeve. Në Britani të Madhe dhe Kanada, me kohë, janë „kristalizuar“ edhe standardet tjera: *mosegoizmi; integriteti; objektiviteti; përgjegjësia; të qenit të hapur; respektimi dhe veprimi me shembull personal*.

Fatkeqësisht, këto standarde etike ende nuk janë „kristalizuar“ në Serbi, Duket se në këtë proces, rol të rëndësishëm do të luajnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut – më saktë, organizatat joqeveritare, caku themelor i të cilave është promovimi, mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të njeriut. Kjo meqë, në këtë kontekst, shkelja e standardeve të etikës më së shpeshti nënkupton edhe shkelje të ndryshme të të drejtave të njeriut nga ana e zyrtarëve të organeve të autoriteteve publike dhe nëpunësve civil. Prandaj, mbrojtësit e të drejtave të njeriut në Serbi kanë rol vendimtar në promovimin dhe krijimin e standardeve të qarta të jetës publike. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut në Serbi përbëjnë strukturën „kulmore“, e cila duhet jo vetëm të ndjek respektimin e tyre, por edhe t'i formulojë në mënyrë të qartë.

Qëllimi i këtij doracakut është që duke punuar bashkërisht me organizatat joqeveritare dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, përmes një sërë shembujsh të sjelljeve etike dhe joetike të zyrtarëve dhe nëpunësve civil, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, të cilat i kemi konstatuar gjatë muajve të kaluar përmes hulumtimit të kryer në Serbi, të formulojmë standarde serbe të qarta të etikës për zyrtarët dhe nëpunësit civil sipas shembullit të standardeve britanike të jetës publike në mënyrë që, në një të ardhme të afërt të mundshme, ato të mund të respektohen qartë, ndërsa shkelja e tyre të sanksionohet „moralisht“ në mënyrë përkatëse.

## Standardet e jetës publike në Britani të Madhe

Standardet e jetës publike janë përkufizuar nga Komisioni për standarde të jetës publike i Britanisë së Madhe që në vitin 1994, menjëherë pas themelimit të tij. Rëndësia e tyre është shqyrtuar përmes hulumtimeve të opinionit publik, të bëra në territorin e Britanisë së Madhe. Duke iu falënderuar rëndësisë së konfirmuar të këtyre standardeve nga ana e opinionit publik, me veprimin personal të anëtarëve të Komisionit për standarde të jetës publike, këto standarde janë pranuar gjerësisht në të gjithë shoqërinë dhe politikën e britanike.

Nga fundi i tetorit 1994, Kryeministri i atëhershëm britanik, z. Xhon Mejxher, njoftoi se qeveria kishte themeluar Komisionin për standarde të jetës publike, me qëllim të „... shqyrtimit të brengave ekzistuese rreth standardeve të sjelljes të të gjithë bartësve të autorizimeve publike, duke përfshirë edhe aktivitetet e tyre financiare dhe afariste, dhe nxjerrjes së rekomandimeve lidhur me rregullimin e domosdoshëm për sigurimin e standardeve më të larta në jetën publike“. Standardet, sipas fjalëve të Xhon Mejxherit, duhet të përfshinin një numër të madh të bartësve të autorizimeve publike, më saktë ministra, nëpunës civil dhe këshilltarë, deputetë të Parlamentit dhe deputetë të Britanisë së Madhe në Parlamentin Evropian, anëtarë dhe zyrtarë të lartë në të gjitha organet publike joshitetërore dhe organet nacionale të kujdesit shëndetësor, drejtorët në organizatat që nuk janë në kuadër të ministrive, anëtarët dhe zyrtarët e lartë të organeve tjera që kryejnë funksione të cilat financohen nga buxheti i shtetit, dhe anëtarë dhe zyrtarë të zgjedhur në pozita në organet e vetëqeverisjes lokale.



Në fillim, Komisioni së pari është marrë me sjelljet joetike të deputetëve të Parlamentit, duke përfshirë kontrollimin e raporteve të tyre financiare, si dhe me raste të caktimeve joadekuate në organet publike.

Duke qenë organ i pavarur këshillëdhënës i qeverisë, Komisioni për standarde të jetës publike ka mbikëqyrë, raportuar dhe ka dhënë rekomandime për të gjitha pyetjet që lidhen me standardet e jetës publike. Komisioni është the-

meluar si një organ i përhershëm, anëtarët e të cilit zgjedhën çdo tre vjet. Puna e Komisionit nuk ka qenë e lidhur me procedura specifike të hetimit apo raportimin që janë caktuar për organe tjera qeveritare apo organe të pavarura.

Në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit të ri, në muajin nëntor 1997, Kryeministri i ri britanik, z. Toni Bler, i zgjeroi edhe më tej kompetencat e Komisionit, për të përfshirë edhe: (1) mbikëqyrjen lidhur me financimin e partive politike dhe (2) të drejtën e Komisionit për të parashtruar rekomandime lidhur me ndryshimin dhe avancimin e rregullores ekzistuese, me qëllim të respektimit të standardeve.

Komisioni takohet shpesh gjatë këtyre kohëve në mënyrë që t'i shqyrtojë çështjet aktuale për të cilat ekzistojnë brenga në publik, të cilat janë të lidhura me shkeljen e standardeve të jetës publike, e sipas nevojës, nxjerrë kumtesa dhe dokumente me të cilat përkrahë hetimet pranë organeve tjera apo organeve të pavarura. Ai ka mundësinë që edhe vet të organizojë „dëgjime publike“ lidhur me rastet aktuale. Gjithashtu, Komisioni mbanë kontakte dhe takime joformale me praktikues në fusha të caktuara dhe me ekspertë, me qëllim të kuptimit sa më të mirë të rasteve konkrete dhe përcaktimit të shkeljes të standardeve të formuluar të jetës publike. Kur është e nevojshme, Komisioni përpilon dhe shpall raporte për qeverinë, të cilat janë në dispozicion të publikut.

Ndonëse është i hapur për pranimin e nismave dhe parashtrësive në fusha të ndryshme që janë lëndë hetimi të Komisionit, ai nuk ka kompetencë për të shqyrtuar dhe vepruar sipas kërkesave individuale, përkatësisht parashtrësive që pohojnë për shkelje të standardeve të jetës publike. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, Komisioni ka pranuar mbi 5000 parashtrësia me shkrim që nga fillimi i punës së tij, që tregojnë se shumë shpejtë është bërë segment i rëndësishëm i demokracisë pjesëmarrëse britanike.

Dokumentet që Komisioni i pranon nga organizatat dhe individët ruhen në zyrën për dokumente publike. Gjithashtu, kopjet e këtyre dokumenteve mund të gjinden edhe në disa zyra të tjera të ngjashme në shumë qytete të Britanisë së Madhe, si dhe në bibliotekën e të dy dhomave të Parlamentit, kështu që ato të mund t'i shfrytëzojnë edhe deputetet. Megjithatë, materialet që mund të jenë fyese, apo për të cilat partitë politike kanë kërkuar që të mos jetë në dispozicion, nuk do të jenë në dispozicion të publikut.

Shtatë standardet themelore të jetës publike në Britani të Madhe, që janë objekt „hetimi“ i Komisionit për standarde në jetën publike janë: (1) *mosegoizmi*; (2) *integriteti*; (3) *objektiviteti*; (4) *përgjegjësia*; (5) *të qenit të hapur*; (6) *ndershmëria* dhe (7) *shembulli personal*.<sup>\*</sup>

**Mosegoizmi**, si standard i jetës publike, në Britani të Madhe nënkupton që bartësit e funksioneve publike duhet t'i marrin vetëm ato vendime të cilat janë në përputhje me interesin publik, dhe që këto nuk duhet të bëhen me përfitim financiar apo material për ata, familjet e tyre, apo miqtë e tyre.

**Integriteti**, si standard i jetës publike, nënkupton që bartësit e funksioneve publike nuk do të duhet të ishin nën kurrfarë detyrimi financiar apo tjetër ndaj individëve apo organizatave, të cilat do të mund të ndikojnë tek ata gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

**Objektiviteti** nënkupton që në kryerjen e punëve publike, duke përfshirë këtu caktimin në funksione publike, ndarjen e vendeve të punës apo rekomandimin e individëve për shpërblime dhe përfitime, bartësit e funksioneve publike duhet të marrin vendime vetëm në bazë të cilësisë.

\* Shënim: Secili prej standardeve të përmendura shtjellohet më hollësisht në pjesën e dytë të këtij Doracaku.

**Përgjegjësia**, si standard publik, nënkupton që bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe që duhet t'i nënshtrohen çdo kontrolli që zbatohet në funksionet e tyre.

**Të qenit të hapur**, si standard i cili zbatohet në jetën publike të Britanisë së Madhe, nënkupton që bartësit e funksioneve publike janë të obliguar të jenë sa më të hapur që është e mundur lidhur me të gjitha vendimet dhe veprimet të cilat i ndërmarrin, si dhe obligimin e tyre që vendimet e tyre t'i arsyetojnë dhe ta ndalojnë dhënien e informatave vetëm kur interesi i përgjithshëm i publikut e kërkon këtë qartë.

**Ndershmëria** si standard nënkupton që bartësit e funksioneve publike kanë obligimin për të lajmëruar çdo interes privat, i cili ka lidhje me detyrën e tyre publike, si dhe të ndërmarrin hapa për zgjidhjen e konflikteve të mundshme në mënyrë që mbrojnë interesin publik.

**Shembulli personal**, si standardi i fundit prej shtatë standardeve në jetën publike të Britanisë së Madhe, nënkupton që bartësit e funksioneve publike duhet t'i nxisin dhe avancojnë këto parime përmes udhëheqjes dhe shembullit personal.

Secili prej standardeve të lartpërmendura është shtjelluar më hollësisht në pjesën e dytë të këtij Doracak.

Me rekomandimin e Komisionit për standarde në jetën publike, në Britani të Madhe janë themeluar disa organe, të cilat, për dallim nga Komisioni, përqendrohen në respektimin e standardeve të sjelljes të zyrtarëve të institucioneve të caktuara. Një organ i tillë është Komiteti për privilegjet e lordëve në Parlamentin britanik.

Këtu, do të përmendim disa raste interesante të cilat i ka shqyrtuar Komisioni si dhe disa organe tjera të pavarura gjatë pranverës 2009.

Pas 350 vjet ekzistimi të Dhomës së Lordëve të Parlamentit të Britanisë, pak kohë më parë, u suspenduan dy anëtarë të saj të dalluar. Lordët *Piter Traskot* dhe *Tomas Tejlor* nga partia qeverisëse laburiste u zbuluan nga gazetarët e *Sandey Tajms-it* të cilët u prezantuan si ndërmjetësues dhe përfaqësues të një kompanie të huaj. Lordët pranuan ofertën që të ndikojnë tek kolegët e tyre në Dhomën e lartë të Parlamentit dhe të votojnë për disa amendamente, dhe në këmbim për këtë ata do të merrnin kompensim në para në vlerë prej 24.000 deri në 120.000 sterlina.



Zbulimi që lordët britanik ishin në gjendje të shisnin sekrete shtetërore për para, duke punuar për interesa të huaja dhe që krahas kësaj rrezikonin stabilitetin e vendit në kohëra të vështira, shkaktoi polemika të rrepta. Trysnia e madhe e publikut e detyroi një nga organet e veçanta të propozojë suspendimin e tyre, i cili u miratua menjëherë. Suspendimi do të zgjasë deri në fund të kryesimit të tanishëm, i cili në këtë përbërje është deri në vjeshtë, siç ishte propozuar në raportin e Komitetit. Policia nuk do të nisë hetime për shkak të pamundësisë së mbledhjes së dëshmitave të mjaftueshme. Lordët nuk akuzohen për marrje parash, por për shkelje të kodit të sjelljes së ndershme të lordëve. Vet rrëfimi që flet për atë se si është arritur deri te diskutimet e pohuara rreth „kompensimit për mundin e tyre“ është gati i pamundur.



Katër deputetë laburist, sipas sqarimeve të *Sandey Tajms-it*, janë takuar me gazetarët raportues, të cilët janë prezantuar si lobues të një kompanie të huaj. Gazeta britanike ka publikuar hollësi të bisedave të cilat i kanë pasur lordi Traskot dhe lordi Tejlor me gazetarët e saj, në të cilat bëhej fjalë për atë se çfarë ndihme mund t'u ofrojnë dhe se si është rrjedha e procedurave parlamentare. Dy lordët e akuzuar pohojnë se kurrë nuk ia kanë ofruar ndihmën e tyre asnjë grupi lobist, duke pohuar se kurrë nuk do të praninin të punonin për interesa të huaja në këmbim për para.

Sipas pohimeve të *Sandey Tajms-it*, lordi Tejlor ka kërkuar 120.000 sterlina për të provuar ndryshimin e ligjit për kreditim, ndërsa për një shërbim të ngjashëm lordi Traskot ka kërkuar 72.000 sterlina. Sipas pohimeve, Traskot i ka ofruar kontaktet e tij në ministrinë e energjisë për ndryshim në vendosjen e tarifave të energjisë elektrike, që do t'i kishte sjellë përfitim të madh financiar sektorit privat të energjisë.

Baronesha Rojal, udhëheqëse e laburistëve në dhomën e lordëve, ka premtuar që do t'i zbardh plotësisht këto akuza, që janë të fundit në një sërë skandalesh, të cilat kohëve të fundit e kanë dëmtuar integritetin e Parlamentit britanik. Në tërë këtë proces ka qenë i përfshirë edhe *Skotland Jard*, por pavarësisht masave të ndërmarra, duket se nuk ekziston qëllimi i sinqertë që rasti të zgjidhet në tërësi. Baronesha ka vlerësuar që akuzat janë mjaft serioze, meqë bëhet fjalë për shkelje të rregullave të Parlamentit, të cilat sigurojnë që lordët nuk guxojnë të përpiqen të ndikojnë në ligje në këmbim të parave.

*Lordi Tejlor* e ka pranuar se dy lobues e kanë kontaktuar atë dhe i kanë ofruar punë si konsulent profesional në kompaninë e tyre, ndërsa për shërbimet e tij i është ofruar honorar mujor mes 5000 deri 10.000 sterlina, varësisht nga angazhimi i tij. Lordi ka shtuar se nuk e ka pranuar ofertën dhe që nuk ka pasur transaksione të parave, duke thënë se nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje për bashkëpunim mes palëve, duke i mohuar pohimet e mediave të shkruara.

Hetime janë ndërmarrë edhe ndaj dy laburistëve tjerë, ish-ministrit të mbrojtës lordit *Luis Muni dhe lordit Piter Snejp*. Muni është bashkëpunëtor i ngushtë i Kryeministrit britanik, ndërsa vlerësohet se fiton mes 35.000 – 40.000 sterlina në vit vetëm për lobim të zhvillimit të kompanisë së americiumit në Edinburg.

Në anën tjetër, Snejp është një legjendë e vërtetë e laburistëve dhe një person me autoritet, i cili 27 vite ka qenë deputet por edhe këshilltar i kompanive të mëdha si *Sterling Lojd dhe Halton Gila*. Të dy janë liruar nga akuzat, të cilat kundër tyre i kishte ngritur *Sandey Tajms-i*, por janë thirrur t'i kërkojnë falje anëtarëve tjerë të dhomës së lartë dhe publikut britanik për sjellje të pahijshme dhe shkelje të rregullave të Parlamentit, të cilat ndalojnë çfarëdo përfaqësimi të paguar të qëndrimeve. Në kumtesën zyrtare thuhet se përfaqësuesit e Parlamentit dhe lordët janë të paguar mjaft mirë, pikërisht për t'iu shmangur nënshtrimit të korrupsionit, shantazhit dhe trysnive të jashtme.

Kjo është arsyeja kryesore që gjatë pranverës 2009 publiku ka qenë i hidhëruar në përfaqësuesit e partisë qeverisëse. Vendimi përfundimtar për fatin e dy lordëve të mbetur është në duart e dhomës së lartë të Parlamentit të Britanisë së Madhe, i cili do të votojë para pushimit veror mbi atë se a do t'i largojë apo dënojë në ndonjë mënyrë tjetër. Rrallë herë ndodh që lordët të suspendohen, ndërsa përjashtimi i fundit ka ndodhur në shekullin e 17.

Serioziteti i situatës në Parlamentin e Britanisë është thelluar edhe më tej me aferën disamuajshe lidhur me shpenzimin e parave të shtetit për nevojat personale të

deputetëve të dhomës së ulët. Një gazetë tjetër britanike, këtë herë *Dejli Telegraf*, ka treguar për mashtrimet e deputetëve në Parlament. Janë publikuar të gjitha hollësitë për atë se çfarë shpenzime paguajnë deputetët në kurriz të taksapaguesve. Aty gjinden fatura për pastruese, pastrim kimik, televizorë, pelena, karamele dhe pastrim oxhakësh, ndërkohë që vëmendjen më të madhe të publikut e kanë tërhequr kreditë për banesa dhe shtëpi, në të cilat deputetët kanë të drejtë, në qoftë se vendbanimi i përhershëm i tyre është jashtë kryeqytetit.

Sipas artikullit të *Dejli Telegraf*, shumica e tyre kanë fituar mjaft duke i ndërruar dhe rinovuar të ashtuquajturat „shtëpi të dyta“ gjatë ekspansionit të madh në tregun e patundshmërive të dekadës së kaluar. Personat përgjegjës në dhomën e ulët kanë kërkuar që në hetimin e keqpërdorimeve të kyçet edhe policia. Por, si në rastin e lobimit të palejueshëm të lordëve, policia nuk i ka hetuar keqpërdorimet, por çështjen se si *Dejli Telegraf* ka ardhur deri te informatat e publikuara. Mendimi i gazetarëve që kanë publikuar këtë artikull në fillim të majit 2009, është se hetimi policor është dëshmi kulmore që Parlamenti thjesht nuk kupton tërbimin e publikut përkritazi me ngjarjet skandaloze në Vestminister.

Interesimi për këtë gjë ekziston që prej vitit 2005, kur sipas Ligjit për qasje të lirë në informata (*Freedom of information Act*) është kërkuar që të publikohen të dhënat për shpenzimet e deputetëve, por që Parlamenti ka heshtur pranë një kërkesë të tillë. Që nga ajo kohë, deputetët kërkojnë t'i shmangen hetimit të drejtë, sepse një numër i madh i tyre kanë qenë drejtpërdrejtë të përfshirë në këto mashtrime.

Njëkohësisht, duket se media të caktuara të shkruara, si p.sh., *Gardian*, mbajnë më tepër anën e deputetëve, sepse kanë pohuar që edhe vet *Dejli Telegraf* i kishte siguruar informatat duke përdorur mjete të dyshimta, gjegjësisht që për informatat kishte paguar rreth 150.000 sterlina. Gazeta *Independent* pajtohet në vlerësimin se deputetët ishin futur në ujëra të turbullta, por që në shkallën botërore të korrupsionit edhe më tej ata janë „peshq të vegjël“. Pavarësisht nga fakti që publiku është tronditur nga grykësia e pohuar e deputetëve të tij, gazeta *Tajms* përmend se deputetët e dhomës së ulët kanë të ardhura mjaft modeste dhe që sistemi i shpenzimeve shtesë është vendosur në mënyrë që ata të ndihmohen për t'i paguar shpenzimet shtesë që dalin nga natyra e punës së tyre. Sistemi parasheh që deputetët të kenë dy vende banimi dhe është plotësisht e arsyeshme që t'u mundësohet jetë dinjitoze dhe të rehatshme. Gazeta *Tajms* konsideron se pohimet që deputetët kanë krijuar për vetën e tyre sistem të përfitimeve shtesë, i cili u mundëson t'i mbushin xhepat mirë, janë thjesht të pasakta.

Megjithatë, kjo aferë ka rezultuar me dorëheqjen e parevokueshme të *Majkëll Martin*, kryetarit të dhomës së ulët. Me këtë veprim, anëtari i dikurshëm i partisë qeverisëse laburiste, tani deputet i pavarur, është bërë kryetari i parë i Parlamentit në historinë e Britanisë i cili është detyruar të jap dorëheqje nga posti. Ndonëse nuk kishte qenë në mesin e deputetëve, të cilët në mesin e arsytimeve për shpenzimeve zyrtare kanë dhënë arsytime nga më të pabesueshmet, duke filluar nga dekorimi i shtëpive, proteza dhëmbësh për fëmijët, e deri te keksët me xhenxhefil, Martini është akuzuar se ka krijuar një mjedis të përshtatshëm që ka lejuar një shpërdorim të tillë të parave të shtetit. Veç kësaj, ai ka qenë njëri nga mbështetësit kryesor të cilët kanë insistuar që hollësitë e shpenzimeve të mos bëhen publike, ndërkohë që në prezantimet e tij ka qenë kaq i rreptë dhe jofleksibil saqë edhe qeveria ia ka ndërprerë ndihmën.

Martini ka deklaruar se më 21 qershor 2009, do ta lë postin e kryetarit, në mënyrë që të rruhet uniteti në parlament, duke shtuar se nuk dëshiron që të hyjë në hollësi të vendimit të tij. Laburistët u giendën në situatë shumë të palakmueshme dhe përpiqen që, së paku, në një masë ta zbusin publikun e tërbuar, ndërkohë që, nën udhëheqjen e Dejvid Kameronit, konservativët tash më kanë kërkuar nga qeveria që t'i shpall zgjedhjet sa më shpejtë që është e mundur. Martini i ka shfrytëzuar kompetencat që ka për ta ndalur debatin rreth propozimit për votëbesimin e qeverisë aktuale. Atmosfera në parlament dukej si në ato ditët e kamotshme, kur të drejtën për fjalë ka mund ta fitojë vetëm ai më i zëshmi. Një ditë pas largimit formal të Martinit nga posti i kryetarit, ai do të zëvendësohet nga kandidati që zgjidhet nga 464 deputetë.

Posti i kryetarit të Parlamentit në Britani të Madhe ndryshon nga shumica e shteteve tjera. Kryetari nuk duhet të jetë person partiak, sepse pritet që me këtë të ruhet pavarësia dhe objektiviteti. Në mënyrë që të fitojë së paku disa pikë pozitive, kryeministri *Gordon Braun* ka paralajmëruar se asnjëri nga deputetët që kanë shpenzuar para në mënyrë të pakujdesshme nuk do të mund të kandidohet në zgjedhjet e ardhshme. Dëm i madh është shkaktuar, ndërsa të gjitha këto skandale e kanë përkeqësuar më shumë rejtingun tashmë të palakmueshëm të partisë, ndërkohë që një numër i madh i të anketuarve konsideron që edhe kryeministri Braun do të duhej të jepte dorëheqje nga posti i kryetarit të partisë laburiste.



Pjesa e dytë  
**Shembuj praktik për kuptimin  
e standardeve të jetës publike**



# Hyrje

Gjatë hulumtimit gjashtëmujor të kryer në periudhën kohore prej fillimit të janarit e deri në fund të qershorit 2009, Komiteti i juristëve për të drejta të njeriut ka vërejtur shumë shkelje të standardeve të jetës publike në Serbi.

Një pjesë e këtij hulumtimi është prezantuar në raportet mujore, të cilat publikohen në ueb-faqen e YUCOM-it, ndërsa në Doracak gjinden edhe shembuj të tjerë të shkeljes së standardeve të jetës publike, gjatë periudhës së lartpërmendur kohore, nga ana e zyrtarëve dhe nëpunësve civil në Serbi.

Në vështrim të përgjithshëm, shkalla e respektimit të standardeve të jetës publike në Serbi është e ulët, dhe njëra prej arsyeve për këtë qëndron në faktin se ato nuk janë qartë të formuluar. Më anën tjetër, etika dhe morali ende nuk janë të përfaqësuar në shkallën e duhur në jetën publike të Serbisë. Prandaj, krijohet përshtypja se në formulimin e standardeve të qarta duhet të „punohet“ ende, sepse adoptimi i standardeve të jetës publike në Britani të Madhe, ndonëse i dobishëm, duhet t'i përshtatet kësaj shoqërie, me çka dhe do të krijohet hapësirë për forcimin e respektimit të etikës dhe moralit të zyrtarëve dhe nëpunësve civil.

Me Ligjin për shërbimin civil të 2005 është themeluar Këshilli i lartë i shërbimit civil. Në pajtim me rregulloret e zbatueshme për organet e administratës dhe shërbimit të shtetit, Këshilli, mes tjerash, sjell *Kodin e sjelljes së nëpunësve civil* dhe kryen punë tjera të caktuara me këtë ligj, ndërsa rregulloret e Këshillit të Lartë publikohen në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë“.

Këshilli nuk ka ueb-faqe, por një pjesë e informatave për punën e tij është në dispozicion në ueb-faqen e *Shërbimit për udhëheqjen me personel të qeverisë së Serbisë*. Në fillim të 2008, Këshilli ka nxjerrë Kodin e etikës së nëpunësve civil që është shpallur në „Gazetën Zyrtare“,<sup>1</sup> i cili përmban një sërë rregullash etike që kanë të bëjnë me nëpunësit civil në Serbi. Megjithatë, informatat më të hollësishme për respektimin e parimeve etike nga ana e nëpunësve civil, si dhe formulimi i këtyre standardeve, kanë mbetur kryesisht të panjohura dhe të padisponueshme për publikun e gjerë.

Nga ana tjetër, nga fundi i 2008, *Mbrojtësi i qytetarëve* disa herë gjatë daljeve të tija publike ka paralajmëruar nxjerrjen e *Kodit të zyrtarëve të organeve të pushtetit publik*, por deri në këtë kohë (mesi i korrikut 2009) një gjë e tillë ende nuk ka ndodh.

Një pjesë e Doracakut që është në duart tuaja, duhet t'ua mundësojë organizatave, të cilat merren me promovimin, avancimin, dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, para së gjithash mbrojtësve të të drejtave të njeriut, që të njihen me standardet e jetës publike, t'i njohin ato, t'i zbulojnë shkeljet e mundshme të tyre, dhe që drejtpërdrejt të marrin pjesë në formulimin e tyre.

---

1 Krahaso: *Kodi i sjelljes i nëpunësve civil*, Këshilli i Lartë Zyrtar, „Gazeta Zyrtare e RS-së“, nr. 29/08. Për më tepër informata rreth Këshillit të Lartë për Gjyqësi dhe Shërbimit për udhëheqje me personel vizitoni ueb-faqen: [www.suk.sr.gov.yu](http://www.suk.sr.gov.yu).

Ajo që ka treguar hulumtimi i Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut është që në çdo rast individual, me rregullin e shkeljes së njërit, shkelen edhe një mori standardesh tjera të jetës publike. Për arsye të përpunimit më të lehtë të „rastit studimor“, çdo rasti i është bashkëngjitur edhe formulari, i cili duhet të shërbejë gjatë edukimit të mbrojtësve të të drejtave të njeriut për standardet e lartpërmendura. Në fund të fundit, përmes rastit studimor, mbrojtësve të të drejtave të njeriut u jepet mundësia që t'i formulojnë vet standardet në mënyrën se si ata i shohin, ku mbrojtësit duhet të bëhen pjesëmarrës aktiv të ndërtimit dhe formulimit të tyre si dhe të ndjekjes së respektimit të tyre.



# MOSEGOIZMI

*Mosegoizmi* është gjithsesi i pari prej shtatë standardeve kyçe të jetës publike të cilat janë kristalizuar në Britani të Madhe dhe në vendet tjera të demokracive perëndimore.

*Mosegoizmi kërkon nga bartësit e funksioneve publike (zyrtarët por edhe nëpunësit civil) t'i marrin vetëm ato vendime të cilat janë në interesin publik. Ata nuk duhet të marrin vendime që u sjellin përfitim financiar apo material atyre, institucioneve tjera dhe partive politike.*

Në shumë vende, ashtu si në Serbi, ky standard etik është standard ligjor. Ai është i lidhur me normat ligjore që i përmban p.sh. Ligji për zgjidhjen e konfliktit të interesave, Ligji për financimin e partive politike, Ligji për Agjencinë kundër korrupsionit, etj. Gjithashtu, shkelja e këtij standardi „etik“ por edhe ligjor, shikuar nga këndvështrimi i „normës ligjore“, në situata të caktuara është thelb i veprave penale (p.sh. veprës penale të keqpërdorimi të detyrës zyrtare, veprimit pakujdesshëm në shërbim).

Megjithatë, *mosegoizmi* si standard i *së drejtës* nuk posedon gjithmonë „gjerësinë“ e nevojshme. E drejta kurrë nuk mund t'i përfshijë të gjitha situatat e papranueshme shoqërore, sepse ato nuk mund të parashihen asnjëherë paraprakisht në tërësi. Në anën tjetër, ata që janë në pushtet dhe të cilët e „shkelin“ shpesh këtë parim, pikërisht për shkak të arsyeve të tyre egoiste, nuk dëshirojnë që situata të tilla të përfshihen nga „sanksionet“ e shtetit në rast të shkeljes së tyre. Elita udhëheqëse në Serbi shpesh „fshihet“ prapa parimit të ligjshmërisë që ende dominon në Serbi. Sipas këtij parimi, çdo veprim i zyrtarëve apo nëpunësve civil arsyetohet nëse është në përputhje me ligjin. Megjithatë, në një shtet bashkëkohorë të së drejtës dominon parimi i „legjitimitetit“, përkatësisht i arsytimit shoqëror të veprimeve të bartësve të funksioneve publike. Pra, parimi i „ligjshmërisë“ nuk është më i nevojshëm. Për veprim të drejtë nevojitet edhe arsytimi i shoqërisë, saktësisht „legjitimiteti“ i veprimit të bartësve të funksioneve publike. Parimi i legjitimitetit, megjithatë, kërkon tashmë kontekstin e përmendur shoqëror dhe arsytimin shoqëror. Bartësit e funksioneve publike kryesisht nuk e njohin këtë ndjeshmëri. Megjithatë, në Serbi këtë e njohin sot mbrojtësit e të drejtave të njeriut, organizatat që angazhohen në fushën e luftës kundër korrupsionit, mediat e veçanta, e shpesh edhe vet qytetarët.

Shkelja e standardit të *mosegoizmit*, si një nga standardet kyçe të jetës publike, shpesh, në kuptimin më të gjerë të fjalës përbën korrupsion, dhe ka kohë që si i tillë njihet në vendet me traditë të gjatë demokratike. Megjithatë, tek ne, „sundimi i ligjit“, përkatësisht norma ligjore nuk i përfshinë situatat e tilla, por edhe kur e bën një gjë të tillë, „e drejta“ shpesh nuk është e saktë, siç janë dhe mekanizmat e themeluar për mbrojtje. Pra, na mbetet vetëm standardi i përmendur etik, e mbi të gjitha, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, mediat dhe publiku të cilët do ta mbrojnë. Prandaj, këtu do të përmendim disa dukuri të tilla „të njohura“ në botë, të cilat përfaqësojnë forma klasike të shkeljes së standardit të *mosegoizmit*, të cilat njëkohësisht janë pjesë përbërëse e termit „korrupsion“.

*Situata e parë* do të ishte kur partitë i shfrytëzojnë funksionet dhe pozitat ekzistuese për „blerjen e votave“ të kategorive të caktuara të zgjedhësve. Kjo dukuri në terminologjinë krahasuese, në kuptimin e gjerë të fjalës, quhet *sjelle qira-kërkuese (rent-seeking behaviour)*, ndërsa një nga format e manifestimit të saj është „shfrytëzimi i drejtë në dukje i fondeve publike“ (*pork barrelling*), me të cilën tregohet që *praktika e bartësit të funksionit, nën trysninë e elitës politike*, në fusha të caktuara shpenzon shuma më të mëdha të parave publike për kategori të caktuara të zgjedhësve (p.sh. pensionistët, studentët, të sëmurët, etj.), me qëllim që partia të fitojë „besimin“ dhe votat në zgjedhjet e ardhshme, duke shkuar kundër dhe në dëm të interesit publik dhe të mirës së përgjithshme të shoqërisë.<sup>2</sup>

Rasti i *dytë* dhe shumë i shpeshtë i shkeljes së standardit të „mosegoizmit“ është lidhja e bartësve të funksioneve publike me interesat private ekonomike, e cila më së shpeshti përthyeret *përmes financimit të partive politike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve publik* gjatë ushtrimit të detyrave publike. Kjo formë ekziston atëherë kur partitë politike, përmes zyrtarëve të organeve të pushtetit publik, të cilët janë personel politik, *i nënshtrohen trysnive dhe miratojnë ligje dhe akte tjera ligjore*, përka-tësisht *vendime strategjike të „shtetit“ në interes të elitës ekonomike* (njerëzve të pasur, pronarëve të ndërmarrjeve private dhe korporatave, etj të ngjashme). Në këmbim për këtë, partia „fiton“ burime të sigurta të financimit, ndërsa „bartësit e funksioneve“ beneficione dhe „lehtësira“ individuale. Prandaj vendet demokratike insistojnë të kenë rregulla ligjore shumë kufizuese lidhur me financimin e partive politike, si dhe për ekzistimin e rregullave për konfliktin e interesave e që, fatkeqësisht, kështu ende nuk është rasti në Serbi.

Edhe lloji i *tretë* i shkeljes së standardit të „mosegoizmit“ është kur zyrtari publik (zyrtar i organeve të pushtetit publik apo nëpunësi civil) e përdor funksionin (pozitën) në aparatit shtetëror kryesisht për qëllim të pasurimit personal. Në këtë kuptim, forma të rënda të dalluara të shkeljes së këtij standardi janë korrupsioni i nivelit të mesëm dhe ai i nivelit të lartë.

Po të nisemi nga kriteri i *vlerës materiale të dëmit, Korrupsioni* mund të jetë i nivelit të vogël, të mesëm dhe të lartë. Korrupsioni i nivelit të mesëm, lidhet kryesisht me nëpunësit civil të rangut të mesëm, të cilët gjinden në pozita relativisht solide dhe me një shkallë më të lartë të autorizimeve në sferën e vendimmarrjes në diskrecion. Ajo që e dallon këtë grup nëpunësish nga korrupsioni i lartë është kryesisht „shkalla“ që ata zënë në administratën shtetërore dhe në hierarkinë shtetërore në kuptim më të gjerë, ndërkohë që animi kah korrupsioni i „lartë“ ritet me avancimin në nomenklaturën e nëpunësve civil.

*Korrupsioni i nivelit të lartë* nënkupton aranzhimin e marrëveshjeve të mëdha afariste, transaksione milionëshe të paligjshme, lidhje me krimin e organizuar, tregtinë e paligjshme me mallra të vlerave të mëdha që i nënshtrohen akcizës, keqpërdorimin në prokurimet publike dhe në procesin e privatizimit dhe të tjera. „Korrupsioni i nivelit të lartë“ paraqitet në nivelet më të larta të qeverisë dhe përfshinë projekte dhe programe më të mëdha të shtetit. Qeveria shpesh ofron përfitime të mëdha financiare firmave private përmes marrëveshjeve për prokurime publike dhe dhënies së koncesioneve. Përmes ryshfetit, investitorët privat në bashkëpunim me zyrtarët e lartë marrin për vete renta monopolizuese, ndërsa procesi i privatizimi

2 Krahaso: Miodrag Jovanović, *Korrupsioni politik: nocioni, shkaqet, tipologjia, me fokus të veçantë në vendet post-komuniste, Korrupsioni (buletini i punëve)* fq. 412-413.

mit i nënshtrohet marrëveshjeve të brendshme korruptuese.<sup>3</sup> Kjo formë e korrupsionit më së shpeshti është i lidhur me *korruptionin politik* dhe *ushtrimin e funksioneve më të lartë të shtetit*, dhe me të ashtuquajturin korrupsion të „centralizuar“. Pasojat e korrupsionit të nivelit të lartë nuk janë vetëm ekonomike, dhe nuk pasqyrohen vetëm përmes dëmit të jashtëzakonshëm material i cili shkaktohet në këtë mënyrë për shtetin dhe shoqërinë, por ajo sjell deri tek prishjen apo dëmtimin e legjitimitetit të institucioneve dhe uljen e besimit të përgjithshëm të publikut në shtet. Korrupsioni i nivelit të lartë, me rregull, lulëzon në periudha krize për shtetin dhe, si e tillë, ajo jo vetëm që i shkakton shoqërisë dëm të jashtëzakonshëm por përbën edhe sfidë të madhe për sigurinë.

Ekzistojnë gjithashtu edhe situata të caktuara kur „mosegoizmi“ nënkupton marrjen e një „vendimi“ të caktuar nga zyrtari publik, i cili nuk duhet të ketë karakter rreptësishtë zyrtar, e në këtë kuptim edhe nuk duhet t'i referohet asnjërës formë të fenomenit të korrupsionit. Thelbi i një vendimi të tillë të zyrtarit është interesi publik, por mburrja, rejtingu, popullariteti apo trimëria e rrejshme... Një „vendim“ i tillë i zyrtarit tregon, gjithashtu, për tiparet e karakterit të tij – egoizmin, ndërsa ndaj sjelljeve të tilla mund të reagohet vetëm me normë morale, gjegjësisht përmes zbulimit të shkeljes së standardit të jetës publike.

---

3 Krahaso: Suzan Rouz-Ejkerman, *Korrupsioni dhe pushteti – shkaqet, pasojat dhe reforma*, „Gazeta Zyrtare“, Beograd, fq. 39.

# MOSEGOIZMI

## SHEMBULLI nr. 1.

### Egoizmi nuk nënkupton përgjegjësi

Sekretari i shtetit për ministrinë e ekonomisë dhe zhvillimit rajonal, kah fundi i marsit ka kërkuar, përmes një shkrese formale, nga ministria e drejtësisë që në gjykatat të ndalohen të gjitha procedurat për rastet ku punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara dhe atyre në proces të privatizimit kërkojnë nga ato përmbushjen e të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës, ku sekretari shtetëror i ministrisë së drejtësisë Sllobodan Homen ka vepruar në pajtim me kërkesën. Në këtë mënyrë, është ushtruar trysni e drejtpërdrejtë në pavarësinë e gjyqësorit nga ana e ekzekutivit, gjë që ka ngjallur reagimin e Gjykatës Supreme, gjykatësve, individëve, si dhe asociacioneve të profesionit. Kështu, për shembull, nga Gjykata Supreme është bërë lajmërim se gjyqtarët nuk do të veprojnë sipas kërkesës.



Nebojsa Qiriq

Me rastin e kësaj shkrese të ministrisë së ekonomisë, Homeni ka deklaruar se shkresa ka qenë një nga shumë të tilla që arrijnë dhe që ai atë vetëm e ka përcjell më tej në Gjykatën Supreme, kështu që në këtë rast ministria e drejtësisë ka qenë vetëm „postier“. Nga Gjykata Supreme është kumtuar se gjykatësit nuk do të veprojnë sipas asaj kërkesë.

Siç mund të dëgjohej ne publik, arsyeja e pohuar për një shkresë të tillë të adresuar nga ministria e ekonomisë, në krye të cilës është ministri Mllaxhan Dinkiq, është që, në kushte të krizës ekonomike, procedura të tilla gjyqësore mund të shkaktojë dëm të pariparueshëm për afarizmin dhe ardhmërinë e këtyre ndërmarrjeve e që, mes tjerash, kështu edhe vet punëtorët mund të mbesin pa punë në rast të falimentimit.

Me këtë rast, ka reaguar edhe Bordi i republikës për zgjidhjen e konfliktit të interesave si dhe Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë. Bordi i republikës ka kërkuar nga qeveria e Serbisë që t'i shkarkojë sekretarët e përmendur të ministrisë së ekonomisë dhe zhvillimit rajonal dhe atë të ministrisë së drejtësisë, sepse kanë shkelur nenin 6 të Ligjit për zgjidhjen e konfliktit të interesave, i cili parasheh ndalimin e përdorimit të funksionit zyrtar që përmes ndikimit në vendimin e legjislativit, ekzekutivit apo gjyqësorit të realizohet përfitimi, të arrihet ndonjë e drejtë apo lehtësirë, të lidhet ndonjë punë ligjore apo në çfarëdo mënyre të ketë favorizuar interesin e tij apo të dijujt tjetër. Qeveria e ka refuzuar rekomandimin e përmendur për shkarkim.

Shpejt është deklaruar edhe Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë, i cili ka kërkuar nga qeveria vetëm shkarkimin e sekretarit të shtetit Nebojsa Qiriq, sepse ai, në rastin konkret, nuk ka bashkëpunuar me Ombudsmanin. Mbrojtësi i qytetarëve, me këtë rast nuk ka kërkuar shkarkimin e Sllobodan Homenit, sepse, për dallim nga Qiriqi, ai kishte bashkëpunuar në rastin konkret me Ombudsmanin. Qeveria ka refuzuar të veprojë edhe sipas këtij rekomandimi.

Në ministrinë e ekonomisë dhe zhvillimit rajonal u tha se nuk shohin arsye për shkarkim dhe plotësisht e kanë mbështetur Qiriqin, sepse „...nuk ka pasur qëllim të ndikojë në vendime të gjykatës, e as që e ka bërë një gjë të tillë...“, por i ka dërguar një letër organit ekzekutiv. Sa i përket mosbashkëpunimit me Ombudsmanin, në këtë ministri thanë që nuk kanë informata për atë që Qiriqi ka refuzuar bashkëpunimin me Mbrojtësin e qytetarëve, dhe që sekretari i shtetit gjendet në Uashington në takimin e Bankës Botërore.

## PYETËSOR

<b>MOSEGOIZMI</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i marrin vetëm ato vendime që janë në përputhje me interesin publik. Këtë nuk do të duhej ta bënin për përfitime financiare apo materiale për vetën, familjen e tyre, apo miqtë e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# MOSEGOIZMI

## SHEMBULLI nr. 2.

### Mrkonjiqin e nervozon fakti që duhet të kursej

Në kuadër të masave për kursim në kushte të krizës ekonomike, Qeveria e Republikës së Serbisë ka kërkuar nga ministrinë uljen e shpenzimeve për 26%. Masat e përmendura, më së shumti e kanë goditur ministrin e infrastrukturës Millutin Mrkonjiqin, i cili i pakënaqur nga kjo ka ofruar dorëheqjen e tij nga mesi i muajit prill 2009. Në SPS (Partinë Socialiste të Serbisë), pas bisedimeve me Mrkonjiqin, thanë se pakënaqësitë janë normale në çaste krize, por që nuk do të ketë pasoja serioze.



Masat për ballafaqimin e krizës të qeverisë së Serbisë nënkuptojnë zvogëlimin e buxhetit të të gjitha ministrive, që ka përfshirë edhe ndërprerjen e projekteve të caktuara dhe „shkurtimin“ e mjeteve të parapara. Masat kundër krizës kanë goditur në një mënyrë edhe projektin e ndërtimit të korridorit 10, për të cilën gjë Mrkonjiqi ka reaguar aq zëshëm.

Sipas lajmeve të publikuara nga qeveria e Serbisë, projektin e përfundimit të korridorit 10, me rebalancimin e buxhetit që vijon deri në përfundim të muajit, aktualisht është paraparë më shumë se që ishte paraparë me buxhetin fillestar, sepse ministria e Mrkonjeviqit duhet të marrë 1,5 miliardë dinarë shtesë për shpronësimin e tokave, ndërsa tre miliardë për ndërtimin e pjesës nga Horgoshi deri në Novi Sad do të sigurohen nga buxheti i Vojvodinës. Në buxhetin fillestar për 2009, nga burimet vetanake për korridorin 10 ishin siguruar vetëm tre miliardë dinar, ndërsa paratë për shpronësim nuk ishin planifikuar.

Por ajo që posaçërisht ka mundur ta prek Mrkonjiqin, siç kanë kuptuar gazetarët, është vendimi që në pajtim me Ligjin e miratuar rishtas shpronësimi i tokave nuk bëhet vetëm me pagesë në të holla por edhe në natyrë, me këmbim të tokës. Ndonëse në këtë mënyrë ai kursen 100 milion Euro në shpenzime, me sa duket Mrkonjiqit nuk i pëlqen që nuk do të disponojë me të gjitha mjetet për shpronësim. Gazetarët gjithashtu kanë zbuluar që kjo nuk është hera e parë që Mrkonjiq ka ofruar dorëheqje, dhe që kolegët e tij të SPS-së kanë pasur mundësi që, deri tani, t'i shohin madje katër nga dorëheqjet e ofruara prej tij. Çdo herë kur i heqin diçka, ai ofron dorëheqje. Pas kësaj ai revoltohet, pastaj kolegët e tij nga SPS-ja e lusin dhe bindin. Sido që të jetë, gjëra të tilla ka pasur edhe më parë – tha bashkëbiseduesi i një gazete ditore.

## PYETËSOR

<b>MOSEGOIZMI</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i marrin vetëm ato vendime që janë në përputhje me interesin publik. Këtë nuk do të duhej ta bënin për përfitime financiare apo materiale për vetën, familjen e tyre, apo miqtë e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimeisht këtë standard të jetës publike?		

# MOSEGOIZMI

## SHEMBULLI nr. 3.

### Zyrtarët punojnë për parti, e jo për qytetarë

Sikur të ishte zbatuar vazhdimisht në praktikë Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, 995 e zyrtarëve tanë do të konsideroheshin si „persona me lidhje“, të emëruar dhe caktuar duke iu falënderuar lidhjeve partiake, pra në mënyrë jomeritore dhe në bazë të kriterëve jo objektive – kështu i deklaroi nga mesi i prillit një gazete ditore Slobodan Beljanski, kryetar i Bordit për parandalimin e konfliktit të interesave.



Sipas mendimit të Beljanskit, ekzistojnë mjaft shembuj që tregojnë se në shtet nuk ka vullnet politik që të ndërpritet partikracija, ndërsa në vendet udhëheqëse të vijnë ekspertët. Përderisa inxhinieri i metalurgjisë ndodhet në krye të Qendrës së kul-

turës në Bor, ose kamerieri kryetarë i Bordit drejtues të ndërmarrjes publike komunale në Krushevc, biologu sekretar i shtetit në Ministrinë e kulturës, ndërsa pensionisti nënkryetar i qeverisë, asnjë masë e ndërmarrë nga kabineti i Cvetkoviçit me qëllim të reformimit të shtetit nuk do të jetë më shumë se demagogji.

Paralajmërimi se këtë vit do të shkarkohen nga puna rreth 8.000 nëpunës të shtetit, sipas mendimit të Beljanskit nuk do të sjellë deri te një shtet më efikas dhe më të lirë, por, ashtu siç paralajmërojnë ekspertët, vetëm deri te shkarkimi nga puna të atyre pak njerëzve të cilët dinë ta kryejnë punën. Partitë do t'i mbrojnë nga shkarkimet njerëzit besnik ndaj tyre, e këta njerëz nuk punojnë në të mirë të qytetarëve por për interesin e tyre personal dhe atë të partive të tyre.

„Në qoftë se do ta kishim hequr partikracinë, ku përkatësia në parti hapë dyert e shërbimit publik, do të kishim një shoqëri shumë më demokratike me njerëz profesional në pozita udhëheqëse, të zgjedhur në bazë të kriterëve objektive. Nuk shoh se po ndërmerret diçka në shoqëri, e as gatishmërinë e partive për të hequr dorë nga punët publike. E gjitha mbetën në një qark të mbyllur, ndërsa vendimet i marrin atë që janë të pakët në numër“ – deklaroi Beljanski, duke theksuar se motivi për hyrje në shërbimin publik është përshtatshmëri personale, e jo interes publik.

Thelbi i partikracisë, siç kishin deklaruar për një të gazetë të përditshme profesore të respektuar të së drejtës kushtetuese, është që ata të cilët udhëheqin nuk punojnë në të mirë të interesit publik, por në interes të partive që i kanë caktuar ose në interes të manjatëve të cilët u kanë ndihmuar të vijnë në pushtet. Sistemi shtrihet në tërë vertikalen e shtetit, nga administratat komunale, të cilat ia mundësojnë manjatëve qasjen në tokë të vlefshme pa tenderim dhe kështu e shtojnë pasurinë e tyre, e deri te maja dhe korrupsioneve në prokurimet publike e cila, siç ka theksuar për këtë në një gazetë të përditshme Predrag Jovanović, drejtor i Administratës për prokurime publike, „në vit merr 400 milionë Euro“. Kjo shifër është katër herë më e madhe „vri-ma buxhetore“, të cilën qeveria me shumë mund tani po përpiqet ta arnojë.



## PYETËSOR

<b>MOSEGOIZMI</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i marrin vetëm ato vendime që janë në përputhje me interesin publik. Këtë nuk do të duhej ta bënin për përfitime financiare apo materiale për vetën, familjen e tyre, apo miqtë e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# MOSEGOIZMI

## SHEMBULLI nr. 4.

### Ndërrimi i humbësve nga të gjitha funksionet

Nga fundi i qershorit 2009, në Kikindë ka ardhur deri te ndërrimi i kryetares së komunës Jagoda Tolicki. Gjatë muajve të fundit, Jagoda e ka „trazuar“ dy herë opinionin publik në komunën e saj. Herën e parë, në tetor 2008, kur si anëtare e DS-së pranoi të zgjidhej në postin e kryetares së komunës, ndërsa hera e dytë ishte gjatë mesit të muajit qershor, kur publikisht, gjatë takimit të KK-së



haptas iu kundërvu mënyrës se si funksionon dhe si e organizon pushtetin DS-ja në Kikindë. Ndërrimi tejet i shpejt i saj është në fakt kulminim i përplasjeve të dy rrymave në mesin e demokratëve, ndërsa fshehtësi publike është se ka pasur fërkime midis tyre edhe në kohën kur pikërisht ajo është propozuar për kryetare të komunës, e jo Branisllav Bajiqi, bartës i listës „Për Kikindën Evropiane“ në zgjedhjet lokale, lajmëruan gazetarët korrespondentë nga Kikinda.

Kungulli plasi në takimin e kuvendit komunal të 5 qershorit, kur Jagoda Tolicki, si kryetare e komunës, nuk ka dashur t'i propozojë nenet e reja të këshillit komunal në mënyrë që të ndërroheshin të mëparshmit. Tolicki e kritikoi kryetarin e këshillit, Savo Dobraniq, ndërsa tërthorazi iu referua edhe afaristit Zoran Milesheviq, pronarit të ndërmarrjes „Jet kompani“ (në përbërje të së cilës janë „radio VK“ dhe „televizioni VK“) dhe i hotelit „Narvik“. Ndonëse në asnjë fjalim ajo nuk përmendi emrin e Zoran Milesheviqit, për qytetarët e Kikindës ishte e qartë se për kënd po mendonte ajo kur tha që arsyeja për ndërrimin e saj është se „nuk ka lejuar që politika të bëhej në restorante të hoteleve dhe nga ballkoni i 'Narvikut'“:

„Fitoren e partisë sime nuk e kam përjetuar si pre specifike e as i mundësi për udhëheqje të lirë me personel. Pushtetin, aq më pak, e kam përjetuar si mundësi për shfrytëzim të pakontrolluar të mjeteve buxhetore sipas llogarisë personale të individëve, të cilët, a mund ta paramendoni, nuk janë as pjesë e pushtetit lokal“, tha Tolicki, duke i bërë thirrje kryetarit të këshillit DS Sava Dobraniqit, që pa dijen e saj, gjatë kohës sa nuk ka qenë e pranishme, ka urdhëruar që klubit hendbollistik të femrave të udhëhequr nga kumbara i tij, t'i paguhet një milion dinarë. Tolicki gjithashtu tha se „me muaj u ka rezistuar trysnive që televizionit „VK“ të Millosheviqit t'i paguhen shuma milionëshe dhe që ka treguar se kështu kishin vepruar edhe zyrtarët e pushtetit të mëparshëm.

Sido që të jetë, Tolicki është ndërruar nga posti i kryetarit të komunës, ndërsa pushteti lokal ka përjetuar një rikonstruktim total. Në vend të nëntë anëtarëve, Këshilli komunal tani ka pesë anëtarë (vendimi për këtë është marrë gjatë kohës kur Tolicki ka qenë kryetare e komunës), ndërsa në funksione janë pikërisht ata të cilët ish-kryetarja nuk ka dashur t'i mbështesë.

## PYETËSOR

<b>MOSEGOIZMI</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i marrin vetëm ato vendime që janë në përputhje me interesin publik. Këtë nuk do të duhej ta bënin për përfitime financiare apo materiale për vetën, familjen e tyre, apo miqtë e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# MOSEGOIZMI

## SHEMBULLI nr. 5.

### Deputetët i duan edhe pensionet sipas „regjimit special“

Nga fundi i majit 2009, në publik është „zbuluar“ informacioni se deputetët e Kuvendit të Serbisë kanë pasur ndërmend që t’ia mundësojnë vetës pensionet me Ligjin e ri për kuvend. Sipas informatave të burimit anonim nga Kuvendi, zëshëm flitej për vendosjen e pensioneve për deputetët, të cilët janë në marrëdhënie të përhershme pune në Kuvendin popullor, ndërsa pensionet do të ishin deri në lartësinë e një page të plotë të deputetit, e cila, në atë kohë, ishte 75.000 dinarë.



Ky informacion ka hasur në dënimin e fuqishëm të publikut, i cili ishte i revoltuar nga paralajmërimi se deputetët, në këtë mënyrë, do të mund të ishin në pozitë shumë më të privilegjuar në raport me qytetarët tjerë. Deputetët e partive të ndryshme politike kryesisht i kanë demantuar këto informata. Megjithatë, ndonëse përfundimi i shpejtë i Projektligjit të parë për kuvendin popullor është paralajmëruar qysh nga fundi i majit, kjo gjë nuk ndodhi më pas. Prandaj, duket se ekziston „frikë“ e arsyeshme e publikut që në versionin final të ligjit të gjendet një propozim i tillë.

## PYETËSOR

<b>MOSEGOIZMI</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i marrin vetëm ato vendime që janë në përputhje me interesin publik. Këtë nuk do të duhej ta bënin për përfitime financiare apo materiale për vetën, familjen e tyre, apo miqtë e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# INTEGRITETI

Standardi i dytë subjektiv i jetës publike që kanë të bëjnë me zyrtarët publik është *integriteti*. Duhet vërejtur se ky standard është në lidhje të ngushtë me standardin e mosegoizmit, por për dallim nga i pari, tek i cili theksi vihet në marrjen e vendimeve, te standardi i integritetit theksi është te „detyrimet“ eventuale, të cilat i ka zyrtari ndaj personave të tretë, të cilat mund ta ndalojnë atë që t'i ushtroj funksionet e tij në përputhje me interesin publik.

*Si standard i jetës publike, Integriteti nënkupton që bartësit e funksioneve publike nuk do të duhej të ishin nën kurrfarë obligimi financiar apo tjetër ndaj individëve apo organizatave, të cilat do të mund të ndikonin tek ata në kryerjen e detyrës zyrtare.*

Edhe ky standard etik, si dhe ai paraprak, e ka „pikëmbështetjen“ e tij në legjislacion dhe normë ligjore, ndërsa shkelja e tij në situata të caktuara përfaqëson edhe thelbin e veprave të caktuara penale. Megjithatë, „Kufiri“ i normës ligjore nuk jep mundësinë që ajo t'i përfshijë të gjitha rastet e shkeljes së këtij standardi. Siç ishte rasti me standardin paraprak, edhe integriteti si standard moral ka kuptim shumë më të gjerë se sa është rasti me normat ligjore, të cilat e rregullojnë atë. Prandaj, këtu do t'i përmendim disa shembuj, ku „lidhjet“ e caktuara ndërmjet zyrtarëve dhe personave të tretë, ndonëse nuk „ndalohen“ me ligj, përbëjnë shkelje të standardit etik të „integritetit“.

Bartësit e këtyre funksioneve në Serbi sipas rregullit nuk janë të „integritetit“. Arsyeya për këtë është se në Serbi ende dominon i ashtuquajtimi „*sistemi i presë*“ (*spoils system*), i cili u braktis në SHBA dhe demokracitë tjera perëndimore që nga fundi i shekullit 19. Me fjalë tjera, në „sistemin e presë“, pas zgjedhjeve, partitë e reja dhe shumica e re politike ndërron edhe të gjithë personelin profesional nga maja e deri në fund, duke i caktuar në këto vende „njerëzit e tyre“. Në sistem të tillë, i vetmi kualifikim që duhet ta posedoj një zyrtar i pushtetit publik është „besnikëria“ ndaj partisë politike apo besnikëria ndaj zyrtarit të shtetit.

Megjithatë, në shtetet bashkëkohore të së drejtës, me kohë është krijuar „*sistemi meritore i nëpunësve*“ – i bazuar në sistemin e vlerësimit të personelit (para së gjithash nëpunësve profesional të shtetit), në të cilin funksionet e *nëpunësve* ndahen qartë me ato *politike*, si funksione profesionale. Për fat të keq, në vendet në tranzicion, në të cilat dominon në mënyrë strikte modeli i administratës hierarkike, nëpunësi civil është ende nën kontrollin e fortë të zyrtarëve të pushtetit publik si dhe bartësve të funksioneve politike. Në një sistem të tillë, në punën e zyrtarëve të organeve publike apo nëpunësve, „ndikon“ ai që e ka vendosur aty. Kështu, si pasojë e mosekzistimit të mekanizmave adekuatë të përzgjedhjes brenda profesionit, qoftë kur në pyetje është avancimi profesional ose avancim në strukturën udhëheqëse, apo ndikimit të qendrave lokale apo qendrore të pushtetit në punën e institucioneve ndikon edhe në integritetin e personave që mbajnë pozita publike.

Për shembull, nëpunësi civil të cilit i është besuar një autoritet në diskrecion, nga trysnitë e zyrtarit me orientim dhe politik të zgjedhur të pushtetit publik „zbaton“ urdhra politike prapa të cilave fshihet partia politike. Këto urdhra shpesh „shkojnë në të mirë“ të interesave të „njerëzve të pushtetshëm“, ndërmarrjeve, korporatave,

përkatësisht interesave private. Ato posaçërisht vihen në pah gjatë nënshkrimit të punëve publike apo financimit të partive politike. Kur shkelet standardi i integritetit, në publik *humbet besimi në tërë strukturën udhëheqëse politike dhe në atë administrative*, që tek qytetarët krijon një ndjenjë të korrupsionit të përgjithshëm të pushtetit. Motiv për shkelje të standardit të integritetit, siç është rasti edhe te shkelja e standardit të „mosegoizmit“, është shpesh përfitimi material. Në këtë kuptim, zyrtari i organeve të pushtetit publik ose nëpunësi civil i siguron privilegje të caktuara të kundërligjshme dhe pamoralshme ndonjë personi të tretë për ndonjë përfitim material dhe të ngushtë. Kështu, personi i tretë fiton „kontroll të plotë“ edhe ndaj veprimeve të ardhshme të zyrtarit publik apo nëpunësit civil edhe për nevojat e „ardhshme“ të „klientit“ të njëjtë.

# INTEGRITETI

## SHEMBULLI nr. 1.

### Drejtorët e humbësve me pagat më të larta

Në fillim të prillit, në publik u përhap lajmi se drejtorët e humbësve në ndërmarrjet publike paguhen më së miri në Serbi. Në atë kohë, paga më e lartë e drejtorit ishte 379.161 dinarë, që përbënte 12,5 paga mesatare në Serbi. Nga gjithsej 32 ndërmarrje publike, 5 drejtorë kanë pasur pagë më të lartë se 300.000 dinarë, ndërsa 10 e kanë pasur më të ulët se 100.000 dinarë.



Ndonëse nuk ka vend për populizëm të llojit „të gjithë duhet të kenë pagë të njëjtë“, publikimi i këtyre të dhënave e ka ngritur përsëri në publik temën se a janë pagat e drejtorëve adekuate, posaçërisht kur dihet se emrat e njerëzve që i udhëheqin ndërmarr-

jet më të mëdha janë emra të prodhuara nga partitë, të cilët më pas do të shërbejnë si burim i sigurt i të hyrave partiake. Sipas mendimeve të shumta, dyshime për personelin që vjen do të ketë deri atëherë kur partitë politike të vendosin që personeli për këto ndërmarrje të zgjidhet përmes konkurseve. Deri atëherë, edhe ata që vërtet e njohin punën, por pas të cilëve qëndron një parti, do të përbëjnë vetëm përjashtime që e vërtetojnë këtë rregull.

Në vend të dytë për nga lartësia e pagës së marrë gjendet „Telekom Srbija“, ku paga e drejtorit të përgjithshëm është 354.879 dinarë, ndërsa sigurisht që vendin e tretë e zë „Elektroekonomia e Serbisë“ me 345.779 dinarë. Kështu, tre vendet e para i zënë dy humbës – në pozitën e parë dhe të tretë. Në fillim të majit, drejtori i përgjithshëm i JP „Transnafta“, ka pasur pagë prej 331.163 dinarë, afërsisht 14.000 dinarë më pak se drejtori i EPS-së, ndërsa kolegu i tij në „Srbijagas“ në muaj fiton 312.918 dinarë. Gjithsej tetë drejtorë marrin paga mbi 200.000 dinarë, ndërsa paga më e ulët në këtë grup është 202.383 dinarë, që e merr drejtori i „Hekurudhave të Serbisë“.

Nga gjithsej 32 ndërmarrje publike, nëntë drejtorë fitojnë në mes 100.000 dhe 200.000 dinarë. Paga më e lartë në këtë grup është 192.321 në „Qendrat Skitare të Serbisë“, ndërsa më e ulët është 125.132 dinarë në „Jugomark“.

Disa ditë më vonë, „Jat ervejs“ ka kumtuar se do të miratojë masa për pagat e udhëheqësisë, si dhe që paga e drejtorit të përgjithshëm do të ulet.

#### **Pesë pagat më të larta për muajin mars 2009:**

„Jat ervejs“	379.161
„Telekom“	354.879
„EPS“	345.0779
„Transnafta“	331.163
„Srbijagas“	312.918



## PYETËSOR

<b>INTEGRITETI</b>		
Bartësit e funksioneve publike nuk do të duhej të ishin nën kurrfarë obligimi financiar apo tjetër ndaj individëve apo organizatave të cilat do të mund të ndikonin tek ata në kryerjen e detyrës zyrtare.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# INTEGRITETI

## SHEMBULLI nr. 2. Velja i premton Mrkonjës



Në fillim të muajit qershor 2009, lideri i „Nova Srbija“ Velimir Iliq dhe deputetët nga partia e tij kanë mundësuar arritjen e kuorumit në mënyrë që Kuvendi të fillojë me shqyrtimin e ligjeve, me të cilat Serbia obligohet në shumë prej 175 milion Euro në të mirë të ndërmarrjes publike „Rrugët e Serbisë“.

Më parë, në krye të kësaj ndërmarrjeje ka qenë Branko Josiq, një kuadro e Iliqit, kundër të cilit janë ngritur akuza për falsifikim të dokumenteve me të cilat buxheti është dëmtuar për 200 milion Euro.

Meqë shumica udhëheqëse në Kuvend nuk kishte numrin e mjaftueshëm të deputetëve, sepse tre prej tyre ishin në udhëtim, në mënyrë që të fillojë me shqyrtimin e dy ligjeve mbi kredinë për NP „Rrugët e Serbisë“, ndihmë ofroi Velimir Iliq – lideri i „Nova Srbija“. Precedenti që opozita të ofrojë ndihmë për arritjen e ku-

orumit, gjë që deri në atë kohë nuk kishte ndodhur kurrë dhe që vlen si rregull e pashkruar e Kuvendit, i befasoit të gjithë deputetët e shumicës udhëheqëse përveç socialistëve. Ata ishin të gatshëm. Lidhur me këtë rast, Velimir Iliq tha për një gazetë të përditshme që i kishte premtuar personalisht ministrit Milutin Mrkonjiq se do ti ndihmojë rreth votave në qoftëse nuk i mjaftojnë, këtë dhe e bëri.

Në kuluaret e Kuvendit, lëvizja e Velimir Iliqit, ish-ministrit për investime kapitale, shpjegohet me „mëkatet e tij të vjetra“ të lidhura me afarizmin e Branko Jociqit. Gjithashtu, vlerësohet që, me këtë sigurim të kuorumit të Kuvendit, socialistët i kanë forcuar pozicionet e tyre politike si parti që mund të bashkëpunojë në mënyrë efektive me të gjithë.

Kam votuar sepse më kanë lutur dhe se e di që punonjësit e ndërmarrjes së rrugëve janë në gjendje shumë të vështirë, meqë shteti nuk u paguan asgjë. Nuk kanë para për ushqim, nuk mund të marrin pjesë në tenderë për punë, nuk kanë para as për një litër naftë, ndërkohë që „Jugopertollit“ i kanë borxh 1 miliardë e 500 milion. Pesë qeveritë e mëparshme kishin premtuar se do t’ua paguanin paratë, por asgjë nuk është bërë. Ne jemi pajtuar në Komisionin për telekomunikacion, që këto dy ligje të votohen nga të gjitha partitë dhe nuk e di pse këtë nuk e bëri askush tjetër përveç nesh. Mrkonjiqi më ka lutur që ta ndihmojë rreth kuorumit dhe unë ia dhashë fjalën se do ta ndihmojë – sqaroi Velimir Iliq për një gazetë të përditshme.

## PYETËSOR

<b>INTEGRITETI</b> Bartësit e funksioneve publike nuk do të duhej të ishin nën kurrfarë obligimi financiar apo tjetër ndaj individëve apo organizatave të cilat do të mund të ndikonin tek ata në kryerjen e detyrës zyrtare.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# INTEGRITETI

## SHEMBULLI nr. 3. Slavica, honorariste e „Galenikës“

Sipas shkrimeve të mediave, nga fundi i qershorit 2009, kryetarja e Kuvendit të Serbisë Slavica Gjukiq-Dejanović ka arritur ta rregullojë mungesën në të ardhura, që e kishte prekur atë si të gjithë zyrtarët e shtetit me paga të larta. Duke iu falënderuar pozitës së fortë të partisë së saj socialiste në „Galenikë“, pak para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi uljen e përkohshme të pagave në administratën shtetërore, ajo ka lidhur marrëveshje me të cilën fiton 700 Euro në muaj për „shërbimet eksperte“ që ia ofron kësaj kompanie farmaceutike shtetërore. Dejanović, e cila me profesion është neuropsikiatër, me karrierë akademike në fakultetin e mjekësisë në Kragujevc dhe në klinikën psikiatrike të këtij vendi, më 27 prill 2009, ka nënshkruar kontratë njëvjeçare mbi vepër, dhe për këtë periudhë kohore ajo do të marrë nga 700 Euro çdo muaj, më së voni deri më datë 15 të muajit vijues. Për këtë shumë, nga kryetarja e Kuvendit të Serbisë pritet që të „përpilojë mendime eksperte dhe atë klinike-farmakologjike dhe farma-ekonomike për prodhimet farmaceutike të asortimanit të prodhimeve të porositësit“.

Përndryshe, është interesante që „Galenika“ dhe Slavica Gjukiq-Dejanović para kontratës së lartpërmendur mbi vepër kanë lidhur edhe marrëveshje për bashkëpunim afarist-teknik (numër 1185, i 3 prillit 2009) dhe atë pikërisht në kohën kur qeveria e Serbisë përgatiti propozimin e ligjit me të cilin, në kuadër të masave për kursim, parashihet ulja e pagave të mëdha të zyrtarëve të shtetit. Më interesante nga të gjitha është se Dejanović ka nënshkruar kontratë me „Galenikën“ më 27 prill, pikërisht në kohën kur në Kuvend vazhdonte shqyrtimi i propozimit të ligjit të lartpërmendur, i cili është miratuar më 29 prill.



Me sa është i informuar publiku, dy zyrtarët më të lartë të mbetur – kryetari i Serbisë Boris Tadiq (psikolog me profesion) dhe kryeministri Mirko Cvetković (ekonomist, ka punuar si këshilltar financiar), nuk kanë burime të ngjashme shtesë në të ardhurat e tyre. Për dallim prej tyre, duket se kryetarja e Kuvendit ka më shumë kohë dhe mundësi për ta mbushur buxhetin e saj.

Me këtë angazhim të saj, kryetarja e Kuvendit të Serbisë lehtë mund të gjendet në situatë ku nuk merr vendim që është në interes të publikut për arsye se ka detyrimet ndaj „Galenikës“, e cila paguan një pjesë të të ardhurave të saj mujore.

## PYETËSOR

<b>INTEGRITETI</b> Bartësit e funksioneve publike nuk do të duhej të ishin nën kurrfarë obligimi financiar apo tjetër ndaj individëve apo organizatave të cilat do të mund të ndikonin tek ata në kryerjen e detyrës zyrtare.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# OBJEKTIVITETI

Objektiviteti, si standard i jetës publike, duhet të sigurojë ushtrim të paanshëm të detyrave publike. Kjo nënkupton që kryerja e punëve publike nga zyrtari publik (zyrtarëve të organeve të pushtetit publik apo nëpunësve civil) është në funksion të të gjithë qytetarëve dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë. Ai përfshinë jo vetëm elementin e „jashtëm“, më saktë marrëdhënien e zyrtarit publik me klientët (qytetarët, ndërmarrjet apo çfarëdo palë të treta), por edhe elementin e qartë të „brendshëm“, posaçërisht kur bëhet fjalë për avancimin e kuadrove sipas sistemit të meritave.

*Objektiviteti nënkupton që në kryerjen e punëve publike, duke përfshirë këtu caktimin në funksione publike, ndarjen e vendeve të punës apo rekomandimin e individëve për shpërblime dhe përfitime, bartësit e funksioneve publike duhet të marrin vendime në përputhje me meritat dhe cilësitë e kandidatëve.*

Parimi i objektivitetit i plotëson dy parimet e përmendura më parë: mosegoizmin dhe integritetin. Përderisa te i pari dhe i dytë theksi vihet te mosegoizmi dhe integriteti si elemente subjektive të zyrtarit publik, parimi i tretë i vë theks objektivitetit – gjegjësisht paanësisë së saj. Domethënë, pavarësisht se kush është në anën tjetër, rregullat e „lojës“ janë të barabarta për të gjithë. Asnjë faktor i jashtëm si i tillë nuk guxon të ndikojë në përgjegjësinë e zyrtarit publik që të merr vendime rreth, për shembull, avancimin e kandidatëve ose ndarjes së kontratave sipas ndjenjës së tij/saj „subjektive“ apo „privilegjeve“ të supozuara që personi i tretë duhet t'i ketë, por ekskluzivisht sipas kritereve dhe standardeve objektive të vërtetuara paraprakisht.

Objektiviteti si standard i jetës publike siguron „plotësimin“ e kritereve të tilla, më së shpeshti, normative. Prandaj, objektiviteti mund të jetë kategori ligjore – kur shkelet ky parim, shpesh shkelet edhe norma ligjore. Por, për arsye të përmendura më parë, jo gjithmonë dhe jo në të gjitha rastet.

Për shembull, në rast të kufizimit të importit të një lloji të caktuar të mallit teknik, tekstilit, apo tjetër, afaristi ka interes që të gjendet në „listën“ e ndërmarrjeve që do të bëjnë importimin e kontingjentit të lejuar të mallit në Serbi, ndonëse nuk i plotëson të gjitha kushtet e parapara me ligj. Zyrtari publik ia lëshon atij lejen e nevojshme, me të cilën, duke i shkelur normat objektive të përcaktuara me ligj, ia mundëson që të gjendet në listën e furnizuesve dhe me këtë i mundëson importimin e mallit të tillë. Ky rast i shkeljes së parimit të objektivitetit më së shpeshti lidhet me korrupsionin dhe qenien e veprave penale të dhënies dhe marrjes së ryshfetit.

Shembull pasqyrues për një lloj tjetër të shkeljes së objektivitetit si standard i jetës publike do të ishte, për shembull, rasti kur Komisioni për prokurime publike, „duke peshuar“ se cili kandidat është më i „miri“, shpesh vlerëson marrëdhëniet që ka me ofertuesit. Në atë rast nuk është e rëndësishme vet oferta, por konfliktet personale të cilat i kanë pasur me ndonjërin prej tyre. Prandaj zgjedhin atë që nuk ka pasur konflikt personal me ta më parë, ndonëse ofertat e të tjerëve janë me më tepër *perspektivë* dhe më të *sigurta* për furnizuesin, ndërsa në periudhën afatgjate *ekonomikisht më të leverdishme*. Megjithëse e dinë këtë, anëtarët e Komisionit veprojnë

kundër gjykimit të tyre, por në pajtim me vlerësimin e lejuar diskrecional. Në rastin konkret, vlerësimi është kushtëzuar me arsye „personale“, e jo me arsyen e interesit publik, ndërsa „përfitimi“ i anëtarëve të Komisionit, konkretisht „hakmarrja“, ka bu-ruar nga një konflikt personal të anëtarëve dhe ofertuesve. Në këtë mënyrë, anëtarët e komisionit *nuk bëjnë veprë penale*, por sjellja e tyre është e pamoralshme, ndërsa pasojat e veprimeve të tyre të bëra me dashje mund të sjellin deri te dëmtimi i inte-resit të publikut dhe ekonominë vendore.

# OBJEKTIVITETI

## SHEMBULLI nr. 1.

### Edhe në kulturë mbretëron terrori partiak

Sipas shkrimeve të një gazete të përditshme, në fillim të muajit mars 2009, konkursi i hapur në fund të janarit për pozitën e kryesuesit në pesëmbëdhjetë institucione kulturore të qytetit u mbyll. Afati për dërgimin e aplikacioneve përfundoi më 13 shkurt, dhe ashtu si mund të mësohej në atë kohë në Sekretariatën për kulturë, kishin arritur 60 aplikacione të cilat ishin shqyrtuar më vonë. Pas kësaj informate të thatë administrative jozyrtarisht mund të mësohej se përkatësia partiake është kriter i rendit të parë dhe se partnerët e koalicionit kishin pasur përplasje të ndryshme mes tyre.



Komisioni për personel në kulturë (të cilën e përbëjnë nga dy anëtarë të SPS-së dhe LDP-së dhe tre anëtarë të Koalicionit për Serbinë Evropiane) kishte filluar punë në shtator të vitit të kaluar. Ishte arritur pajtim që të bëhet shpallja e konkursit publik dhe që, pa ndërhyrje partiake, të zgjidhen më të mirët nga kandidatët e paraqitur. Megjithatë, shumë shpejtë erdhi deri te konfrontimet ndërpartiake rreth zgjidhjes së drejtorit të arkivit, e më pas edhe për institucionet tjera, deri kur një grup parlamentar kërkoi që gjatë „ndarjes“ së presë partiake të vendosen kuota në kuptim të institucioneve të qytetit. Më pas, u bë kategorizimi i institucioneve, ndërsa vendimi së cila parti duhet ta ketë fjalën e fundit në cilin institucion është marrë me forma të ndryshme të bisedimeve dhe tregtive. Kështu, DS-së i takuan Ateleja 212, Teatri i dramës në Beograd, Muzeu i Beogradit, Arkivi historik, Qendra Rinore, Qendra Belef, Teatri „Boško Buha“, dhe Qendra për edukim artistik. LDP-ja do të vendosë për kryesuesit e Entit për mbrojtje të monumenteve të kulturës të Beogradit, Bifefit dhe Qendrës për Kulturë Mlladenovac, G17 plus për Teatrin Terazije dhe Qendrën për kulturë Llazarevac, ndërsa SPS për Muzeun Pedagogjik dhe Shtëpisë së trashëgimisë.

Pra, konkursi ka përfunduar. Mandati i kryesuesve dhe drejtorëve aktual skadon në fund të majit, por me mbylljen e konkursit, siç flitet në qarqe të ndryshme, nuk ka përfunduar oferta me emra dhe garat partiake. Jozyrtarisht mund të mësohet se ka pasur edhe trysni mjaft serioze nga qeveria e Serbisë, ndaj të cilave nuk kanë mbetur të paprekur as baballarët më të mëdhenj të qytetit. Megjithatë, duket se më të shumtë në numër janë ata që shpresojnë se ekziston edhe ndonjë pikë ndërgjegje dhe vullneti të mirë që nuk do t'i lejojnë interesat dhe kriteret partiake të zotërojnë mbi të gjitha tjerat, përfshirë këtu edhe mendjen e shëndoshë.



## PYETËSOR

<b>OBJEKTIVITETI</b> Në kryerjen e punëve publike, duke përfshirë këtu caktimin në funksione publike, ndarjen e vendeve të punës apo rekomandimin e individëve për shpërblime dhe përfitime, bartësit e funksioneve publike duhet të marrin vendime në bazë të cilësisë.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# OBJEKTIVITETI

## SHEMBULLI nr. 2. Licenca partiake për punë

Nga fundi i prillit 2009, në fokus të publikut ishte lajmi i publikuar në një gazetë të përditshme se ndërtimi i rrugëve dhe objekteve në veri të Kosovës dhe metohisë po shkakton dyshim te shumë individë. Sipas burimeve të gazetës, deputeti i DSS-së Vladimir Milintijeviq, kryetar i Komisionit për Kosovë dhe metohi në përbërjen e mëparshme të parlamentit, me vite të tëra i fiton shumicën e tenderëve që shpallen për ndërtimin e rrugëve dhe objekteve në veri të Kosovës. I lartpërmenduri ka deklaruar përsëri se në punët e firmës së tij nuk ka pasur kurrë, e as që do të ketë ndonjëherë diçka të jashtëligjshme, dhe se fjalët që puna e tij i kushton para të mëdha qeverisë është gënjeshtër, ku dhe shtoi se ka „kryer“ vetëm disa punë më të mëdha me çmim prej një milion Euro.



Është fakt i njohur që sistemi i kontrollit të financimit të komunave serbe në Kosovë me vite të tëra nuk është transparent. Në publik edhe më herët ngriheshin fjalë për mallverzime të shumta lidhur me financimin e pjesëve të caktuara të Kosovës nga buxheti i Republikës së Serbisë. Si ministri i mëparshëm Slobodan Samarxhiq ashtu dhe ai aktual për Kosovë dhe metohi Goran Bogdanoviq, kanë deklaruar se nuk janë kompetent për „verifikimin“ e tenderëve dhe procedurave të tenderimit në këto komuna.

Megjithatë, lideri i SNV-së të Kosovës qendrore Ranxhel Nojkiq ka deklaruar se Milintijeviqin e njoh prej kohësh dhe që e di mirë se sa punë ka firma e tij ndërtimore. Milintijeviqin e njoh që nga 2001, kur ende ishte një ndërtimtar i vogël. Në atë kohë, firma e tij duhej ta rregullonte kulmin e postës në Leposaviq. Shpejt më është bërë e qartë se ai është duke përzier diçka, sepse nuk kishte asnjë dokument, e as që mbante regjistër për punët e ndërtimore. Punën ja anulova. Më pas, ai përsëri provoi të kërkojë t'i paguhen para për, siç thoshte, punët shtesë. Sipas fjalëve të tij, pasi që u bë deputet i DSS-it, Milintijeviq ka depërtuar shpejt si ndërtimtar i suksesshëm. Më pas, asnjë punë ndërtimore në Kosovë nuk ka mundur të bëhet pa atë! Vetëm me atë, ose përmes ndërmjetësuesit të tij me të cilin i ndan paratë. Kështu ka qenë me vite të tëra, por vazhdon edhe sot. Është e qartë – Kosova ka qenë në kompetencat e DSS, kështu që janë organizuar mirë. Tani, Milintijeviq na është bërë afarist i madh – tregon Nojkiq.

Stojanka Petkoviq, deputete e G17 plus nga Zveçani, thotë gjithashtu se është një gjë e ditur se Milintijeviq i fiton të gjithë tenderët. Në mbledhjen e kaluar të Komisionit për Kosovë dhe metohi e ka pohuar para meje se i fiton të gjithë tenderët, por, siç shprehet ai, në këtë punë çdo gjë është e pastër – përfundon znj. Petkoviq, ku dhe deklaroi se ajo kishte folur hapur disa herë për këtë punë.

## PYETËSOR

<b>OBJEKTIVITETI</b>		
Në kryerjen e punëve publike, duke përfshirë këtu caktimin në funksione publike, ndarjen e vendeve të punës apo rekomandimin e individëve për shpërblime dhe përfitime, bartësit e funksioneve publike duhet të marrin vendime në bazë të cilësisë.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# OBJEKTIVITETI

## SHEMBULLI nr. 3. Kriteri – librezja e partisë

Ministri për ekonomi dhe zhvillim rajonal Mllaxhan Dinkiq i ka mashtruar disa kryetar të caktuar të komunave, të cilët janë të pakënaqur me mënyrën e ndarjes e mjeteve nga NIP (Plani kombëtar për investime) dhe me planin e ministrisë për ekonomi për zhvillimin e komunave, shkruan një gazetë ditore nga mesi i muajit prill 2009. Siç pohon kryetari i komunës së Pribojit, Lazar Rvoviq, lideri i G17 plus i ka mashtruar dy herë. „Të njëjtën ditë kur janë publikuar të ardhurat mesatare të janarit, ku te ne ato kanë qenë 10.880 dinarë, Priboji është hequr nga lista e komunave më të varfra me Rregulloren për kriteret e klasifikimit të komunave sipas zhvillimit! Nuk e di pse është bërë kjo?! Nuk kemi marrë asnjë dinar nga Fondi për zhvillim, ndërsa tani nuk marrim as nga NIP. Pres takimi me ministren Verica Kalanoviq që të na sqarojë se për çfarë bëhet fjalë“, i pakënaqur thotë Rvoviq. Kryetari i komunës së Pribojit madje pohon se Rregullorja e kriterëve të klasifikimit të komunave sipas zhvillimit as që është aprovuar në takimin e qeverisë.



Mllaxhan Dinikiq – ministër i ekonomisë dhe zhvillimit rajonal

dhënat statistikore janë të qarta. Priboji është në grupin e tretë sipas shkallës së zhvillimit, Nga 145 komuna, Priboji është në vendin e 96 sipas kriterit të vitit 2007. Sipas pagave, kjo komunë zë vendin e 96, ndërsa për nga pensionet gjendet në vendin e 18. Nuk është edhe aq e vërtetë ajo që paraqesin ata. Ne jemi në kontakt me kryetarin e komunës së Pribojit dhe shpresojnë se çdo gjë do të jetë në rregull. Por, është e qartë se me sulme të tilla nuk do të arrijnë asgjë – thuhet nga Ministria e ekonomisë.

Një qytet tjetër që ka ngritur zërin kundër mënyrës se si G17 plus e rregullon gjendjen në komuna është Novi Pazar. Nën kryetari i kësaj komune Vujica Tiosavljeviq i ka akuzuar drejtpërdrejtë „dinkiqët“ se po bëjnë diskriminim politik, duke pohuar se komuna ka pranuar mjete simbolike nga NIP „sepse nuk është në pronësi të G17 plus-it“.

Në ministrinë e ekonomisë dhe zhvillimit rajonal na thanë se Rregullorja e përmendur ende nuk ka hyrë në fuqi, por që të

## PYETËSOR

<b>OBJEKTIVITETI</b>		
Në kryerjen e punëve publike, duke përfshirë këtu caktimin në funksione publike, ndarjen e vendeve të punës apo rekomandimin e individëve për shpërblime dhe përfitime, bartësit e funksioneve publike duhet të marrin vendime në bazë të cilësisë.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# OBJEKTIVITETI

## SHEMBULLI nr. 4

### Në „Aeroport“ kërkojnë bonuse në lartësinë e dy pagave

Pas aferës së madhe lidhur me të ardhurat e ish-drejtorit të NP Aeroporti Beograd, kur gjatë vitit 2008 drejtori i përgjithshëm ia ka „ndarë“ vetës pagën prej 3600 Euro dhe një bonus shtesë prej 11.500 Euro, pas së cilit rast dha dorëheqje si rezultat i trysnisë së publikut, në fillim të muajit mars 2009 është paralajmëruar se publiku do të ketë qasje në informatat për të ardhurat e menaxherëve, përkatësisht drejtorëve dhe anëtarëve të bordeve drejtuese të ndërmarrjeve publike. Në atë kohë, në kushte të krizës së madhe ekonomike, personeli menaxhues i kësaj ndërmarrjeje i propozoi Bordit drejtues uljen e shumave maksimale për pagat e tyre dhe mundësinë që në vit të paguhet një bonus në shumën maksimale prej dy pagave të drejtorit.



Nga fundi i kësaj jave, kur Bordi drejtues i „Aeroportit“ mblihet dhe shqyrton këtë propozim të menaxhmentit, kryeministri Mirko Cvetković do ta kuptojë nëse janë përmbushur pritjet e tij që shteti do të „kursejë shumë“ me vendosjen e rregullit në sistemin e shpërblimit të drejtorëve të ndërmarrjeve publike. Shumica e drejtorëve, me të cilët kanë kontaktuar gazetarët në fillim të marsit, kanë pohuar se pagat e tyre dhe të anëtarëve të bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse u janë ulur që në fillim të vitit, si dhe që informacionet për të ardhurat në të ardhmen do të jenë në dispozicion në ueb-faqet e ndërmarrjeve të tyre, ashtu siç ka rekomanduar qeveria, e që më pas është bërë.

Megjithatë, lartësia e pagave të „ulura“ të drejtorëve, posaçërisht të atyre në ndërmarrjet publike që punojnë me humbje për vite me radhë ose që gëzojnë pozitë monopoli në treg, ka lënë përshtypje shumë të keqe te qytetarët e Serbisë.

## PYETËSOR

<b>OBJEKTIVITETI</b>		
Në kryerjen e punëve publike, duke përfshirë këtu caktimin në funksione publike, ndarjen e vendeve të punës apo rekomandimin e individëve për shpërblime dhe përfitime, bartësit e funksioneve publike duhet të marrin vendime në bazë të cilësisë.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# PËRGJEGJËSIA

Ushtrimi i funksionit publik nënkupton edhe përgjegjësi të caktuar për ushtruesin e atij funksioni. Prandaj, me kohë, në vendet perëndimore është kristalizuar standardi i *përgjegjësisë*, si një standard shumë i rëndësishëm.

*Parimi i përgjegjësisë nënkupton që bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe që duhet t'i nënshtrohen çdo kontrolli që zbatohet në funksionet e tyre.*

Në një shtet bashkëkohor të së drejtës, përgjegjësia është gjithashtu një prej standardeve themelore të së drejtës. Ai, si i tillë, nuk është vetëm standard i legjislacioneve kombëtare. Përgjegjësia, si njëri prej standardeve themelore të punës së administratës publike, përmes vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është bërë edhe njëri prej parimeve themelore të hapësirës administrative evropiane. Pa përgjegjësi nuk ka shtet bashkëkohorë të së drejtës, e as administratë publike, si një rregullator kompleks i proceseve shoqërore. Parimi ligjor i përgjegjësisë ka edhe kuptim të „zgjeruar“ përmes homologut të tij të personifikuar në normën etike. Këtu do të flasim vetëm për kuptimin e gjerë „etik“ të parimit të përgjegjësisë. Ky parim, si i tillë, është i rëndësishëm për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, mediat e pavarura dhe publikun në kuptimin e gjerë. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë „syri kujdestar“ i këtij standardi etik. Me punën, aktivitetet, kritikën, sugjerimet dhe daljet publike ata janë dhe „mbrojtës“ të parimit etik të përgjegjësisë. Çdo kontroll i nevojshëm i duhur i detyrave, nuk nënkupton të drejtën e zyrtarit që, më së shpeshti përmes shërbimit „të tij“ marrëdhënie me publikun, t'iu „përgjigjet“ kritikave apo t'ua „kthejë“ goditjen. Zyrtari i përgjegjshëm, para së gjithash, e ka për detyrë që të rivlerësojë sjelljen e tij në përputhje me kritikën e drejtuar. Domethënë, meqë pozita e „bartësit të funksionit“ apo „nëpunësit civil“ është gjithmonë superiore në raport me të gjithë personat e tjerë, si dhe me të subjektet tjera pjesëmarrëse në jetën publike, zyrtari i përgjegjshëm publik është ai që, pavarësisht nga „rejtingu“ apo pozita në shërbimin publik, „kupton“ dhe përpiket të përmirësojë sjelljen e tij, e jo ai që „sulmon“.

Kuptohet, kur „përgjegjësia“ përbën shkelje të ligjit, zyrtari përgjegjës publik përgjigjet ligjërisht, gjegjësisht bartë pasojat ligjore, si përmbajtje e elementit të normës ligjore. Thjeshtë, „funksioni“ i caktuar, qoftë politik apo profesional në kuadër të shërbimit (shtetëror) publik, në vete bartë dhe përgjegjësinë. Në fakt, jo vetëm përgjegjësinë, por edhe „përqendrimin“ e publikut. Prandaj, çdo fjalë e thënë e zyrtarit publik, si dhe çdo veprim i tij, nga pozita e „pushtetit“ që ka (sepse „pas këtij pushteti“ qëndron shteti si aparat me monopolin e detyrimit fizik në shoqëri), ka rëndësi të veçantë. Për shkak të kësaj „rëndësie të veçantë“, nga zyrtari publik kërkohet një shkallë shumë më e lartë e përgjegjësisë se sa që parashihet me të „drejtën“.

Formë shumë e rëndë e shkeljes së parimit të „përgjegjësisë“ është ndryshimi i ligjit në interes të personave të tretë. Kjo formë e shkeljes së parimit të përgjegjësisë është shumë i vështirë për t'u dëshmuar, sepse në të „merr pjesë aktive“ administrata dhe pushteti ekzekutiv i personifikuar në qeveri si dhe vet pushteti legjislativ. Kjo formë e shkeljes së parimit të „përgjegjësisë“ përfshinë një sërë zyrtarësh publik dhe



është i lidhur me procesin, i cili në këtë rajon quhet procesi i *manjatizimit*. Ajo sjell deri te ndryshimi i ligjeve dhe rregullave, në përputhje me interesat private të personave të pushtetshëm financiarisht. Pushtetarët financiar – manjatët, në këtë mënyrë kontrollojnë shtetin, sepse shteti krijon dhe i jep formë kornizës institucionale për kryerjen e aktiviteteve tregtare, sipas interesave të veçanta, private dhe të privilegjuara të atyre që janë të gatshëm t'i paguajnë të tjerët për promovimin e interesave të tyre, posaçërisht zyrtarët e „fuqishëm“ publik të cilët mund t'u shërbejnë. Në këtë mënyrë, shteti nuk është më „çështje publike“ (Res Publica) dhe bëhet shtet privat i pushtetarëve financiar, gjegjësisht „banane republikë“. Kështu, për shembull, standardi i „përgjegjësisë“ shndërrohet në „antipodin“ e tij. Duke u betuar në „ligjshmërinë“ e veprimeve të tyre, si bazë për „përgjegjësinë“ e tyre, zyrtarët publik ende vazhdojnë t'i shmangen me sukses çfarëdo sanksioni nga shkelja e këtij parimi, duke përfshirë këtu edhe atë morale.

# PËRGJEGJËSIA

## SHEMBULLI nr. 1.

### Përmes mëditjeve radikalëve u paguhet mirë pengimi i punës së Kuvendit të Serbisë

Ndalohet vetëm prodhimi i pakontrolluar i armëve kimike, ishte njëri prej ndryshimeve që radikalët e propozuan në Projektligjin për ndalimin e zhvillimit, prodhimit, deponimit dhe përdorimit të armëve kimike, i cili parasheh „ndalimin e prodhimit të armëve kimike“. Më saktë, me këtë ndryshim radikalët kërkojnë që të futet fjala „i pakontrolluar“, me të cilën i tërë ligji e humbet kuptimin, ndërsa ky është vetëm njëri prej 2800 ndryshimeve të cilat i ka propozuar grupi i SRS në ligje për të cilat është diskutuar në parlament gjatë muajit prill dhe maj 2009, me qëllim të pengimit të punës së tij.

Ky është gjithashtu një prej shembujve ku shihet se shkrimi i tërbuar dhe i pakuptimtë ndryshimeve tashmë është bërë praktikë e radikalëve në pengimin e punës së parlamentit, por edhe mënyrë për të marrë mëditje në emër të pjesëmarrjes në punën e komisioneve të Kuvendit.

Deputeti i Kuvendit Vlatko Ratkoviq, kryesues i Komisionit legjislativ të Kuvendit të Serbisë: „Që këto janë ndryshime të kota, të cilat nuk propozojnë ndryshime konstruktive, tregon fakti që deputetët e SRS-së,



në të shumtën e rasteve, propozojnë ose heqjen e të gjitha neneve, paragrafëve ose pikave të ligjit, ose kërkojnë ndryshimin e fjalëve të caktuara, pikave dhe nocioneve tjera gramatikore. Gati njëqind ndryshime, të cilat parashohin ndryshime gjuhësore dhe gramatikore, janë paraqitur vetëm në nenin 1 të Ligjit për përdorimin e flamurit, stemës dhe himnit, i cili e përkufizon temën e tij. Sipas fjalëve të tij, refuzimi i 3600 ndryshimeve, të parashtruara kryesisht nga SRS, do të zgjasë rreth 28 orë, ose tre ditë. Kjo nënkupton që, për këtë mbledhje, qytetarët do të paguajnë nga xhepat e tyre 15 milion dinarë më shumë, sepse çdo ditë pune e Kuvendit kushton së paku 5 milion dinarë, duke mos e llogaritur mëditjet që duhet t'i paguhet deputetëve dhe 2 milion dinarë shtesë për shtypjen e ndryshimeve.

Meho Omeroviq (kryesues i Komisionit për punë dhe çështje sociale i Kuvendit) me këtë rast, ka deklaruar për një gazetë të përditshme: „Më tragjike nga të gjitha është se në këtë mal ndryshimesh, të cilat janë parashtruar vetëm me qëllim të ngadalësimit të punës së Kuvendit, ndryshimet konstruktive të propozuara nga opozita nuk do ta marrin vëmendjen e duhur ose do të anashkalohen.“

## PYETËSOR

<b>PËRGJEGJËSIA</b> Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# PËRGJEGJËSIA

## SHEMBULLI nr. 2.

### Drejtoresha ka marrë çelësin dhe vulat

Në fillim të muajit qershor 2009, prindërit e fëmijëve në kopshtin parashkollorë „Radost“ në Çokë, janë përballur me një problem të madh. Institucion parashkollor kishte mbetur pa drejtor dhe pa Këshill drejtues, ndërsa prindërit protestonin se fëmijëve nuk kishte kush t’ua jepte vërtetimet që kanë vijuar mësimin parashkollor. Galina Bugarski, ishte u.d. e drejtorit, por më 21 maj 2009, asaj i kishte përfunduar mandati. Po atë ditë, ajo kishte marrë pushim shëndetësor, kishte kyçur vulën e institucionit, dhe kishte marrë me vete çelësin e zyrës si dhe çelësin e automjetit zyrtar.



Këshilli drejtues emëroi Danijela Saviqin, edukatore në IP „Radost“, si ushtruese të re të detyrës së drejtorit, por inspektori komunal për arsim e kishte anuluar vendimin, ndërsa këshilltarët e KK të Çokës e kishin shkarkuar Këshillin drejtues. Në mbledhjen e fundit të KK të Çokës, këshilltarët kishin debatuar për gjendjen në IP „Radost“ dhe rreth konkludimeve të Janosh Jastrebinac, inspektorit komunal për arsim, i cili e kishte bërë mbikëqyrjen në IP „Radost“. Këshilltarët e partisë opozitare SRS e kishin fajësuar partinë e DS në pozitë për gjendjen e krijuar në një kopsht në Çokë, ku qëndrojnë 400 fëmijë. Seanca përfundojë me vendimin për shkarkimin e Këshillit drejtues.

Fëmijëve të moshës parashkollore nuk ka kush t’ua lëshojë vërtetimet që kanë vijuar mësimin e programit parashkollor, të domosdoshëm për regjistrim në klasë të parë të shkollës fillore, sepse Galina Bugarski e ka kyçur vulën – tha në seancë Vukica Jovanov (SRS), këshilltare dhe edukatore, e cila ishte drejtoreshë e IP „Radost“ deri në vitin 2004. Ajo shtoi se janë bërë dy muaj që punonjësit e kopshtit nuk i kanë marrë pagat. Mandati i u.d. të drejtorit ka zgjatur gjashtë muaj, konkursi ishte shpallur me kohë, por është anuluar për arsye të panjohura – tha Vukica Jovanov. Për shkak të një situatë të tillë, ne punonjësit kemi kërkuar nga Hajnallka Llukovac (DS), kryesuese e Këshillit drejtues të „Radost“, që të thërret mbledhje, por ajo nuk i është përgjigjur thirrjeve tona. Me kërkesën e një të tretës së anëtarëve të Këshillit drejtues, që lejohet edhe me statut, mbledhja u thirr nga zëvendëskryesuesja e Këshillit drejtues Danijela Saviq. Kështu, me vendimin e pesë nga nëntë anëtarëve të këshillit drejtues, Danijela Saviq u emërua u.d. së drejtorit të „Radost“ – sqaroi Vukica Jovanov. Janosh Jastrebinac, inspektor komunal për arsim, konkludoi se mbledhja e Këshillit drejtues është thirrur në mënyrë të parregullt, sepse thirrjen për mbledhje e ka bërë zëvendës-kryesuesja, e cila mund ta bëjë këtë vetëm në rast të mungesës së kryesueses.

## PYETËSOR

<p><b>PËRGJEGJËSIA</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# PËRGJEGJËSIA

## SHEMBULLI nr. 3

### Qyteti humb miliona për shkak të evazionit fiskal

Në fillim të muajit mars 2009, një gazetë ditore publikoi informata ku thuhej që qyteti i Nishit është duke humbur miliona nga mosdeklarimi i pronës. Një numër i madh i objekteve banesore dhe afariste në Nish nuk është i paraqitur në administratën tatimore, për shkak të cilit qyteti, i cili para dy vitesh e ka marrë në kompetencë mbledhjen e tatimit në pronë, humb me dhjetëra miliona në vit. Autoritetet e qytetit kanë gjetur se numri i qytetarëve të cilët i shfrytëzojnë shërbimet komunale në Nish, madje 40 % më i madh se numri i tatimpaguesve që detyrohen sipas tatimit në pronë. Për këtë arsye, Këshilli i qytetit i ka urdhëruar ndërmarrjet komunale që t'ia dorëzojnë administratës së qytetit për financa të dhënat amzë të shfrytëzuesve të shërbimeve komunale, në mënyrë që të bëhet krahasimi me bazën e të dhënave të administratës lokale tatimore. Thjesht, me sa duket unazat e sistemit të vetëqeverisjes lokale në këtë qytet kanë dështuar, gjë që është reflektuar edhe në buxhetin e qytetit.



Problemi i përditësimit të bazës të të dhënave të tatimpaguesve të obliguar është paraqitur kur para dy vitesh pagesa e kësaj tarife ka kaluar në duart e Kuvendit të qytetit, sepse gjykatat dhe filialet e administratës tatimore

për shitblerjen e pronave nuk ia kanë dorëzuar të dhënat administratës të qytetit për financa. Vetëm nga fillimi i marsit, udhëheqësit e qytetit të Nishit kanë paralajmëruar se së shpejti do të fillonte puna vëllimore në terren e regjistrimit të pronës me komision. Supozohet se ndërtime të palajmëruara ka në të gjitha pjesët e Nishit, meqë shumë objekte banesore nuk janë të regjistruara në regjistrin e tokës, ndërsa në ndërkohë banorët i kanë blerë banesat shoqërore. Gjithashtu, supozohet që ka mjaft shtëpi të saponëduara që nuk janë lajmëruar në administratë tatimore. Këshilli i qytetit apelon tek bashkëqytetarët të cilët ende nuk e kanë lajmëruar pronën e tyre që këtë ta bëjnë sa më shpejtë, në mënyrë që në të ardhmen shpenzimet e tyre mos të rriten për pagesën e gjobave.

Thjesht, duket se unazat e sistemit të vetëqeverisjes lokale në këtë qytet kanë dështuar, që është reflektuar në mënyrë të konsiderueshme edhe në buxhetin e qytetit. Sidoqoftë, barra e këtij rasti bie pjesërisht edhe tek nëpunësit lokal civil.

## PYETËSOR

<p><b>PËRGJEGJËSIA</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# PËRGJEGJËSIA

## SHEMBULLI nr. 4

### Qeveria e Serbisë vonon kthimin e Projektligjit mbi shoqatat në procedurën e Kuvendit

Që në vitin 2002, në pajtim me obligimet që në atë kohë kishte Republika e Serbisë në kuadër të ish Republikës Federative të Jugosllavisë ndaj Këshillit të Evropës, një nga ministritë e atëhershme linjë kishte hartuar Projektligjin për asociacionet, i cili është dashur të rregullojë në mënyrë bashkëkohore dhe në përputhje me standardet demokratike ndërkombëtare fushën e lirisë së shoqërimit dhe statusin e shoqatave në Serbi. Sa për rikujtim, që nga fillimi i korrikut 2009, në Serbi ekzistojnë dy ligje nga kjo fushë, njëri nga niveli i dikurshëm federativ që ishte miratuar që në vitin 1990, dhe i dyti që është miratuar në vitin 1982 për territorin e Republikës së dikurshme Socialiste të Serbisë.

Doli që Projektligji për shoqatat me vite ishte „i lidhur“ me shpërbërjen e qeverive të ndryshme, duke u nisur nga qeveria e Zoran Zhivkoviqit, i cili erdhi pas vrasjes së kryeministrit të dikurshëm Zoran Gjinxhiq në vitin 2003, e deri të dy qeveritë e Vojislav Koshtunicës. Gjatë 6 viteve të kaluara, sa herë që ndonjë prej qeverive ka dërguar Projektligjin për asociacionet në procedurë të Kuvendit, qeveria është shpërbërë dhe janë shpallur zgjedhjet e reja parlamentare.

Nga fundi i 2008, filloi edhe një raund i „shqyrtimit“ në seancën e Kuvendit popullor. Për fat të keq, ligji u tërhoq përsëri nga procedura e Kuvendit, për sh-



kak të „prioriteteve“ që kanë pasur ligjet tjera nga fusha e gjyqësorit. Por, ndonëse Projektligji i mëparshëm për asociacionet tashmë ishte „shqyrtuar“ në hollësi nga deputetët, qeveria e Serbisë nuk e ka kthyer përsëri në procedurë të Kuvendit deri në muajin mars 2009.

Prandaj, më 6 mars 2009 mbrojtësi i qytetarëve Sasha Jankoviq ia

ka adresuar kryetarit të qeverisë Mirko Cvetkoviqit iniciativën që qeveria e Serbisë të fillojë sa më shpejtë me përcaktimin e Projektligjit për shoqatat e qytetarëve dhe t'ia dërgojë Kuvendit për miratim. Më vonë, qeveria përsëri e ka përcaktuar Projektligjin, por gjatë ndryshimeve, për të cilat kishte insistuar këshilli për reformën rregullative, regjistrimi dhe para-regjistrimi i është besuar Agjencisë së veçantë për regjistrimet ekonomike, që assesi nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare të lirisë së organizimit. Pas 7 vitesh, ligji më në fund është miratuar nga Kuvendi popullor më 9 korrik 2009.



## PYETËSOR

<b>PËRGJEGJËSIA</b> Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# PËRGJEGJËSIA

## SHEMBULLI nr. 5

### Zgjedhjet shpallen të pavlefshme për shkak të emrave në shkronja të alfabetit latin

Pas dekadave të kaluara me garanci kushtetuese të shkrimit latin dhe atij cirilik, Kushtetuta e Republikës së Serbisë e vitit 2006, e ka paraparë, si shkrim të vetëm „zyrtar“ – shkrimin në shkronja cirilike. Kuptohet, menjëherë duhet të rikujtohem në procesin e miratimit të Kushtetutës dhe të konstatojmë se vetë teksti i Projektligjit i vitit 2006, me të cilin është hequr shkrimi latin „formalisht dhe faktikisht“ si „shkrim“ zyrtar nuk i është nënshtruar asnjë „debati publik“, por marrëveshjes politike të parterëve të koalicionit në atë kohë.

Vet fakti që shkrimi latin nuk është shkrim zyrtar, ka ndikuar që, nga fundi i majit 2009, shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një vendvotim në Novi Sad.

Njëri nga zgjedhësit ‘u ankua’ pranë Këshillit zgjedhor në bashkësinë lokale „Sonja Marinković, se emri i tij në listën e zgjedhësve është shkruar në shkrimin latin prandaj dhe ka shprehur pakënaqësi. Banori anonim A.V. i Novi Sadit me këtë rast ka theksuar se nuk



dëshironte që emri i tij të shkruhej në shkrim latin, se shkrimi latin është „shkrim kroat“. Me statutin e qytetit të Novi Sadit është përcaktuar se në qytet gjuha serbe dhe shkrimi cirilik janë zyrtare. Domethënë, statuti i qytetit nuk parashikon përdorimin e shkrimit latin për gjuhën serbe, kështu që shkrimi latin nuk mund të përdoret zyrtarisht nga institucionet në zonën e qytetit.

Këshilli gjyqësor në Novi Sad me vendimin e tij e ka vërtetuar shkeljen e ligjit për arsye se anëtarja e komisionit zgjedhor e ka shkruar emrin e personit në fjalë nga Novi Sadi në shkrim latin, Komisioni ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin dhe Statutin e qytetit të Novi Sadit, kështu që zgjedhjet në këtë vendvotim janë anuluar.

Kryetari i Komisionit të zgjedhjeve Boris Pavlov, megjithatë, e ka njoftuar gjykatën, se shumica institucioneve dhe ndërmarrjeve shtetërore, si qeveria e Serbisë, Këshilli ekzekutiv të Vojvodinës ose „Elektroekonomia“ kanë ueb-faqe në internet në gjuhën serbe dhe shkrimin latin, por edhe me faktin që në listën zgjedhore „informatike“ emrat e qytetarëve duhet të shkruhen në shkrim latin, sepse të dhënat nuk do të jetë në dispozicion në shkrimin cirilik. Në mënyrë paradoksale edhe numri i referencës të vendimit gjyqësor, me të cilin anulohen zgjedhjet, mbanë shkronjën latine „R“.

## PYETËSOR

<p><b>PËRGJEGJËSIA</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrolli që zbatohet në funksionet e tyre.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# PËRGJEGJËSIA

## SHEMBULLI nr. 6

### Shkojnë në Beograd 20 herë për një leje



Komuna e Paraqinit ka vendosur që të hapë përfaqësi në Beograd, sepse më lirë iu del të marrin me qira hapësira dhe të paguajnë një njeri që do të punojë, se sa gjatë gjithë kohës t'i paguajnë shpenzimet e udhëtimit për ardhje të shpeshta në kryeqytet për arsye të administratës së ngadalshme të republikës.

Kështu banorët e Paraqinit pohojnë se duhet të shkojnë në Beograd deri 15–20 herë vetëm për një leje apo miratim të ndonjë projekti.

Për shkak të procedurave të ngadalshme administrative, udhëheqësit dhe nëpunësit e komunës në qarkun e Pomoravës në muaj shpenzojnë disa qindra mijëra dinarë për shkuarje në bisedime ose pas miratimeve nëpër ministritë në Beograd.

„Shpesh udhëtojmë për Beograd për të zgjidhur probleme të ndryshme dhe atë jo vetëm ne, zyrtarët e komunës, por edhe nëpunësit e ndryshëm, thonë në komunën e Paraqinit. Në muaj shpenzojmë rreth 200.000 dinarë për udhëtime dhe shpenzime të ndërlidhura me këtë. Për shembull, Nuk kemi mundur të numërojmë se sa herë na është dashur të shkojmë për të marrë pajtimin për shtrirjen e kabllos së tensionit të lartë në zonën industriale, të cilën është dashur ta marrim nga „Rrugët e Serbisë“. Për çfarëdo veprimi të mundshëm të shpalljes, marrjes së pëlqimit dhe çdo gjë që lidhet me dokumentacionin e projekteve, duhet të shkojmë 10 herë në ministrinë për planin nacional të investimeve. Kur kësaj t'i bashkëngjitet edhe ajo që për një dokument në dokumentacionin e projektit për paratë nga NIP-a nevojitet edhe pëlqimi i NP „Rrugët e Serbisë“, atëherë kjo është e barabartë me katastrofë. Shpesh na duhet të shkojmë në Beograd, në mënyrë që të mbajmë takim me ndonjë nëpunës, i cili mund të zgjasë nga 3 deri 5 minuta! Janë pikërisht këta nëpunës në ministri të cilët nuk dëshirojnë të kuptohemi përmes telefonit“ – tha Sasha Paunoviq, kryetar i komunës së Paraqinit. „Kemi vlerësuar se është më lirë të hapim një zyrë në Beograd dhe të punësojmë një person, ndërsa në kryeqytet punon një numër i madh i njerëzve nga qarku i Pomoravës. Në këtë mënyrë do t'u shmangeshim shpenzimeve të udhëtimit, shoferëve, amortizimit të automjeteve dhe shpenzimeve tjera“, – thotë Paunoviq.

Kryesuesit e komunës së Svilanjac gjithashtu pajtohen se bashkëpunimi i vetëqeverisjeve lokale dhe organeve të republikës është shpesh i ngadalshëm dhe i çuar deri në absurditet, dhe për këtë ata janë të gatshëm të mbështesin iniciativën e kryetarit të komunës së Paraqinit.

## PYETËSOR

<b>PËRGJEGJËSIA</b> Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# TË QENIT TË HAPUR

„Fshehtësia“ ka qenë gjithmonë bazë e mbijetesës në pushtet, fshehja e punëve të paligjshme dhe padrejta të bartësve të detyrave më të larta të funksioneve shetërore dhe nëpunësve civil, shpërdorimit dhe korrupsionit, që janë shenja kyçe të sistemit jodemokratik dhe të mbyllur. Për fat të keq, edhe në vendet me demokraci të zhvilluar ndodh shpesh që zyrtarët publik të „mbrohen“ pas fshehtësisë me qëllim të realizimit të ndonjë, interesi hipotetik „më të lartë“. Fatkeqësisht ky, sipas rregullit, nuk është rasti. Prandaj, në shumë vende transparenca konsiderohet „oksigjen“ i demokracisë, ndërsa sigurimi i „të qenit të hapur“ parim i së drejtës dhe etik.

Në qoftë se kthehemi edhe njëherë në dimensionin e saj tejnacional „të së drejtës“, si edhe te parimi paraprak, do të shohim se „të qenit të hapur“ si parim i së drejtës edhe në aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë sot konsiderohet një prej parimeve themelore të hapësirës administrative evropiane.

Megjithatë, *të qenit të hapur* është edhe njëri prej parimeve kyçe etike të standardit të jetës publike.

*Bartësit e funksioneve publike janë të obliguar të jenë sa ma të hapur që është e mundur lidhur me të gjitha vendimet dhe veprimet të cilat i ndërmarrin. Ata duhet t'i arsyetojnë vendimet e tyre dhe ta ndërpresin dhënien e informatave vetëm kur interesi i përgjithshëm i publikut e kërkon qartë një gjë të tillë.*

Prandaj puna, marrja e vendimeve dhe arsyetimi i vendimeve që burojnë nga kompetencat e zyrtarëve dhe nëpunësve civil duhet të jenë në dispozicion të publikut në masën më të madhe të mundshme, përveç në raste kur rregullat dhe natyra e punëve kërkon nevojën e ruajtjes së fshehtësisë në atë masë sa fshehtësia është e nevojshme në një shoqëri demokratike me qëllim të ruajtjes së interesit publik.

Prandaj, si parim etik të qenit të hapur e kërkon zyrtarin e „hapur“, në dispozicion të mediave, publikut dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, ky parim kërkon që vendimet dhe arsyetimet e vendimeve të personit zyrtar dhe nëpunësit civil, si të tilla, të jenë në dispozicion të publikut.

Kjo është e vetmja mënyrë se si qytetarët mund të fitojnë „përshtypje“ të drejtë për një person zyrtar, përkatësisht nëpunës civil dhe për punën e tij në „interes të publikut“. Domethënë, pikërisht „interesi publik“ të cilin e përfaqëson dhe e paraqet zyrtari publik është *conditio sine qua non* i standardit etik të „të qenit të hapur“.

Mosrespektimi i këtij parimi krijon mundësi për keqpërdorime të numërta. Korrupsioni është padyshim njëri prej manifestimeve të jashtme të shkeljes si të parimit të së drejtës ashtu edhe atij etik të „të qenit të hapur“.

Megjithatë, parimi i „të qenit të hapur“ nuk është „absolut“. Nga ai mund të ekzistojnë edhe përjashtime të caktuara. Megjithatë, përjashtimet e tilla duhet të arsyetohen me interesin „më të lartë“ të publikut. Në të kundërt, „përjashtimi“ i pohuar mund t'i shërbejë zyrtarit të pandërgjegjshëm publik si bazë për shkeljen e standardit të „të qenit të hapur“.

Në qoftë se kthehemi përsëri në rëndësinë e mbrojtësit të të drejtave të njeriut në shoqërinë demokratike, janë pikërisht mbrojtësit ata që më së shpeshti tregojnë për shkelje të standardit të së drejtës dhe etik të „të qenit të hapur „.

Prandaj, mbrojtësit e të drejtave të njeriut duhet të insistojnë edhe më tej deri në kufi të skajshëm që zyrtari publik, kur kjo të jetë e mundur, t'i kumtojë arsyet për marrjen e vendimeve të tij, që puna e tij të jetë në „dispozicion“ të të gjithëve dhe t'i ofrojë publikut informacione relevante për punën e tij.

# TË QENIT TË HAPUR

## SHEMBULLI nr. 1

### Shërbimet e qytetit dhe mafia e urbanizimit

Për vite të tëra me radhë, tek qytetarët e Beogradit ekziston mendimi i „përhapur“ se me qytetin e Beogradit „qeverisë“ mafia e urbanizimit. Ndjenja subjektive tek qytetarët është se kësaj situatë i kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme edhe nëpunësit e qytetit dhe të, të cilët, përmes procedurave jotransparente dhe duke i shfrytëzuar „zbrazëtirat“ në ligjet e ndryshme ose në marrëveshje me investitorët, e shkelin ligjin me vetëdije, gjë që ju siguron përfitime të mëdha materiale. Nga mesi i muajit qershor 2009, kryetari i komunës së Beogradit Dragan Xhilar ka kërkuar nga 17 komunat e Beogradit që për 30 ditë të dorëzojnë raport për ndërtimet e të gjitha objekteve deri në 80 metra katror në territorin e komunave të tyre, si dhe informacionet themelore për legalizimin e objektit, raportet e punës së inspektorateve dhe njëkohësisht ka paralajmëruar kallëzime penale kundër investitorëve të pandërgjegjshëm.

Me këtë rast, kryetari i komunës deklaroi: „historia për keqpërdorimet në urbanizim dhe ndërtimtari është bërë kaq e madhe sa që qyteti duhet të përcaktohet qartë ndaj këtij problemi. Nuk jam më i gatshëm t'i dëgjojë ankesat e



qytetarëve të cilët ankohen se në ndonjë banesë, në vend të katër kateve, janë ndërnuar shtatë ose të dëgjojë për objekte të paraqitura si garazhe, deri te cilat mund të arrihet vetëm me parashutë.

Këtë verë, në të gjitha komunat do të ndërmarrim një aksion të vendosur në mënyrë që të ndërpresim ndërtimin e tillë, ashtu siç kemi vepruar para disa muajsh kur mbyllëm me dhjetëra vend-ndërtime të pasigurta dhe ngritëm kallëzime penale kundër personave përgjegjës.

Nga kryetarët e komunave ai kërkoi që të paraqesin të dhëna rreth asaj se sa herë gjatë ndërtimit i ka kontrolluar inspektorati ndërtimor punët në objekte dhe a kryhen ato punë në pajtim me rregulloret dhe projektin. Në raport duhet të jenë edhe të dhënat për numrin e objekteve prej 80 metra katror, që ndërtohen sipas lejeve. Inspektorët duhet t'i vizitojnë të gjitha lokacionet në të cilat vazhdon ndërtimi dhe në rast se vërehet ndonjë ndërtim që nuk është sipas rregullave dhe projektit, menjëherë i ndërmarrin të gjitha masat që të ndalohet ndërtimi i tillë. Në qytet, ne do ta përsërisim aksionin e disa muajve më parë dhe do t'i kontrollojmë të gjitha objektet më të mëdha se 80 metra katror.



## PYETËSOR

<p><b>TË QENIT TË HAPUR</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# TË QENIT TË HAPUR

## SHEMBULLI nr. 2.

### Sekreti shtetëror dhe rasti i Milladin Kovaçeviqit



Më 19 shkurt 2009, publiku i Serbisë u informua se qeveria i kishte vënë shenjën „sekret shtetëror“ informacionit që thoshte se qeveria do të paguante një milion euro për ta heshtur problemin e krijuar në mes SHBA-së dhe Serbisë me rastin e veprimeve joligjore të organeve shtetërore të Serbisë, përmes të cilave Milladin Kovaçeviqit i është mundësuar largimi i paligjshëm nga territori i SHBA-së, i cili dyshohet se i ka shkaktuar

lëndime të rënda trupore një studenti amerikan vitin e kaluar.

Me vendosjen e shenjës sekret shtetëror në këto „informacione“, Qeveria e Republikës së Serbisë, e para së gjithash Ministria e punëve të jashtme dhe Ministria e drejtësisë, e kanë shkelur rëndë standardin i cili kërkon që puna e bartësve të funksioneve publike të jetë e hapur si dhe kërkesën që, për këtë vendim, të informohet publiku. Kështu, me shkeljen e standardit të jetës publike, është lëkundur edhe besimi i qytetarëve në ligjshmërinë e një veprimit të tillë. „Vizita“ e menjëhershme shtesë e inspektorit nga administrata e policisë kriminalistike në hapësirat e gazetës së përditshme „Borba“ më 20 shkurt 2009, për shkak të informimit të publikut për gjëra të cilat janë padyshim në interes të publikut, e ka dëmtuar besimin e qytetarëve për mundësinë dhe dëshirën e zbulimit të bartësve të (pa)ndërgjegjshëm të funksioneve publike.

Përcaktimi i përgjegjësisë i të gjithë bartësve të funksioneve publike, para së gjithash atyre në Ministrinë e punëve të jashtme të cilët e kanë mundësuar largimin e paligjshëm të Milladin Kovaçeviqit nga territori i SHBA, është prishur me zgjidhjen apo marrëveshjen milionëshe të shtetit të Serbisë dhe familjes së personit të dëmtuar. Dëmi që është shkaktuar me veprimet e paligjshme të përfaqësuesve të pushtetit për shkak të „ndihmës“ që i është dhënë një personi i cili është i dyshuar për kryerje të veprës së rëndë penale, është kompensuar me paratë e tatimpaguesve. Me këtë, në publikun e Serbisë edhe më shumë është forcuar bindja që pushteti është i papërgjegjshëm. „Mbrojtja“ e veprimit të tillë të qeverisë bazohej në vendosjen e shenjës „sekret shtetëror“.

Shenja e konfidentalitetit, përkatësisht e „sekretit shtetëror“ është vendosur në rastin Kovaçeviq me rekomandim të Ministrisë së punëve të jashtme. Me këtë rast, ministri për punë të jashtme Vuk Jeremiç deklaroi, mes tjerash, për televizionin publik RTS se do të bëjë çdo të mundur që problemi në rastin Kovaçeviq të zgjidhet në pajtim me ligjin, ndërsa deri në atë kohë, për arsye të zgjidhjes sa më të shpejtë, rasti do të jetë i klasifikuar si „sekret shtetëror“. Në anën tjetër, sekretari shtetëror i Ministrisë së drejtësisë Slobodan Homen deklaroi se qeveria nuk mund të flet për një vendim të tillë, pikërisht për arsye të shenjës së konfidentalitetit. Ai gjithashtu deklaroi se nuk mund të ketë dëmshpërblim deri në atë kohë me procedurë gjyqësore nuk vërtetohet fajësia e dikujt. Ndërsa, rasti i Kovaçeviqit nuk ka përfunduar as në SHBA, e as në Serbi. Homen gjithashtu theksoi se Serbia e kishte shkelur Konventën e Vjenës kur konsulli dhe zëvendëskonsulli i saj i lëshuan dokumente udhëtimi Kovaçeviqit dhe që kjo është përgjegjësi e saj.

## PYETËSOR

<p><b>TË QENIT TË HAPUR</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# TË QENIT TË HAPUR

## SHEMBULLI nr. 3.

### Qeveria ua shiti zyrtarëve 288 banesa me çmim më të ulët

Ministrat, deputetët, drejtorët e ndërmarrjeve publike dhe zyrtarë të tjerë në Serbi janë të vetmit që kanë privilegje që nën kushte shumë të mira, afat 20 vjeçar të pagesës, të blejnë banesa shtetërore. Vetëm gjatë dy viteve të fundit, madje 288 banesa të shtetit, të paguara me paratë e qytetarëve të Serbisë, kanë kaluar në duar private. Publiku nuk është i informuar për këtë, përveç në afëra sporadike, si ajo e ish-drejtorit të „Hekurudhat e Serbisë“, të cilit ndërmarrja publike në humbje i ka blerë banesë luksoze në Beograd.

Në përgjigjen e Bratisllav Pejkoviq, drejtor i drejtorisë për pronë, dhënë një gazete të përditshme në fillim të korrikut, thuhet që në bazë të rregullores për zgjidhjen e nevojave banesore të personave të zgjedhur, caktuar dhe të punësuar, të gushtit 2007, drejtoria republikane për pronë



ka nënshkruar 288 kontrata për shitblerjen e banesave shtetërore me sipërfaqe nga 24 deri në 107 metra katror. Çmimi sipas të cilit janë shitur banesat ishte nga 12.000 deri në 69.000 dinarë për metër katror. Banesat janë shitur kudo në Serbi, ndërsa janë blerë në bazë të rregullores së përmendur dhe marrëveshjes për blerjen e banesës, të cilat i kanë lidhur paraprakisht këta persona të privilegjuar me ndonjë nga ministritë apo organet e shtetit. Nga kjo informatë e vogël, të cilën ka arritur ta sigurojë një gazetë e përditshme pas një muaj insistimi në drejtorinë e pronës për t'i zbuluar të dhënat rreth shitjes së banesave të shtetit, rezulton se banesat janë shitur nga 130 Euro për metër katror, me mundësi pagese për 20 vjet.

Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetës së njëjtë se me çfarë çmimi janë shitur banesat e shtetit, drejtori i drejtorisë së republikës u përgjigj: „Çmimi i blerjes së banesave për të cilat janë lidhur kontratat për shitblerje, varësisht nga vlera e tregut të banesës, të cilën ka përcaktuar organi përkatës tatimor në përputhje me rregulloren në secilin rast konkret, ka qenë nga 12.000 deri 69.000 dinarë për metër katror“. „Sipërfaqja e banesave për të cilat drejtoria ka lidhur kontrata për shitblerje sillet nga 24 deri në 107 metër katror“. Duke e pasur parasysh që drejtori nuk është përgjigjur se kur është shitur banesa, kujt i është shitur dhe sa e madhe ka qenë mund të konkludohet që, në qoftë se banesat janë shitur në vitin 2007 kur drejtoria i ka nënshkruar kontratat e para për shitblerje dhe kur kursi i euros ka qenë shumë i ulët, metri katror i banesë është paguar nga 157 deri 907 Euro, që është shumë më ulët se sa çmimi i tregut të banesave në të cilat thirren këto organe shtetërore që kanë shitur banesat.

Qysh nga fundi i vitit të kaluar, kryeministri Mirko Cvetkoviq ia kishte kërkuar drejtorisë për pronë të dhënat për të gjitha banesat shtetërore dhe zyrtare me të cilat disponojnë organet e shtetit, si dhe informatat për gjendjen e tyre, kujt i janë shitur, kujt dhe me çfarë çmimi i jepen me qira, a paguajnë qiramarrësit rregullisht dhe të dhëna të ngjashme. Në mënyrë që të përballemi me korrupsionin, gjë që parashihet edhe me programin e kryeministrit Cvetkoviq si një ndër prioritetet me të cilat qeveria duhet të ballafaqohet, është e domosdoshme që të gjitha këto të dhëna të vihen në dispozicion të publikut.

## PYETËSOR

<p><b>TË QENIT TË HAPUR</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# TË QENIT TË HAPUR

## SHEMBULLI nr. 4.

### Mrka ia asfaltoi Tomës fshatin e vendlindjes!

Nga mesi i korrikut 2009, lideri i SNS-së Tomislav Nikoliq me ministrin Milutin Mërkonjiq dhe me zyrtarët të lartë të SPS-së kanë festuar me rastin e asfaltimit të rrugës që kalon përmes Bajçetinës së tij. Me vajza në veshje popullore, pogaçe, kripë dhe muzikë, Nikoliq e preu shiritin e kuq dhe e përuroi rrugën që kalon përmes maleve Glediçke, i cila nuk gjendet në rrugë të korridorit 10.



Së bashku me Nikoliqin dhe Mërkonjiqi ishin edhe zyrtarët e SPS-së Dushan Bajatoviq dhe Branko Ruzhiq, sekretari i Kuvendit Veljko Odaloviq, por edhe përfaqësues të DS-së dhe „bllokut popullor“. Gjatë përrurimit të rrugës, Nikoliq tha se kjo është ....“ditë e madhe për rajonin e shumadisë, nga i cili janë larguar shumë të rinjë për shkak të kushteve të këqija të jetës“. Me rastin e përrurimit të rrugës, Nikoliq iu urojë të gjithë banorëve të Bajçetinës (ku, sipas

pohimeve të gazetarit të një gazete ditore në të cilën ishte publikuar artikulli, jetojnë 25 amvisëri) që me shëndet ta gëzojnë rrugën, dhe që t'i ngasin veturat me shpejtësi të ulët dhe të kenë marrëdhënie më të mira fqinjësore. Pas fjalimit përshëndetës të nikoqirit Tomislav Nikoliq, të ftuarit u futën nën një tendë të madhe, që ishte vendosur mu në udhëkryqin e rrugës që çon deri te shtëpia e liderit të SNS-së (të cilit asfalti i ka arritur deri te pragu i shtëpisë) ku fillojë një festë popullore për të gjithë banorët e Bajçetinës dhe mysafirët e dashur.

Nikoliq dhe Mrkonjiq u afruan aq shumë sa që në një çast ministri e përqafoi dhe e mbështeti për gjoksi të parit të partisë „Napred Srbijo“. Kishite këngë, ngacmime edhe ndonjë fjalosje të vogël. Kuptohet, festa nuk kaloi pa ngacmime se a ka nën tendë më shumë balona të kaltër apo të bardhë dhe pse nuk shihet balonat e kuq. Borislav Busaraq, kryetar i KK Kniq, të cilës i takon Bajçetina, thotë se nuk e di se sa ka kushtuar rruga të cilën e ka përruruar Nikoliq. Të gjitha i ka bërë ministria për infrastrukturë, është asfaltuar rreth pesë kilometra rrugë që lidh fshatrat „Adžine livade“, Bajçetinë dhe Glediq. Bëhet fjalë për një rajon të bukur ku, para ndërtimit të rrugës, askush nuk ka dashur të blejë tokë. Tani, situata është ndryshe, theksoi Busaraq. Megjithatë, publiku nuk e ka të qartë se a është asfaltuar rruga se kështu duhej sipas planit të ndërtimit të korridorit 10, ose për shkak se Bajçetina është vendlindja e liderit të SNS-së Tomislav Nikoliq.



## PYETËSOR

<p><b>TË QENIT TË HAPUR</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrolli që zbatohet në funksionet e tyre.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# NDERSHMËRIA

Ndershmëria (sinqeriteti) është gjithashtu njëri nga shtatë standardet themelore të jetës publike.

*Gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, bartësit e funksioneve publike kanë për obligim që ta lajmërojnë çdo element të interesit privat,, si dhe të ndërmarrin hapa për zgjidhjen e konflikteve të mundshme të interesit në mënyrë të tillë që para së gjithash mbron interesin publik.*

*Ndershmëria dhe sinqeriteti duhet të jenë bazë për punën e tyre publike.*

Segmenti i këtij standardi etik është gjithsesi edhe ligjor. Bëhet fjalë për konfliktin e interesave gjatë kryerjes së detyrës. Megjithatë, në Serbi praktika ka treguar se kur bëhet fjalë për „konfliktin e interesit“, legjislacioni i Serbisë e „ngushton“ këtë nocion në mënyrë të konsiderueshme. Shumë afera të mëdha të cilat i kanë zbuluar, mes tjerash, mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë të lidhura pikërisht me „konfliktin e interesit“ me çfarë është zgjeruar mjaft e ashtuquajtura kornizë ligjore (e së drejtës).

Prandaj, kur e drejta nuk mund t’iu përgjigjet kërkesave dhe nevojave të kohës, përsëri kthehemi te etika dhe standardi etik i ndershmërisë (sinqeritetit).

Në kuptim etik, një pjesë e standardit që e quajmë „ndershmëri“, dhe i cili në njëfarë mase i referohet edhe konfliktit të interesit, mund të përcaktohet si detyrë të zyrtarit për të zbuluar çdo interes material dhe jomaterial privat, të huaj dhe të tjerë gjatë ushtrimit të funksion publik, por edhe obligimin për ndërmarrjen masave të duhura për t’iu shmangur konfliktit të mundshëm dhe për ta eliminuar konfliktin ekzistues të interesin.

Në një kuptim më të gjerë, ndershmëria përfshinë obligimin e zyrtarit publik që në çdo situatë, duke përfshirë edhe zgjedhjet, t’ia thotë publikut të vërtetën, pa varësisht nga pasojat.

Kështu, për shembull, gjatë fushatës zgjedhore, zyrtari i organit të pushtetit publik e ka për obligim që vetëm përmes programit dhe argumenteve të tij të luftojë për votat e zgjedhësve.

Gjithashtu, personi i tillë nuk guxon të përpiqet t’i sigurojë votat e zgjedhësve përmes shpifjeve, paraqitjes së të pavërtetave dhe ofendimeve, ose duke përdorur dhunë ose kërcënime, ose përmes shpërdorimit të detyrës ose ofrimit dhe premtimit të ofrimit për shërbimeve dhe kthim të shërbimeve.

Në kuptimin etik, ndershmëria nënkupton edhe veprime të sinqerta në jetën publike. Shpesh veprimet e zyrtarëve në shikim të parë na duken „të sinqerta“, por „në thelb“ nuk janë sepse përdoren kryesisht për të përmirësuar „imazhin e tyre“ në publik, gjë që në nuk është morale dhe nuk është në përputhje me këtë standard.





# NDERSHMËRIA

## SHEMBULLI nr. 1 „Tollovi“ në ndërtesën e Kuvendit të Serbisë

Pas shumë viteve, më 1 prill 2009, ish-ndërtesa e Kuvendit Federativ në Beograd, u bë ndërtesa e Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë. Megjithatë, që në seancën e parë të mbajtur në sallën e rinovuar të Kuvendit Popullor të Serbisë, takimi ishte anuluar pas vetëm 40 minutash pune, sepse radikalët, të cilët kryetarja Sllavica Gjukiq-Dejanović i kishte përjashtuar nga takimi, nuk pranorin të largoheshin nga salla. Pesëmbëdhjetë anëtarë të kësaj partie u dënuan sepse refuzuan të largohen nga vendet, të cilat me vendim të Këshillit administrativ ishin të rezervuara për deputetët e LDP-së.



Shpërndarja e vendeve në sallën e re të Kuvendit ishte vendosur në seancën e mbajtur më parë nga Këshilli administrativ, në të cilën morën pjesë përfaqësues të të gjitha partive parlamentare. Megjithatë, në seancën e Kuvendit, deputetët e SRS-së kishin ardhur më parë në sallë dhe i kishin zënë vendet e LDP-së. Deputetët e LDP-së nuk dëshironin të debatojnë me radikalët kështu që u ulën në ulëset e rezervuara për DSS-së. As deputetët e DSS-së nuk dëshironin të debatojnë me kolegët nga LDP-ja, kështu që ata u ulën në vendet e rezervuara për qeverinë.

Shpërndarja në sallën e re është „shumë e rëndësishme“, kjo edhe për faktin që deputetët nuk dalin për foltore por flasin nga vendet e tyre, atëherë kur kryetarja ua kç mikrofonin.

## PYETËSOR

<p><b>NDERSHMËRIA</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike kanë obligimin për të lajmëruar çdo interes privat, i cili ka lidhje me detyrën e tyre publike, si dhe të ndërmarrin hapa për zgjidhjen e konflikteve të mundshme në mënyrë të tillë që mbron interesin publik.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# NDERSHMËRIA

## SHEMBULLI nr. 2

### Drejtori i firmës së Peconit ishte në Kuvend

Drejtori i kompanisë „Monus“ Dejan Stankoviç, pas së cilës qëndron Predrag Rankoviç Peconi, është parë në Kuvendin e Serbisë në kohën kur është votuar ndryshimi për akciza, i cili u shkante në favor të prodhuesve vendor të cigareve, kështu kuptoi gazetari i një gazete të përditshme. Gazetari pastaj u përpoq të bisedonte me Stankoviçin, por nuk arriti të merr përgjigje. Në të njëjtën kohë, Kuvendi i Serbisë, në kërkesën e gazetarëve për t’iu ofruar atyre informata për njerëzit që e kanë vizituar Kuvendin gjatë atyre ditëve, u përgjigj se informacioni do të dorëzohet brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, ndonëse për publikun ishte me rëndësi të madhe që informacion ta marrë menjëherë, sepse „publiku ka të drejtë të di“ se kush hyn në Kuvendin e Serbisë.

Faktin që Ligji për akcizat është ndryshuar në mënyrë që kompania „Monus“ e Predrag Rankoviç Peconit të fitojë pozitë të privilegjuar e konfirmoi për një stacion televiziv edhe kryesuesja e grupit parlamentar G17 plus Suzana Grubjeshiq. Ajo deklaroi se pak para votimit të këtij ligji, njëri prej drejtorëve të kompanisë së Peconit është parë se si i viziton disa nga klubet e deputetëve në Kuvend.



Deputetët e opozitës, LSV dhe SVM, të cilët e përkrahën ndryshimin, vazhdojnë të pohojnë se këtë e kishin bërë për arsye shoqërore „në mënyrë që shtresa e varfër e shoqërisë të ketë se çfarë të pijë“, mundësi kjo që nuk përjashtohet edhe nga Nadada Kolundxhija, kryesuese e grupit parlamentar ZES.

Socialistët më herët i kishin refuzuar pohimet se partia e tyre financohet nga Peconi dhe, ashtu siç sqaroi Ivica Daçiq, me ndryshimin e kontestuar nuk kishin dashur ta favorizojnë „Invej“. Për dallim të liderit të partisë së tij, Branko Ruzhiq, i cili edhe e ka parashtruar ndryshimin e kontestuar, nuk ishte aq konkret. Në fakt, ai deklaroi se: „Mendoj se është tejet e parëndësishme se a ka ndodh kjo gjë apo jo. Shumë njerëz kanë hyrë, nuk shoh këtu diçka kontestuese edhe në qoftë se ka ardhur“..., duke refuzuar komentimin e mëtejshëm deri në atë kohë kur komisioni i qeverisë ta rishikojë arsyetimin social dhe ekonomik të ndryshimit të SPS-së. Në pyetjen, a është mirë që përfaqësuesit të kompanive të mëdha llojnë nëpër Kuvend, Ruzhiq tha se nuk ka të dhëna se ka ndodhur një gjë e tillë.

Nada Kolundxhia, kryesuese e grupit parlamentar ZES, thotë se nuk ka njohuri se me ftesë të kujt kanë ardhur përfaqësuesit e „Monusit“ në Kuvend. Sa i përket sjelljes së socialistëve, Kolundxhia thotë se kjo hapë së paku dy çështje. E para, si është e mundur që nëse qeveria e Serbisë e miraton njëzëri tekstin e ligjit, anëtarët e koalicionit qeverisës sillen ndryshe. Ndërsa e dyta, a është e mundur të bëhej vlerësim i gabuar meqë ndryshimet si të tilla nuk duhet të jenë të kontestueshëm. Vërtetë, ato i privilegjojnë ata që prodhojnë cigare më të lira, por kjo mund të arsyetohet në rastin kur ndryshimi është depozituar që të mos ketë ngritje të çmimit të cigareve të lira, në mënyrë që të mos i shkurtohej shtresës së varfër të shoqërisë mundësia për të pirë cigare – konkludoi Kulundxhia.

## PYETËSOR

<p><b>NDERSHMËRIA</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike kanë obligimin për të lajmëruar çdo interes privat, i cili ka lidhje me detyrën e tyre publike, si dhe të ndërmarrin hapa për zgjidhjen e konflikteve të mundshme në mënyrë të tillë që mbron interesin publik.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# NDERSHMËRIA

## SHEMBULLI nr. 3. Krkobabiq i riu – fsheh pasurinë

Komisioni i republikës për zgjidhje të konfliktit të interesave i ka rekomanduar Milan Krkobabiqit, nënkryetarit të komunës së Beogradit, të japë dorëheqje nga ky funksion, për shkak se nuk kishte dorëzuar raportin për pasurinë dhe të ardhurat e tij. Krkobabiq nuk dëshironte të komentonte përse nuk e kishte dorëzuar raportin për pasurinë dhe të ardhurat e tij, si dhe rreth asaj se a do ta respektonte rekomandimin e Komisionit të republikës.



Në takimin e mbajtur nga mesi i qershorit, Komisioni ia parashtrroi masën e deklarimit publik të rekomandimit që të ofrojë dorëheqje për mosdorëzim të raportit për pasuri dhe të ardhura Krkobabiqit, këshilltarit të kuvendit komunal Grocka, z. Vladan Zariq, dhe këshilltarit të kuvendit komunal Savenski Venac, z. Nebojsa Raschet. Për akumulim të funksioneve, Komisioni ka iniciuar procedurë kundër anëtarit të Këshillit të qytetit të Beogradit Goran Krecloviq, i cili përveç kësaj detyre, kryen edhe detyrën e kryetarit të Këshillit drejtues të Agjencisë për medikamente dhe pajisje mjekësore.

Meqë Krkobabiq nuk veproi sipas rekomandimit, nga fundi i qershorit, Komisioni i republikës shqiptoi masën e deklarimit publik të rekomandimit drejtuar nënkryetarit të komunës që të japë dorëheqje nga ky funksion. Arsyeja për këtë është se, as pas paralajmërimit të bërë paraprakisht, Krkobabiq nuk e dorëzoi raportin për pasurinë, të ardhurat, dhe funksionet publike të tij.

Vendim i komisionit të republikës është publikuar në „gazetën zyrtare“, në të cilën theksohet se Krkobabiq ka vepruar kundër dispozitës së Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, dhe se nuk e ka përmbushur obligimin e tij.

## PYETËSOR

<p><b>NDERSHMËRIA</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike kanë obligimin për të lajmëruar çdo interes privat, i cili ka lidhje me detyrën e tyre publike, si dhe të ndërmarrin hapa për zgjidhjen e konflikteve të mundshme në mënyrë të tillë që mbron interesin publik.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtë)</p>		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formuloni ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

# NDERSHMËRIA

## SHEMBULLI nr. 4. Fjalosja midis Nikoliq dhe Shutanovac rreth eksportimit të armëve

Në fillim të qershorit, seanca e Kuvendit popullor në të cilën përfaqësuesit e qeverisë u përgjigjeshin pyetjeve të deputetëve, u shënuar me një polemikë mes kryesuesit të grupit parlamentar „Napred Srbijo“ të Tomislav Nikoliqit dhe ministrit të mbrojtjes Dragan Shutanovac rreth asaj se kush i përfaqëson interesat e kujt.



Nikoliq theksoi se Shutanovac i përfaqëson interesat e kompanisë „Jugoimport SDPR“ dhe që për këtë i „ka shkatërruar së paku dy eksportues privatë të armëve“. Në këto pohime, Shutanovac u përgjigj se është plotësisht normale që si ministër ai përfaqëson interesat e ndërmarrjeve publike, e jo të atyre private, duke shtuar se Nikoliq i përfaqëson interesat e lobit që e financon për ta sulmuar atë.

Në vërejtjen e ministrit, Tomislav Nikoliq u përgjigj se ministri do të duhej të ishte më serioz gjatë daljeve të tij publike. As ministri Shutanovac nuk i mbeti borxh kur iu përgjigj se: „Nuk jam arrogant, por ndoshta Nikoliqit mënyra e prezantimit tim i duket arrogante sepse nuk e ka ndërgjegjen e qetë“.

Publiku i gjerë mbeti i pasqaruar se a kishin këta të dy interesa të caktuara private në punët importuese-transportuese lidhur me tregtinë e armëve, dhe se a kanë ndërmarrë hapa për zgjidhjen e konflikteve të tilla në mënyrë që të mbrohet interesi publik.



## PYETËSOR

<b>NDERSHMËRIA</b> Bartësit e funksioneve publike kanë obligimin për të lajmëruar çdo interes privat, i cili ka lidhje me detyrën e tyre publike, si dhe të ndërmarrin hapa për zgjidhjen e konflikteve të mundshme në mënyrë të tillë që mbron interesin publik.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtë)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

## SHEMBULLI PERSONAL

Parimi i fundit nga shtatë parimet etike është veprimi sipas shembullit personal. Shembulli personal është bazë për punë të drejtë, të ndershme, të paanshme, të hapur dhe të përgjegjshme të zyrtarit publik, i cili duke i respektuar personalisht standartet e jetës publike „apelon“ edhe tek pjesëmarrësit e tjerë që të veprojnë ngjashëm apo njëlloj. Prandaj, sa më i lartë të jetë zyrtari i organeve të pushtetit publik, aq më shumë rëndësi do të ketë veprimi sipas shembullit të tij tek rrethi i gjerë i zyrtarëve më të „ulët“ dhe bartësve të tjerë të funksioneve publike, duke përfshirë edhe nëpunësit civil.

*Bartësit e funksioneve publike duhet t'i nxisin dhe avancojnë këto parime përmes udhëheqjes dhe shembullit personal.*

Domethënë, zyrtarët e organeve të pushtetit publik janë ata të cilët përmes shembullit sjelljes etike u japin shembull zyrtarëve dhe nëpunësve civil. Prandaj, gjatë mandatit të tyre, zyrtarët janë të obliguar që gjatë ushtrimit të detyrave publike, por edhe në jetën private, të sillen në mënyrë të tillë që nuk e dëmton reputacionin e funksionit që kryejnë. Sjellja e tillë pasqyrohet drejtpërdrejtë edhe përmes raportit me bartësit tjerë „më të ulët“ të funksioneve publike, para së gjithash me nëpunësit civil.

Prandaj në raportet me nëpunësi civil, zyrtari i organit të pushtetit publik duhet të veprojë me respekt. Veprimi me shembull personal „hapë“ edhe obligimin e zyrtarit që të mos mbrojë zyrtarët më të „ulët“ të funksioneve publike, të cilët me veprimet e tyre si në ushtrimin e detyrave apo marrëveshjeve ashtu edhe në jetën private e dëmtojnë reputacionin e organit ku janë të punësuar.

Veprimi me shembull personal i bartësit të funksionit publik, gjithashtu nënkupton që, në marrëdhëniet apo raportin e tyre me qytetarët, bartësit e funksioneve publike duhet të veprojnë me korrektësi, mirësi, sinqeritet, si duhet, ndershmërisht, në mënyrë objektive dhe të paanshme, duke treguar interesim dhe durim për problemet e tyre, ndërsa në raport me zyrtarët dhe nëpunësit tjerë, konfliktet personale dhe animoziteti nuk guxojnë të ndikojnë në ushtrimin e detyrave dhe punëve që u janë besuar. Kur ekzistojnë konflikte të tilla, në interes të funksionit publik, ato duhet të tejkalohen sa më shpejtë që është e mundur.



# SHEMBULLI PERSONAL

## SHEMBULLI nr. 1

### Shkelja e dinjitetit të funksionit gjatë diskutimin në kuvend

Në fillim të prillit 2009, diskutimin për Projektligjin për partitë politike në Kuvend e shënoi një polemikë e shkurtër ndërmjet deputetit të LDP-së dhe ministrit përgjegjës Milan Markoviq, me rastin e propozimit që për themelimin e partisë, në vend të numrit të deritashëm të nevojshëm 100, është e domosdoshme mbledhja e 5000 nënshkrimeve të qytetarëve. Deputetja e LDP-së Vesna Peshiq vlerësoi se ky propozim është më kufizues se ligjet dhe rregulloret që e kishin rregulluar këtë fushë në kohën e Millosheviqit. Diskutimi ndërmjet deputetes dhe ministrit, i cili e „mbronte“ propozimin ligjor, kaloi në debat të zhurmshëm i cili në një moment eskaloi edhe me përdorim të fjalëve dhe termeve vulgare dhe akuzave të ndryshme të pabazuara.



Ministri Milan Markoviq dhe deputetja e Kuvendit Vesna Peshiq

Gjatë debatit, deputetja Peshiq tha: „Ne nuk kemi punë tjera përpos që në këtë kohë krize të vrapojmë dhe t'i mbledhim e regjistrojmë 5000 nënshkrime dhe të paguajmë nga 50000 dinarë për çdo nënshkrim. Zonja Peshiq gjithashtu bëri pyetje se a është kjo ndonjë aktivitet i ri buxhetor që po tentohet t'iu imponohet partive. „A jeni ju të pagëzuar? A jeni ju normal apo jo? Përse do të duhesha unë të ju informojë se ku kam organizim territorial, e ku nuk kam, bëri pyetje deputetja Peshiq, duke theksuar se me ligjin e propozuar preket në të drejtat themelore të qytetarëve për organizim. Më pas, ajo kërkoi nga ministri Markoviq që ta tërheq...“këtë ligj idiot“.

Duke reaguar në pohimet e deputetes Peshiq, ministri Markoviq theksoi që ajo nuk e di dallimin midis grupeve të partive dhe partisë politike. „Pas 20 vitesh marrje me politikë ju nuk dini të bëni dallim mes grupit të qytetarëve dhe partisë politike. „Kam mbrojtur 16 apo 17 ligje dhe, me përjashtim të zonjës Vesan Peshiq, askush nuk më ka fyer në Kuvend“, tha Markoviq.

Në fund të polemikës Markoviq i kërkoi falje deputetëve Peshiq dhe Koraq nëse i ka fyer, ndërsa Peshiq ka kërkuar falje nëse toni i saj ka qenë „ndoshta pak më i ngritur sepse vërtet ishte e habitur“.

## PYETËSOR

<b>SHEMBULLI PERSONAL</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i nxisin dhe avancojnë këto parime përmes udhëheqjes dhe shembullit personal		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimeisht këtë standard të jetës publike?		

# SHEMBULLI PERSONAL

## SHEMBULLI nr. 2

### Në vend të arrestimit, vetëm fjalë për korrupsion

Kryetari i Serbisë dhe lideri i demokratëve Boris Tadiq kohës së fundit çdo ditë e më tepër dhe më ashpër flet për korrupsionin në shtet dhe partitë politike, por në praktikë nuk shihen rezultate. Kështu, nga fundi i majit 2009, kryetari i Serbisë, në kuvendin e përgjithshëm të DS-së vlerësoi që „të gjitha partitë janë të përfshira në korrupsion të thellë“ dhe se „askush nuk është imun në asnjë parti“. Sigurisht, gjatë muajit vijues nuk ndodhi asgjë e rëndësishme në këtë drejtim. Me rastin e këtij fjalimi të kryetarit Tadiq, kryetari i grupit të vendeve për luftë kundër korrupsionit (GRECO) Drago Kos theksoi se angazhimi kundër korrupsionit në këtë mënyrë, e madje edhe vetë ndryshimet në legjislacion, kanë pak rëndësi pa ndryshime serioze në praktikë.



Në raportet e Komisionit Evropian për përparimin e Serbisë në integrimet evropiane korrupsioni renditet lartë si një prej problemeve kryesore që duhet të zgjidhet në Serbi. Kushti lidhet edhe me vendosjen e vendit tonë në listën e bardhë të shengenit. Si burim i korrupsionit janë identifikuar partitë politike për shkak të financimit jotransparent dhe të pakontrolluar, si dhe prokurimet publike nga të cilat, sipas vlerësimeve të fundit të organeve të pavarura, humb 400 milion euro në vit. Të dy burimet e korrupsionit janë të lidhura me ndërmarrjet publike të cilat i mbajnë partitë politike.

Kur flitet për prokurimet publike përmes të cilave paratë nga financat publike rrjedhin në drejtime të ndryshme të pakontrolluara, GRECO ka pranuar ankesa dhe parashtrësia konkrete nga Serbia. Gjithashtu, në deklaratën e tij për një gazetë të përditshme, Kos ka deklaruar gjithashtu se në Serbi të gjitha institucionet të cilat duhet të merren me luftën kundër korrupsionit janë të penguar, dhe se u merret pavarësia menjëherë pas arritjes të rezultateve fillestare të mira.

## PYETËSOR

<b>SHEMBULLI PERSONAL</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i nxisin dhe avancojnë këto parime përmes udhëheqjes dhe shembullit personal		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimeisht këtë standard të jetës publike?		

# SHEMBULLI PERSONAL

## SHEMBULLI nr. 3

### Më lehtë është lyerja se marrja me politikë

Rasim Ljaiq, ministri për punë dhe politika sociale i Serbisë, ka paralajmëruar sot se ministria e tij, në bashkëpunim me ministrinë e ekonomisë dhe planifikimit hapësinor, është duke përgatitur strategjinë e veprimit të përgjegjshëm shoqëror.

Duke marrë pjesë në aksionin vullnetar „Beogradi Ynë“, në shkollën fillore për fëmijët e verbër dhe me shikim të dobët, Ljaiq tha se sot në lokacione të ndryshme 250 vullnetar do të promovojnë përgjegjësinë e kompanive.



„Po punojmë në projekte të mbrojtjes së natyrës, avancimit të drejtave dhe pozitës së fëmijëve dhe përmirësimit të pozitës së të moshuarve, theksoi Ljaiq pasi që e ndihmoi shkollën duke e lyer një mur të saj. Ljaiq tha se kjo nuk është hera e parë që lyente dhe se kjo është shumë më e lehtë për t’u bërë se sa të merresh me politikë.



## PYETËSOR

<b>SHEMBULLI PERSONAL</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i nxisin dhe avancojnë këto parime përmes udhëheqjes dhe shembullit personal		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

# SHEMBULLI PERSONAL

## SHEMBULLI nr. 4 Deputetët paramendojnë se janë „aktorë“

Në fund të janarit, „tenisi“ shkaktojë shtyrje të seancës së Kuvendit të Serbisë. Turneu i tenisit në Melburn, të drejtat për transmetim të së cilit i ka blerë transmetuesi publik, përkatësisht RTS, si dhe transmetimi i hendbollit dhe kuvendi i Shën Savës, ka sjellë deri te ndërprerja e seancës së Kuvendit. Meqë RTS ka pasur „punë më të rëndësishme“, as deputetë e Kuvendit të Serbisë nuk kanë dashur të punojnë pa transmetim të drejtpërdrejtë të seancës së Kuvendit. Pyetjes së gazetarit se si shumica qeverisëse ka lejuar që të shkurtohet orari i punës së Kuvendit për shkak të transmetimit të ngjarjeve sportive, kryesuesja e seancës së kuvendit Gordana Çomiq vetëm i ka ngritur krahët, derisa mosinteresimin e dukshëm të deputetëve për të punuar pa transmetim të drejtpërdrejtë e kundërshtuan vetëm deputetët e LDP-së.

Megjithatë, vështirë mund të thuhet se edhe në këtë periudhë kohore të shkurtuar, nga ora 12 deri në orën 15:20, është punuar seriozisht sepse deputetët nuk kanë debatuar sipas rendit të ditës, por mbledhja disa herë resht ka kaluar në fjalosje reciproke ndërmjet SRS-së dhe SNS-së, gjatë së cilës radikalët trokisnin në dysheme dhe tavolina, duke krijuar një zhurmë të padurueshme sa herë që në foltore dilte kryesuesi i grupit parlamentar „Napred, Srbijo“ Tomislav Nikoliq.

Në mënyrë që qytetarëve të Serbisë mos t’iu „shkurtohej“ mundësia e përcjelljes së këtyre skenave të shëmtuara, kryesuesja Çomiq deklaroi që edhe ditën vijuese parlamenti nuk do të fillojë me punë si rregullisht në orën 10:00, por fillimi i seancës do të shtyhej për në orën 13:00. Gjegjësisht, në orët e pasdites, RTS-ja duhej të fillonte



përsëri me transmetimin e ndeshjes së tenisit nga Australia. Për këtë, Çomiq ka deklaruar se transmetimi i drejtpërdrejtë televiziv i seancës sot do të zgjasë deri në orën 20:00.

Në konsultimet e Çomiq me grupet parlamentar, është bërë ofertë që seanca të vazhdojë, por që transmetimi të transmetohet më pas, gjë që nuk është pranuar. Në vazhdim të seancës, për shkak të mosrespektimit të in-

stitutionit, kryesuesja e seancës gjatë ditës së djeshme përsëri u ka dhënë disa vërejtje radikalëve sepse kanë pamundësuar diskutimin sipas rendit të ditës për zgjidhjen e delegacioneve të përhershme në institucionet ndërkombëtare parlamentare, duke u lajmëruar sipas rregullit dhe duke goditur dyshemenë me këpucë ose tavolinat me stilolapsa sa herë që në foltore dilte dikush nga partia „Napred Srbijo“.

## PYETËSOR

<b>SHEMBULLI PERSONAL</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i nxisin dhe avancojnë këto parime përmes udhëheqjes dhe shembullit personal		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formuloni ju shkurtimeisht këtë standard të jetës publike?		

# SHEMBULLI PERSONAL

## SHEMBULLI nr. 5

### Komisioni republikan për zgjedhje dhe konflikti i interesit

Gjatë shkurtit 2009, besimi i publikut në institucionet demokrati u luhat seriozisht me zbulimin e ekzistimit të konfliktit të interesit të shumicës së anëtarëve të rizgjedhur të Komisionit republikan për zgjedhje, në të cilin më tej ndikoi publikimi i lartësisë së të ardhurave të anëtarëve të Komisionit republikan për zgjedhje. Duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij institucioni për rendin demokratik, si dhe faktin që disa nga anëtarët e Komisionit për zgjedhje bartës të funksioneve më të larta të gjyqësisë, ky rast përfaqëson shembull të shkeljes së rëndë të standardit të ndershmërisë, por edhe të standardeve tjera të përmendura të jetës publike.

Sipas raporteve të mediave vendore, anëtarët e Komisionit republikan për zgjedhje, shumica e të cilëve përkundër Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare janë bartës të funksioneve të dyfishta, ia kanë rritur vetës shpërblimet e parapara për punë. Mediat kanë publikuar se në vend të 60.770 dinarëve, me bonuse, vetës ia kanë paguar deri në 700.000 dinarë në muaj dhe që kanë caktuar nga dhjetë seanca në javë, në mënyrë që të mund të marrin shuma milionëshe.

Gjithashtu, për anëtarë të veçantë të KRZ-së (Komisionin republikan për zgjedhje) janë zgjedhur familjarë të afërt dhe bashkëshortët/et të deputetëve të Kuvendit (bashkëshortja e deputetit të Kuvendit Zorana Krasiq dhe motra e deputetes së Kuvendit Vjerica Radeta).

Gjykatësja i Gjykatës Supreme të Serbisë, Sonja Brkiq dhe ministrja e drejtësisë Snezhana Maloviq, në kundërshtim me kërkesat që imponojnë standardet e jetës publike për veprim me shembull personal, e kanë shkelur ligjin për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesit në dy mandate.

Gjykatësja Brkiq në shumë raste ka demantuar publikisht se ajo nuk është në konflikt të interesit. Në



Në fund, nën trysninë e publikut, megjithatë ajo dha dorëheqje. Epilogu i një tjetër afere serbe, në të cilën individë të caktuar kanë mbushur xhepat me paratë e të gjithë qytetarëve të këtij shteti është që vetëm ministrja Snezhana Maloviq, përveç dorëheqjes, ka kthyer shumë prej dy milion dinarë, ndërkohë që të tjerët, disa nga të cilët kanë marrë më shumë se ajo, kanë konsideruar se me dorëheqje i kanë vënë pikë „tregimit të KRZ-së“, dhe se mund të vazhdojnë qetësisht të merren me ndonjë punë tjetër të cilën, për çudi, gjithashtu e paguajnë qytetarët e këtij shteti.

## PYETËSOR

<p><b>SHEMBULLI PERSONAL</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike duhet t'i nxisin dhe avancojnë këto parime përmes udhëheqjes dhe shembullit personal</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formulonit ju shkurtimeisht këtë standard të jetës publike?</p>		





PODRŠKA RAZVOJU NEPROFITNIH STRUKTURA

Pjesa e tretë

**Hulumtim:**

**Forcimi i kapaciteteve të mbrojtësve lokal  
të të drejtave të njeriut dhe prezantimi  
i standardeve të jetës publike në Serbi**





## **Hulumtim:**

# **Forcimi i kapaciteteve të mbrojtësve lokal të të drejtave të njeriut dhe prezantimi i standardeve të jetës publike në Serbi**

Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut – „YUKOM“, me përkrahjen e delegacionit të Komisionit Evropian për Republikën e Serbisë, është duke realizuar projektin e forcimit të kapaciteteve të mbrojtësve lokal të të drejtave të njeriut dhe prezantimi i standardeve të jetës publike në Serbi.

Qëllimi themelor i projektit është ofrimi i ndihmës për organizatat e shoqërisë civile të cilat merren me probleme që bien në fushën e gjerë të mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe mundësimi i pluralizmit të organizatave të shoqërisë civile në rajonet e Serbisë. Gjithashtu, qëllim i këtij projekti është edhe zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të reja lokale joqeveritare të cilat do të merreshin me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndërkohë që ato ekzistuese forcohen për kryerje të suksesshme të rolit në luftën për respektim të vazhdueshëm të të drejtave të njeriut dhe standardeve të jetës publike, përmes vendosjes së një mekanizmi të qëndrueshëm të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

Në kuadër të këtij projekti ProConcept, si organizatë partnere, ka kryer hulumtim në mesin e organizatave të shoqërisë civile, me qëllim të përcaktimit të gjendjes dhe të nevojave të shoqërisë civile të cilat do të ishin të kyçura në fazën vijuese të projektit.


## **GJETJET E HULUMTIMIT**

Hulumtimi është bërë në periudhën maj 2009 për nevojat e projektit Forcimi i kapaciteteve të mbrojtësve lokal të të drejtave të njeriut dhe prezantimi i standardeve të jetës publike në Serbi, i cili realizohet nga Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut – YUKOM, me përkrahjen e delegacionit të Komisionit Evropian për Republikën e Serbisë.

Ftesa për pjesëmarrje në hulumtim i është drejtuar OJQ-ve drejtpërdrejtë përmes internetit më rreth 160 e-mail adresa, përmes shpalljes në ueb-faqen e organizatës burimore Qendra për Zhvillim dhe Sektorin Joprofitabil (CRNPS) dhe përmes listës postare të Agjencisë së qytetit për bashkëpunim me OJQ-të. Ftesës iu përgjigjën 57 organizata nga të cilat 24 organizata e kanë plotësuar pjesërisht pyetësorin (mbi 1/3 të përgjigjeve) ndërsa 15 e kanë plotësuar tërësisht pyetësorin. Pyetësori ka mundur të plotësohet edhe në formën „online“ dhe si Word dokument, i cili u është shpërndarë organizatave sipas kërkesës. Duke e pasur parasysh numrin e dërguar të pyetësorëve dhe numrin e organizatave që janë përgjigjur, mund të flasim edhe për kapacitetin „e vogël bashkëpunues“ të OJQ-ve si dhe solidaritetit të pazhvilluar kur bëhet fjalë për hulumtime të rëndësishme për vënien në hartë të problemeve dhe përpjekje për gjetjen e zgjidhjeve. Meqë nuk është ndikuar në përzgjedhjen e organizatave, atëherë mostra mund të konsiderohet e duhur dhe nga informacionet e marra mund të shihen tendencat, të cilat mund të tregojnë në ligjshmëri të caktuara në punën e organizatave të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.


Gjysma e organizatave që kanë marrë pjesë në hulumtim janë themeluar para vitit 2000, ndërsa gjysma tjetër pas vitit 2001 (Diagrami 1.).

**Diagrami 1. Viti i themelimit të OJQ-së?**




Numri më i madh i tyre vjen nga territori i Beogradit, pastaj Vojvodinës, ndërsa më së paku ka nga Serbia perëndimore, lindore dhe jugore. (Shih Diagramin 2)

**Diagrami 2. Vendi i selisë së OJQ-së**




Po të shikohet në raport me rajonin gjeografik në të cilin veprojnë, konkludohet se numri më i madh i organizatave aktivitetet e tyre i realizojnë në nivelin nacional, gjegjësisht republikan, në bashkëpunim me organizatat nga shtetet tjera, derisa një numër më i vogël i organizatave janë të përqendruara në nivelin lokal (komuna, qytetit) (Shih Diagramin 3).

**Diagrami 3. – Niveli i veprimtarisë së OJQ-ve**




Në kuptim të karakterit, rezultatet e hulumtimit tregojnë se shumicën e organizatave të mbrojtjes të të drejtave të njeriut e përfaqësojnë organizata të cilat merren me tema si: të drejtat e pakicave dhe ato të njeriut dhe toleranca, zhvillimi i shoqërisë civile, mundësi të barabarta dhe mbrojtja në kuptimin më të gjerë të mundshëm. Rezultatet tregojnë përqendrim të vogël apo të dobët profesional në fusha të veçanta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përkatësisht se nuk ka organizata të profesionalizuara posaçërisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (shih Diagrami 4).

**Diagrami 4. Fushat e veprimit të OJQ-ve**



Organizatave që kanë marrë pjesë në hulumtim merren me grupet vijuese të shoqërisë: romët, rininë, viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, pakicat nacionale, fetare, dhe seksuale, përfaqësues të institucioneve të shtetit, personave me aftësi të kufizuara, dhe me refugjatë dhe persona të zhvendosur.

Në kuptim të financimit të organizatave, dominojnë organizatat ndërkombëtare (14 organizata financohen nga ky burim), Buxheti i Serbisë (10 organizata financohen nga ky burim) buxhetet e vetëqeverisjeve lokale (7 organizata financohen nga ky burim) dhe fondeve të BE-së (6 organizata financohen nga ky burim) (shih Diagramin 5).



**Diagrami 5. Burimet e financimit të OJQ-ve**

Mënyra e komunikimit me organizatat tjera të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut është kryesisht e karakterit joformal dhe ad hoc, që nënkupton se organizatat lidhen vetëm gjatë realizimit të projekteve ose ndonjë iniciative tjetër. Në anën tjetër, ka më pak prani të rrjetëzimit ose formave të tjera të lidhjes programore apo organizative ndërmjet organizatave, siç është p.sh. Rrjeti i komiteve për të drejta të njeriut në Serbi, CHRIS.

**Tabela 1. Raporti i OJQ-ve me rrethin**

	bashkëpunoni në masë të madhe me	bashkëpunoni në masë të vogël me	vihen në konflikt në masë të vogël me	nuk kemi kontakte
Me OJQ tjera që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut	37,5%	37,5%	12,5%	12,5%
Me OJQ që nuk merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut	50,0%	37,5%	12,5%	

	bashkëpunoni në masë të madhe me	bashkëpunoni në masë të vogël me	viheni në konflikt në masë të vogël me	nuk kemi kontakte
Organet e vetëqeverisjes lokale	37,5%	62,5%		
Mediat lokale	50,0%	50,0%		
Ekspertët lokal	50,0%	50,0%		
Institucionet e arsimit të mesëm	37,5%	50,0%		12,5%
Institucionet e arsimit të lartë	37,5%	50,0%		12,5%
Institutet shkencore	25,0%	12,5%		62,5%
Organet e shtetit		62,5%		37,5%
Ndërmarrjet nga komuna apo qyteti juaj	12,5%	25,0%	12,5%	50,0%
Shoqatat tregtare	12,5%			87,5%
Shoqatat profesionale	37,5%	12,5%		50,0%

Raporti ndërmjet organizatave pjesëmarrëse në hulumtim dhe rrethit në të cilin vepronë karakterizohet me bashkëpunim, me ekzistimin e një numri shumë të vogël të organizatave me hisedarë lokal (vetëqeverisja lokale, mediat, OJQ-të tjera, ekonomia, partitë politike..). Duke e pasur parasysh vlerësimin negativ të gjendjes së të drejtave të njeriut, e cila është vërtetuar edhe me gjetjet në këtë hulumtim, një shkallë e tillë e „bashkëpunimit“ dhe mosekzistimit të konfrontimit sjell në pyetje legjitimitetin dhe kapacitetet e organizatave pjesëmarrëse në hulumtim.

Si instrumente të veprimit të tyre, Kushtetutën e përdorin gjysma e organizatave, një e treta e përdor Ligjin penal, derisa në punën e tyre gati të gjitha organizatat thirren në Ligjin e punës dhe Ligjin për parandalimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara.

Shumica e organizatave i zbatojnë rregulloret ndërkombëtare në punën e tyre. Megjithatë, dy e treta e respondentëve konsideron se thirrja në rregulloret ndërkombëtare ka efekt në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, ndërsa një e treta e konsideron se thirrja në rregulloret ndërkombëtare nuk kontribuon në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Kur flitet për sistematizimin e të dhënave dhe evidentimin e rezultateve të punës së organizatave, mund të konkludohet që një numër i vogël i organizatave (33%) kanë bazë të të dhënave, gjegjësisht të evidencës së rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut, dhe i përdorin instrumentet ndërkombëtare në mbajtjen e evidencës dhe përpunimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Gjysma e organizatave i përdorin instrumentet ndërkombëtare në mbajtjen e evidencës së rezultateve dhe punës.

Kur bëhet fjalë për përpilimin e raporteve, 60% e organizatave nuk përpilon raporte mbi aktivitetet dhe rezultatet e arritjeve të tyre që i kushtohen prezantimit publik. Nga organizatat që përpilojnë raporte, 67% të atyre raportet i përdorin për fushata, 60% për iniciativa legjislative, gjysma për iniciativa qytetare dhe 83% për veprime në nivel lokal.<sup>4</sup>

Në drejtim të vlerësimit të gjendjes së të drejtave të njeriut në periudhën para vitit 2000, tek respondentët të cilët kanë qëndrim për këtë, përfaqësohen vlerësime të barabarta se janë pakësuar llojet dhe shpeshtësia e shkeljeve të drejtave të njeriut (20.7%). Ndërsa, 16,7% mendojnë se është ulur vetëm shpeshtësia e shkeljes së të drejtave të njeriut. Çdo e pesta organizatë pjesëmarrëse në hulumtim mendon se janë pakësuar vetëm disa lloje të shkeljes së të drejtave të njeriut, derisa 16,6% janë të mendimit se nuk ka kurrfarë ndryshimi në raport me periudhën e mëparshme. Pjesa e mbetur e respondentëve, më pak se 30%, konsideron se nuk mund të japë vlerësim për ekzistimin e ndryshimit në shkeljen e të drejtave të njeriut për periudhën e caktuar.

Si mënyrë me efikase për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, 71 % e respondentëve e shohin zgjidhjen në insistimin që shteti t'i merr përsipër detyrimet e parapara me ligjet e miratuara, ndërsa çdo i gjashti (6) respondent e shih zgjidhjen në angazhimin e qytetarëve dhe ekspertëve përmes organizatave joqeveritare, më pak se 5% konsiderojnë se vet procesi i integritetit në BE do të kontribuojë në uljen e numrit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në Serbi.

Në kuadër të projekteve të tyre, OJQ-të më së shumti janë marrë me fushat vijuese: parandalimin e diskriminimit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, lirinë e shprehjes, të drejtat për organizim shoqëror, të drejtave kulturore dhe të pakicave. Kur bëhet fjalë për të drejtat e pacientit, konsumatorit, të drejtat sindikale, të drejtat për banim, e drejta për gëzim të qetë të pronës, të drejtat në kujdes shëndetësor dhe sigurisë sociale, me këto të drejta nuk merret gati askush.

Sipas mendimit të pjesëmarrësve në hulumtim, prioritet për organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në rend të parë, do të duhej të ishte: parandalimi i diskriminimit; e drejta për jetë; ndalimi i torturës, veprimi çnjerëzor apo poshtërues; e drejta në lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, e drejta për arsimi; e drejta për mbrojtje të familjes; të drejtat e pacientit; dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. (Shih Tabelën 2)

**Tabela 2. Të drejtat që duhet të avancohen domosdoshmërisht**

	Rangu i parë	Rangu i dytë	Rangu i tretë	Rangu i katërt
Parandalimi i diskriminimit	12,5%	37,5%		25,0%
Të drejtat në jetë	37,5%			12,5%
Ndalimi i torturës, sjelljes çnjerëzore apo poshtëruese ose	12,5%	25,0%		
Ndalimi i torturës, sjelljes çnjerëzore apo poshtëruese ose			25,0%	

4 Shuma e përqindjes është mbi 100% sepse respondentët kanë mundur të zgjedhin më shumë se një përgjigje

	Rangu i parë	Rangu i dytë	Rangu i tretë	Rangu i katërt
E drejta për liri dhe siguri të individëve dhe veprimet me individë				12,5%
E drejta për gjykim të drejtë			12,5%	
E drejta për mbrojtje të jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës				
E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë	12,5%			
E drejta për t'u shprehur		12,5%		
Të drejtat e anëtarëve të komuniteteve				
Të drejtat politike, e drejta për organizim politik dhe partiak		12,5%		
Mbrojtja familjare			12,5%	
të drejtat martesore				12,5%
Mbrojtja e veçantë e fëmijëve			12,5%	12,5%
E drejta për punë			12,5%	
Të drejtat e pacientit	12,5%			12,5%
të drejtat e konsumatorit		12,5%		
E drejta për arsim			25,0%	
E drejta për siguri sociale	12,5%			12,5%

Me këtë temë lidhet edhe vlerësimi i situatës së të drejtave, e cili është negativ. Përkatësisht, nëse shohim Tabelën 3, vërehet se përqindja e pjesëmarrësve në huluntim vetëm në një numër të vogël të rasteve e ka vlerësuar situatën si pozitive.

**Tabela numër 3. Përqindja e OJQ-ve të cilat e vlerësojnë pozitive situatën e të drejtave të renditura**

	vlerësim pozitiv
Parandalimi i diskriminimit	18,20%
Të drejtat në jetë	45,50%

	vlërësim pozitiv
Ndalimi i torturës, veprimi çnjerëzore apo poshtërues apo dënimit	36,40%
Trafikimi me qenie njerëzore dhe kontrabandës me njerëz	27,30%
E drejta për liri dhe siguri personale dhe veprimi me njerëzit e privuar nga liria	27,30%
E drejta për gjykim të drejtë	18,20%
E drejta për mbrojtje të jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës	27,30%
E drejta për liri të mendimit, ndërgjegjes dhe fesë	45,50%
Liria e shprehjes	63,70%
E drejta për tubim paqësor	45,50%
Liria e organizimit	63,70%
E drejta për gëzim të lirë dhe të papenguar të pronës	18,20%
Të drejtat e anëtarëve të pakicave	36,40%
Përdorimi i gjuhës	27,30%
Të drejtat politike, e drejta për organizim politik dhe partiak	45,50%
Të drejtat zgjedhore	54,60%
Mbrojtja e familjes	27,30%
Të drejtat martesore	27,30%
Mbrojtja e veçantë e fëmijëve	27,30%
Liria e lëvizjes	54,60%
Të drejtat ekonomike	18,20%
Të drejtat sociale	0
Të drejtat kulturore	27,30%
E drejta për punë	9,10%
Të drejtat sindikale	27,30%



	vlërësim pozitiv
E drejta për banim	18,20%
Mbrojtja shëndetësore	18,20%
Të drejtat e pacientit	9,10%
Të drejtat e konsumatorit	0
E drejta për mjedis të shëndosh jetësor, të drejtat ekologjike	0
E drejtat për arsim	0,273
Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	0,182

Kur bëhet fjalë për formimin e vlerësimeve të dhëna paraprakisht, për rëndësinë e tyre flasin të dhënat se 53% e organizatave i kanë dhënë vlerësimet e tyre në bazë të punës në projekte, gjegjësisht të dhëna të marra nga qytetarët të cilët kanë qenë viktima të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Në të njëjtën kohë, 36% e organizatave e bazojnë vlerësimin e tyre në raportet e OJQ-ve të tjera të cilat merren me të drejtat e njeriut.

Të pyetur se me cilën grup të të drejtave do të merreshin në të ardhmen, duke i pasur parasysh kapacitetet e organizatave të tyre, shumica e OJQ-ve e konsideron se ka burime për: parandalimin e diskriminimit, të drejtën për lirinë e organizimit, të drejtat e pakicave, të drejtat për qasje në arsim, të drejtën për liri të shprehjes. Fushat për të cilat organizatat e anketuara nuk kanë kapacitete të mjaftueshme janë: trafikimi ne qenie njerëzore dhe kontrabanda e njerëzve, e drejta për punë, të drejtat sociale, të drejtat e mbrojtjes sociale, të drejtat për sigurim sociale.

Njohuritë që mungojnë, në radhë të parë, janë në fushën e: burimeve të mbledhjes së të dhënave dhe informimit, huluntimit dhe dokumentimit, avokimit publik, njohjes më të mirë të ligjeve relevante për fushat që kanë të bëjnë me të drejtat e përmendura, ngritja e motivimit të vullnetarëve dhe qasjes në literaturë profesionale. Nga organizatat që kanë plotësuar anketën, asnjëra nuk di, gjegjësisht nuk ka dëgjuar për konceptin e „shtatë parimeve të veprimit publik“.

Mesatarisht 80 deri 90% të organizatave të cilat morën pjesë në huluntim e konsiderojnë se „shtatë parimet e veprimit publik“ në Serbi ende nuk zbatohen kur është fjala për nivelet e ndryshme të pushtetit (nga ato lokale deri te niveli i republikës).<sup>5</sup>

## KONKLUDIM

Në nivelin e lëvizjeve të „të drejtave të njeriut“, në Serbi ekziston nevoja për „specializim të bashkërenduar“ i cili, do të nënkuptonte nga njëra anë që kontaktet ekzistuese joformale të formalizohen në një formë të bashkërendimit, me specializi-

5 Çdonjëri prej shtatë parimeve është sqaruar hollësisht në pyetësor.

min e njëkohshëm për lloje të veçanta të të drejtave. Bashkërendimi do të ishte në funksion të vendosjes së sistemit të monitorimit të drejtave të njeriut, këmbimit të informatave dhe edukimit e cila do të ishte pikërisht në funksion të specializimit të individëve dhe organizatave.

Krijimi i bazës së të dhënave të shoqërisë civile për shkeljet e të drejtave të njeriut, e cila do të ishte në shërbim të të gjitha organizatave dhe e cila do të kishte metodologji të pranueshme dhe ndërkombëtarisht të përputhshme të mbledhjes, verifikimit, arkivimit dhe analizimit të gjendjes së shkeljes të të drejtave të njeriut.

Programi trajnues, i cili do të ishte në funksion të edukimit të organizatave të cilat merren me të drejtat e njeriut, si dhe organizatave të cilat merren me grupet të cilat janë objekt i shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Kur e vendosim informacionin për qasjen jokonfrontuese ndaj organeve të shtetit në kontekst të vlerësimit se gati 50% e organizatave konsideron se që nga viti 2000 në Serbi nuk është përmirësuar situata e respektimit të të drejtave të njeriut, shtrihet pyetja për çfarë arsye organizatat kanë një qasje të tillë kryesisht jokonfrontuese? Këtë fenomen mund ta shohim duke e pasur parasysh mungesën e kapaciteteve të vet organizatave ose, si rezultat i rregullave të padefinuara të funksionimit të organizatave të shoqërisë civile, e para së gjithash në fushën e financimit, marrëdhënieve të punës dhe rregullave tjera të rëndësishme për mbijetesën dhe veprimtarinë e organizatave. Prandaj, është e nevojshme që të punohet në ngritje të kapaciteteve të organizatave në mënyrë që të jenë të pavarura dhe plotësisht kritike në aktivitetet e tyre.

Gjithashtu, jemi të mendimit se do të ishte mirë që t'i kushtohej vëmendje edhe fushës së financimit të organizatave që është kryesisht e natyrës së projekteve, ndërsa bazohet në realizimin e projekteve individuale dhe, kryesisht, projekteve ad hoc. Një strukturë e tillë e financimit shkakton edhe diversifikimin e keq të donatorëve, si dhe mundësi të vogël të planifikimit financiar, gjë që shkakton pasiguri financiare afatgjate të organizatave.

SHTOJCA I  
Këshilli i Lartë i Shërbimit Civil  
Kodi i sjelljes i nëpunësve civil



Në bazë të nenit 164. pika 2 e Ligjit për shërbimin civil („Gazeta Zyrtare RS“, nr. 79/05, 81/05 – përditësuar, 64/07 dhe 67/67 –përditësuar),

Këshilli i Lartë i Shërbimit Civil nxjerrë:

## **KODI I SJELLJES TË NËPUNËSVE CIVIL**

### **Qëllimi i Kodit**

#### **Neni 1.**

Qëllimi i këtij Kodi është që t'i përcaktojë më në hollësi standardet e integritetit dhe rregullat e sjelljes të nëpunësve civil të organeve të administratës shtetërore, shërbimeve të qeverisë dhe shërbimeve profesionale të qarqeve administruese (në tekstin e mëtutjeshëm: organet) dhe ta informojë publikun për sjelljen që ka të drejtë ta presë nga nëpunësi civil.

### **Respektimi i dispozitave të Kodit**

#### **Neni 2.**

Nëpunësi civil e ka për obligim që t'i respektojë dispozitat e këtij Kodi.

Sjellja e nëpunësit civil në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi përbën shkelje të lehtë të detyrave të punës, përveç nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe si shkelje e rëndë e detyrave të punës.

### **Besimi publikut**

#### **Neni 3.**

Nëpunësi civil e ka për obligim të sillet në atë mënyrë që i kontribuon ruajtjes dhe nxitjes së besimit të publikut në integritetin, paanësinë dhe efikasitetin e organit.

### **Ligjshmëria dhe paanësia në punë**

#### **Neni 4.**

Nëpunësi civil e kryen detyrën e tij në kuadër të autorizimeve që ka, në pajtim me ligjin dhe rregullat tjera dhe vepron sipas rregullave të profesionit dhe dispozitave të këtij Kodi.

Nëpunësi civil nuk guxon që në jetën private të sillet në mënyrë të tillë që e bën tërheqës për ndikimin e personave tjerë gjë që mund të ndikojë në kryerjen e detyrës në mënyrë të ligjshme dhe paanshme.

### **Neutraliteti politik**

#### **Neni 5.**

Nëpunësi civil në kryerjen e detyrave të tij i respekton parimet e neutralitetit politik.

Në hapësirat zyrtare të organit, nëpunësi civil nuk guxon të mbajë dhe theksojë shenja të partive politike, e as materiale propagandistike të tyre.

Nëpunësi civil nuk guxon të ndikojë në përcaktimin politik të nëpunësve tjerë civilë dhe punonjësve.

### **Mbrojtja e interesit publik**

#### **Neni 6.**

Gjatë marrjes së vendimeve dhe ushtrimit të autorizimeve që i ka në diskrecion, nëpunësi civil është i obliguar që të kujdeset për interesin publik dhe faktet relevante, dhe nuk guxon të veprojë në mënyrë që e sjell atë në pozitë të detyrimit për t'ia kthyer shërbimin ndonjë personi fizik apo ligjor.

### **Parandalimi i konfliktit të interesit**

#### **Neni 7.**

Në kryerjen e detyrave të tij, nëpunësi civil nuk guxon të lejojë që interesi i tij privat të vijë në konflikt me interesin publik.

Ai është i obliguar që të kujdeset për konfliktin ekzistues apo të mundshëm të interesave dhe t'i ndërmerr masat e parapara me ligj për t'iu shmangur konfliktit të interesit.

### **Parandalimi i konfliktit të interesit gjatë fillimit të punës**

#### **Neni 8.**

Udhëheqësi i njësisë së personelit të organit, përkatësisht nëpunësi civil i ngarkuar me punë të personelit në organin që nuk ka njësi të personelit, është i obliguar që ta njoftojë personin që pranohet në punë në cilësinë e nëpunësit civil para së të fillojë me punë me ligjin, kufizimet e parapara, dhe ndalesat që kanë për qëllim parandalimin e konfliktit të interesit.

### **Veprimi me dhuratë**

#### **Neni 9.**

Nëpunësi civil nuk guxon të pranojë dhuratë, e as çfarëdo lloj shërbimi apo përfitimi tjetër për vetën e tij apo persona tjerë në kryerje të detyrës, përveç dhuratave protokollare ose të duhura me vlerë më të vogël, në përputhje me rregulloret me të cilat rregullohet parandalimi i konfliktit të interesit gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

Në rast se nëpunësit civil i është ofruar një dhuratë apo ndonjë shërbim tjetër, ai është i obliguar që dhuratën apo shërbimin e ofruar ta refuzojë, gjegjësisht dhuratën e dhënë ta kthejë, të ndërmerr veprime për identifikimin e personit dhe, në qoftë se është e mundur, të gjejë dëshmitarë dhe menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orëve, për këtë të përpilojë shënim zyrtar dhe ta lajmërojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë.

Nëse nëpunësi civil është në dyshim se dhurata e ofruar mund të konsiderohet si dhuratë e duhur me vlerë më të vogël, ai është i obliguar që për këtë ta kërkojë mendimin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

### **Veprimi me mjetet e besuara**

#### **Neni 10.**

Nëpunësi civil është i obliguar që mjetet materiale dhe financiare të cilat i janë besuar në kryerjen e punëve t'i shpenzojë në mënyrë të paraparë, ekonomike dhe efikase, vetëm për kryerjen e punëve dhe mos t'i përdorë ato për qëllime private.

### **Veprimi me informacione**

#### **Neni 11.**

Në kryerjen e detyrave të tij, nëpunësi civil nuk mund të kërkojë qasje në informacione të cilat nuk i nevojiten për kryerjen e detyrës, ndërsa informatat që i ka në dispozicion i shfrytëzon në mënyrë të përcaktuar.

Nëpunësi civil nuk guxon të publikojë informacione në mënyrë të paautorizuar të cilat i ka mësuar gjatë kryerjes së detyrave të tij.

Në kryerjen e punëve private, nëpunësi civil nuk guxon t'i shfrytëzojë informacionet të cilat i ka në dispozicion zyrtarisht me qëllim të përfitimit të lehtësirave për atë apo për njerëzit që kanë lidhje me atë.

### **Mbrojtja e privatësisë**

#### **Neni 12.**

Me qëllim të mbrojtjes së privatësisë, nëpunësi civil nuk guxon të nxjerrë informata personale nga evidencat që mbahen për një nëpunës tjetër civil, përveç në raste që parashihen me ligj.

### **Sjellja me palët**

#### **Neni 13.**

Në sjelljen me palët, nëpunësi civil është i obliguar të: veprojë profesionalisht, me mirësi dhe denjësisht; të tregojë interesim dhe durim, posaçërisht me palën e painformuar; të japë informacione dhe të dhëna të sakta dhe me kohë, në përputhje me ligjin dhe rregulloret tjera; të ofrojë ndihmë dhe japë informacione për organet përgjegjëse për procedurë sipas kërkesave, si dhe për mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave; të udhëhiqet me parimin e barazisë dhe mos të japë privilegje varësisht nga veçoritë dhe karakteristikat personale të partisë; t'i kushtojë kujdes të veçantë sjelljes ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe personave tjerë me nevoja të posaçme; të respektojë personalitetin dhe dinjitetin e palës.

### **Sjellja me mbikëqyrësin dhe nëpunësit tjerë civil**

#### **Neni 14.**

Në raport me mbikëqyrësin, vartësit, nëpunësit e tjerë civil dhe punonjësit, nëpunësi civil sillet me kujdes të duhur dhe respekt. Nëpunësi civil, është i obliguar që në raport me nëpunësit e tjerë civil, mos ta pengojë procesin e punës, t'i nxisë marrëdhëniet profesionale dhe ambientin e punës dhe t'i shmanget veprimeve të cilat do të kishin pasoja të dëmshme për reputacionin e organit.

### **Ruajtja e reputacionit të organit**

#### **Neni 15.**

Nëpunësi civil në pozitë është i obliguar që të kujdeset që me sjelljen e tij në vende publike mos ta ulë reputacionin e pozitës dhe organit dhe besimin e qytetarëve në shërbimin civil.

### **Ndalimi i ngacmimit seksual**

#### **Neni 16.**

Ndalohet ngacmimi seksual, sjellja verbale apo joverbale e padëshiruar nga sfera e jetës seksuale me të cilin fyjet integriteti personal i nëpunësit civil. Parashtrësit për ngacmim seksual i parashtrohen personit i cili është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i personit nga i cili vijnë ngacmimet.

### **Standardet e veshjes në punë**

#### **Neni 17.**

Nëpunësi civil është i obliguar që të vishet në mënyrë të përshtatshme dhe të duhur, në përputhje me detyrat e nëpunësit civil dhe që me mënyrën e veshjes së tij në vend të punës mos ta dëmtojë reputacionin e organit të shtetit, e as mos të shprehë përkatësinë e tij politike, fetare apo tjetër, e cila do të mund ta ventë në dyshim paanësinë dhe neutralitetin e tij. Veshje të papërshtatshme konsiderohen në veçanti: fundet e shkurtra, bluzat me dekolte të madhe apo bretela të holla, bluza shumë të shkurta apo të tejdukshme, pantallona të shkurta. Nëpunësi civil i veshur në mënyrë të papërshtatshme njoftohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për obligimin e respektimit të këtij Kodi në kuptim të veshjes në vend të punës dhe për mundësinë e hapjes së procedurës disiplinore në rast të shkeljes së përsëritur të Kodit.

### **Mbrojtja e standardit të sjelljes dhe ndalimi i abuzimit**

#### **Neni 18.**

Nëpunësi civil i cili konsideron se nga ai apo ndonjë tjetër nëpunës civil kërkohet që të veprojë në mënyrë që është në kundërshtim me këtë Kod, për këtë e informon me shkrim udhëheqësin e organit. Për këtë arsye, nëpunësi civil nuk duhet të gjendet në situatë të papëlqyeshme në lidhje me nëpunësit e tjerë civil, e as t'i ekspozohet abuzimit gjatë kryerjes së detyrave dhe realizimit të të drejtave në organ.

### **Hyrja në fuqi**

#### **Neni 19.**

Kodi hyn në fuqi në ditën e tetë pas ditës së publikimit në „Gazetën Zyrtare të Serbisë“.



**SHTOJCA II**  
**Formularët për ndjekje praktike**  
**të standardeve të jetës publike**



## PYETËSOR

<b>MOSEGOIZMI</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i marrin vetëm ato vendime që janë në përputhje me interesin publik. Këtë nuk do të duhej ta bënin për përfitime financiare apo materiale për vetën, familjen e tyre, apo miqtë e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

## KOMENTE/SHËNIME

## PYETËSOR

<b>INTEGRITETI</b>		
Bartësit e funksioneve publike nuk do të duhej të ishin nën kurrfarë obligimi financiar apo tjetër ndaj individëve apo organizatave të cilat do të mund të ndikonin tek ata në kryerjen e detyrës zyrtare.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

## KOMENTE/SHËNIME

## PYETËSOR

<b>OBJEKTIVITETI</b> Në kryerjen e punëve publike, duke përfshirë këtu caktimin në funksione publike, ndarjen e vendeve të punës apo rekomandimin e individëve për shpërblime dhe përfitime, bartësit e funksioneve publike duhet të marrin vendime në bazë të cilësisë.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

## KOMENTE/SHËNIME



## PYETËSOR

<b>PËRGJEGJËSIA</b> Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimmirë	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?		

## KOMENTE/SHËNIME

## PYETËSOR

<p><b>TË QENIT TË HAPUR</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike janë përgjegjës para publikut për vendimet dhe veprimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen çdo kontrollë që zbatohet në funksionet e tyre.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)</p>		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

## KOMENTE/SHËNIME

## PYETËSOR

<p><b>NDERSHMËRIA</b></p> <p>Bartësit e funksioneve publike kanë obligimin për të lajmëruar çdo interes privat, i cili ka lidhje me detyrën e tyre publike, si dhe të ndërmarrin hapa për zgjidhjen e konflikteve të mundshme në mënyrë të tillë që mbron interesin publik.</p>		
<p>1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?</p>		
<p>2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?</p>		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
<p>3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?</p>		
<p>4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtë)</p>		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
<p>5. Si do ta formulonit ju shkurtimisht këtë standard të jetës publike?</p>		

## KOMENTE/SHËNIME

## PYETËSOR

<b>SHEMBULLI PERSONAL</b> Bartësit e funksioneve publike duhet t'i nxisin dhe avancojnë këto parime përmes udhëheqjes dhe shembullit personal.		
1. A konsideroni që në rastin konkret është shkelur ky standard i jetës publike dhe pse?		
2. Përveç standardit të përmendur të jetës publike, a është shkelur edhe ndonjë standard tjetër i jetës publike, cili, dhe në pika të shkurtra, pse?		
(1)		
(2)		
(3)		
(4)		
3. A ka ndërmarrë personi përgjegjës ndonjë hap pozitiv më qëllim të rregullimit apo zgjidhjes së shkeljes të standardit?		
4. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e kaluar është po, a e konsideroni veprimin e personit përgjegjës (vlerësoni me notë nga 1 deri në 5 dhe jepni një koment të shkurtër)		
të sinqertë dhe qëllimshëm	5 (pesë)	
të drejtë dhe mjaftueshëm	4 (katër)	
mund të ishte më i sinqertë	3 (tre)	
jo i bindshëm	2 (dy)	
i pasinqertë dhe i rrejshëm	1 (një)	
5. Si do ta formuloni ju shkurtimeisht këtë standard të jetës publike?		

## KOMENTE/SHËNIME